



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 19/2024 regjistër (JR)
Datë 29.05.2024

Nr. 15 i vendimit
Datë 26.02.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 26.02.2025, ditën e mërkurë, në orën 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretar Gjyqësor Kevin Kovaçica, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 730, datë 10.01.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), analizoi pretendimet e ngritura në ankim, nga Komisioneri Publik Florian Ballhysa dhe nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme Altin Dumani, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, nëpërmjet të cilave kërkuan ndryshimin e vendimit nr. 730, datë 10.01.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në

vijim, “Komisioni”) dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Valentin Preçi (në vijim, “subjekti i rivlerësimit”) dhe, pasi analizoi parashtrimet dhe kërkimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit dhe të përfaqësueses ligjore, të cilët kërkuan lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Valentin Preçi, për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Mbështetur në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, hartuar nga: (i) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) Drejtoria e Sigurimit të Informacionin të klasifikuar (në vijim “DSIK”), për kriterin e kontrollit të figurës, sipas neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016; (iii) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga të cilat ka rezultuar si vijon:

2.1. ILDKPKI-ja, në raportin e hollësishëm e të arsyetuar të dërguar në Komision, ka konstatuar: (i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave¹.

2.2. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo elemente që cenojnë figurën e tij, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, dhe ka konstatuar përshtatshmërinë në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit².

2.3. KLP-ja, pas rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

¹ ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 10.10.2018, ka dërguar “Aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit Valentin Preçi”.

² Raporti i DSIK-së, nr. {***} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar me vendimin e KDZh-së, nr. {***}, datë 07.07.2020.

³ Raporti i KLP-së, “Për analizimin e aftësive profesionale të prokurorit Valentin Preçi”, përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 02.06.2023.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin nr. 730, datë 10.01.2024, Komisioni arsyetoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Bazuar në nenin 58, pika 1, shkronja “a”, nenin 59, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vendosi:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Valentin Preçi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. [...]

4. Sipas çështjeve të shqyrtuara për secilin kriter, Komisioni vlerësoi me arsyetimin e përmbledhur si vijon:

4.1. Në lidhje me kriterin e pasurisë: [...] Në respektim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit... Komisioni vlerësoi se balanca negative prej - 1.241.068 lekësh nuk mund të shërbejë si shkak për të vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

4.2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës: [...] Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Valentin Preçi ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

4.3. Në lidhje me kriterin e aftësive profesionale: [...] Subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

5. Komisioneri Publik Florian Ballhysa (në vijim “Komisioneri Publik”), bazuar në nenin C, pika 2, nenit F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 4 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016, ka ushtruar ankim⁴ ndaj vendimit nr. 730, datë 10.01.2024, të Komisionit, duke e konsideruar atë në papajtueshmëri të plotë me gjendjen e fakteve dhe provave të administruara në fashikull, për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik, nëpërmjet ankimit, kërkon shqyrtimin nga Kolegji të shkaqeve të ngritura në ankim dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, të vendosë: (i) ndryshimin e vendimit nr. 730, datë 10.01.2024, të Komisionit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Valentin Preçi.
6. Ankimi i Komisionerit Publik është mbështetur në rekomandimin e një komisioni të përbërë nga tre përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”), të cilët, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenin 65, pika 2 e ligjit

⁴ Ankim nr. {***} prot., datë 03.05.2024, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 03.05.2024.

nr. 84/2016, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 24.04.2023, “Rekomandim për paraqitje ankimi”⁵ ndaj vendimit nr. 730, datë 10.01.2024, të Komisionit.

7. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

7.1. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, sa i përket vlerësimit të burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e pasurive “apartament banimi me sipërfaqe 84.54 m²” dhe “garazh me sipërfaqe 14 m²”. Komisioneri Publik kundërshton qëndrimin e Komisionit për: 1) mbulimin/financimin e shpenzimeve të kredisë nga i vjehri, SH. B.; 2) shpenzimet e udhëtimit (transporti dhe qëndrimi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës); 3) ndihma sociale e marrë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe; 4) të ardhurat e përfituara nga lotot sportive. Komisioneri Publik, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm dhe jurisprudencën e Kolegjit, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe kryerjen e shpenzimeve ndër vite, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 3, i lidhur me nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

7.2. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, Komisioneri Publik ka vlerësuar se mosdeklarimi i marrëdhënies me z. M. F. në formularin për kontrollin e figurës, e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, parashikuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka plotësuar saktë “Deklaratën për kontrollin e figurës”, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016. Z. M. F. rezulton person i përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, referuar Rekomandimit të ONM-së, të datës 23.4.2024, ku parashtrrohet se kjo e dhënë, e administruar gjatë hetimit dhe kontrollit të figurës justifikon rishikimin nga Kolegji edhe në drejtim të treguesit të “Etikës”, Komisioneri Publik vlerëson se, edhe kjo “gjetje” duhet çmuar si rrethanë që lidhet me etikën e magjistratit, në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas parashikimit në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

7.3. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioneri Publik, në përfundim të vlerësimit të gjetjeve të lidhura me konfliktin e interesit dhe ato të dala nga shqyrtimi i dy denoncimeve, konkretisht të shtetasve B. A. dhe A. H., në konsideratë edhe të rekomandimit të ONM-së, vlerëson se veprimet e subjektit të rivlerësimit afektojnë kriterin e aftësisë profesionale, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 73, pikat 2 dhe 3, nenin 74, pika 4, dhe nenin 75, pika 4, të ligjit nr. 96/2016.

Komisioneri Publik vlerëson se sjellja e subjektit të rivlerësimit duket se vjen në kundërshtim me vlerat themelore të pritshme të një magjistrati, siç është përcaktuar në nenin 3, pika 5 e

⁵ Link: <https://aksesdrejtesi.al/dokumenta/1715177813Ankim-kund%C3%ABr-vendimit-nr.-730-dat%C3%AB-10.01.2024-t%C3%AB-KPK-s%C3%AB-p%C3%ABr-subjektin-e-rivler%C3%ABsimit-z.-Valentin-Pre%C3%A7i.pdf>

ligjit nr. 96/2016, dhe rregullat ndërkombëtare, që parashikojnë sjelljen e magjistratëve gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij, duke përfshirë parime si pavarësia, integriteti dhe shmangia e konflikteve të interesit, të cilat janë të domosdoshme për të mbajtur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

Sipas Komisionerit Publik, problematikat e konstatuara më sipër janë të vlefshme për t'u trajtuar nga Kolegji eventualisht, së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, nën frymën e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të aplikimit të nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, si cenim i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

VI. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

i. Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, që ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

ii. Legitimimi i ankuesit

9. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2, dhe F, pika 2, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

10. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për të garantuar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, çështja objekt gjykimi u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim "trupi gjykues") në seanca gjyqësore publike, në prani të palëve, të cilat u zhvilluan në datat 21.01.2025, 05.02.2025, 13.02.2025 dhe 26.02.2025.
11. Për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës, dhe nenit 199, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile, në seancën gjyqësore publike të datës 21.01.2025, këtë kompetencë e ushtroi Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, Altin Dumani.
12. Në seancën gjyqësore publike të datës 21.01.2025, në vijim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit për marrjen në cilësinë e provës të akteve shpresore të depozituara, së bashku me parashtrimet e tij, që do t'i shërbenin hetimit dhe shqyrtimit të plotë të çështjes, pasi dëgjoi edhe Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme lidhur me këtë kërkesë, në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, dhe neneve 45 dhe 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, me

vendim të ndërmjetëm, vendosi të lejojë marrjen e tyre në cilësinë e provës⁶, për sa ato lidheshin me shkaqet e ankimit dhe nevojën e subjektit të rivlerësimit për t'i prapësuar, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale. Pas paraqitjes së parashtrimeve të palëve, subjekti i rivlerësimit iu përgjigj pyetjeve të Vëzhguesit Ndërkombëtar dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

iv. Gjetje nga Vëzhguesi Ndërkombëtar

13. Nga Vëzhguesi Ndërkombëtar i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, z Ferdinando Buatier de Mongeot, bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “b” e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, më datë 04.02.2025, u paraqit në Kolegj akti “Gjetje”⁷. Në këtë akt, Vëzhguesi Ndërkombëtar parashtron se, ashtu sikurse është paraqitur në rekomandimin e tyre, konfirmuar nga ankimi i Komisionerit Publik, Komisioni nuk arriti të kryente një hetim të plotë mbi natyrën e kontakteve të z. Preçi me vëllezërit Frroku, duke çuar

⁶ Subjekti i rivlerësimit, së bashku me parashtrimet e datës 16.01.2025, paraqiti në Kolegj aktet si vijon për secilin kriter:

Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: (i) revista e përmuajshme rinore “{***}”, qershor 2007, 60 faqe; (ii) revista e përmuajshme rinore “{***}”, shtator 2007, 60 faqe; (iii) revista e përmuajshme rinore “{***}”, nëntor 2008, 60 faqe; (iv) Revista e përmuajshme rinore “{***}”, janar 2009, 60 faqe; (v) revista e përmuajshme rinore “{***}”, shkurt 2009, 60 faqe; (vi) revista e përmuajshme rinore “{***}”, mars 2009, 60 faqe; (vii) vendim nr. {***}, datë 20.03.2024, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, 10 faqe; (viii) vërtetim nr. {***} prot., datë 26.12.2024 i Përmbarduesit Gjyqësor Privat, 1 faqe; (ix) shkresë, datë 08.05.2024, lëshuar nga “Department of Medicaid”, e apostiluar dhe përkthyer, 8 faqe; (x) shkresë “kthim-përgjigje”, nr. {***} prot., datë 09.01.2025, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Kamëz, Bashkia Kamëz, 1 faqe; (xi) kërkesë, datë 08.01.2025, drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile, Bashkia Kamëz, 1 faqe; (xii) “email”, datë 30.04.2024, drejtuar adresës së email-it {***}, me objekt: “Kërkesë për korrigjimin e gabimit material”, 1 faqe; (xiii) kërkesë, datë 30.04.2024, me objekt “Korrigjimin e gabimit material të vendimit nr. 730, të datës 30.04.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, 9 faqe; (xiv) “email” i dërguar nga Komisioni më datë 27.05.2024, me adresë {***}, 1 faqe; (xv) “email”, dërguar më datë 31.05.2024 Komisionit, në adresat {***} dhe {***}, 1 faqe; (xvi) “email” i dërguar nga Komisioni më datë 03.06.2024, me adresë {***}, 1 faqe.

Për kriterin e kontrollit të figurës: (i) shkresë nr. {***} prot., datë 29.05.2024, e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, 1 faqe; (ii) kërkesë, datë 13.12.2024, drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, 1 faqe; (iii) shkresë “kthim-përgjigje”, nr. {***} prot., datë 16.12.2024, e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, 15 faqe; (iv) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.01.2025, 4 faqe; (v) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.01.2025, 4 faqe; (vi) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.12.2024, 6 faqe; (vii) certifikatë vdekje (nga “Akti”), datë 24.12.2024, 1 faqe; (viii) kërkesë, datë 13.12.2024, drejtuar Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, Prokuroria e Përgjithshme, 2 faqe; (ix) shkresë “kthim-përgjigje”, nr. {***} prot., datë 08.01.2025, e Prokurorisë pranë Gjykatës Së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, 24 faqe.

Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: (i) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.01.2024 – 4 faqe; (ii) shkresë “kthim-përgjigje” nr. {***} prot., datë 24.12.2024, e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, 2 faqe; (iii) shkresë nr. {***} prot., datë 21.10.2024, me lëndë “Njoftim mbi vendimin e arkivimit të ankesës pas shqyrtimit fillestar”, e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, 9 faqe; (iv) vërtetim nr. {***} prot., datë 10.10.2024, e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, 8 faqe.

⁷ Më datë 04.02.2025, në Kolegj u depozitua dokumenti “Gjetje” i Vëzhguesit Ndërkombëtar, si dhe dokumentacioni shoqërues: (i) akte që i përkasin fashikullit të procedimit penal nr. {***}, viti 2013, për procedimin penal ndaj shtetasit A. F. (ii) vendim nr. {***}, viti 2017, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mbi dënimin e A. F. (iv) vendim nr. {***}, viti 2015, i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, ndaj A. F. (v) vendim nr. {***}, viti 2015, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

në gabime lidhur me analizën dhe konkluzionet e saj ligjore. Sipas provave të paraqitura rishitazi nga Struktura e Posaçme Anti-Korrupsion (SPAK), sipas nenit 50 të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se, nga regjistri i thirrjeve të muajit prill 2012, konfirmohen komunikime të drejtpërdrejta ndërmjet celularit të shtetasit A. F. dhe celularit të subjektit të rivlerësimit Valentin Preçi.

14. Vëzhguesi ndërkombëtar, bazuar në gjetjet e mësipërme, arriti në përfundimin se provat e paraqitura bien ndesh me pretendimet e z. Preçi se ai nuk kishte njohje me z. A. F. Të dhënat telefonike tregojnë se ky takim, në qershor 2012, nuk ishte rastësor dhe që ata kishin kontakte me njëri-tjetrin, të paktën që nga prilli 2012. Duke pasur parasysh implikimet serioze të këtij informacioni të ri, Vëzhguesi Ndërkombëtar rekomandon që të rihapet hetimi për t'i mundësuar trupit gjykues dhe palëve të rishikojnë dhe vlerësojnë ndikimin e kësaj prove në proces.
15. Në kushtet kur ligji nr. 84/2016, në nenin 49, pika 10 e tij, "Gjetjen" e paraqitur nga Vëzhguesi Ndërkombëtar e konsideron me cilësinë e provës që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, i cili ekziston ose ka ndodhur, trupi gjykues, në seancën gjyqësore publike të datës 05.02.2025, iu la kohë palëve në proces për t'u njohur me këtë akt dhe për të përgatitur qëndrimin e tyre lidhur me të, përpara se kjo provë t'i nënshtrohej debatit gjyqësor.
16. Në seancën gjyqësore publike të datës 13.02.2025, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme paraqiti parashtrimet mbi "Gjetjen" e Vëzhguesit Ndërkombëtar, duke mbajtur qëndrimin se të gjitha faktet e sipërpërmendura duhet të merren në shqyrtim dhe të vlerësohen, për sa i përket kriterit të vlerësimit të figurës për subjektin e rivlerësimit dhe, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, sjellja e tij të vlerësohet se ka krijuar vështirësi në zbulimin e së vërtetës dhe që vjen në kundërshtim me vlerat themelore të magjistratit dhe standardet e etikës dhe rregullave të sjelljes të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
17. Përfaqësuesja ligjore e subjektit të rivlerësimit, në qëndrimin që mbajti lidhur me "Gjetjen", u shpreh se përgatitja e praktikës shkresore, mbi të cilën është paraqitur më pas "gjetja", nuk rezultoi të jenë konkluzion i veprimeve hetimore të Komisionit apo hetim gjyqësor i Kolegjit, orientuar nga kërkimet e palëve në proces. Për pasojë, çdo iniciativë e jashtme për të administruar e më pas paraqitur prova në gjykim (qoftë edhe si premisë për një gjetje) duket se nuk është në përputhje me qëllimin dhe rregullat e procedurës së rivlerësimit, sipas Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

17.1. Përfaqësuesja ligjore e konsideroi këtë akt një tejkallim të kompetencës në drejtim të marrjes dhe administrimit të provave, nga subjekt jo i parashikuar në Kushtetutë dhe në ligj, duke i kërkuar Kolegjit t'i konsiderojë të papërdorshme aktet shkresore të referuara si bazë për lëshimin e "Gjetjes" së Vëzhguesit të ONM-së dhe, për rrjedhojë, edhe këtë të fundit, si një opinion i ngritur nga një provë nën këtë sanksion dhe, si të tillë, ta përjashtojë nga vlerësimi dhe debati gjyqësor në këtë fazë gjykimi.

17.2. Pas njohjes me "Gjetjen" e paraqitur nga Vëzhguesi Ndërkombëtar, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur disa kërkesa në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në Gjykatën e Posaçme

kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar, në përgjigje të të cilave ka marrë disa akte shkresore, që kërkoi të administrohen si prova.⁸

18. Në seancën gjyqësore publike të datës 13.02.2025, trupi gjykues vendosi të pranojë në cilësinë e provës “Gjetjen” e Vëzhguesit Ndërkombëtar, së bashku me dokumentacionin shoqërues të saj, si dhe aktet e paraqitura nga përfaqësuesja ligjore e subjektit të rivlerësimit. Këto akte iu nënshtruan debatit gjyqësor dhe u vlerësuan nga Kolegji në raport me vendimin objekt shqyrtimi dhe shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik. Sa u përket denoncimeve⁹ të depozituara në Kolegji, pasi dëgjoi qëndrimin e palëve, trupi gjykues, duke mos i gjetur ato në kushtet e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, vendosi të mos vijojë me kryerjen e hetimit të mëtejshëm.
19. Gjatë paraqitjes së konkluzioneve përfundimtare, më datë 18.02.2025, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme u shpreh se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e shkaqeve të ankimit për të tria kriteret e vlerësimit, duke i kërkuar Kolegjit ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Valentin Preçi. Përfaqësuesja ligjore e subjektit të rivlerësimit kundërshtoi ankimin dhe i kërkoi përfundimisht Kolegjit mospranimin e tij, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 730, datë 10.01.2024, që lidhet me subjektin e rivlerësimit Valentin Preçi, si një vendim tërësisht i bazuar në ligj e në prova dhe në parimet e objektivitetit, proporcionalitetit dhe paanshmërisë.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues vlerësoi shkaqet e ngritura në ankim, qëndrimet e palëve përgjatë procesit gjyqësor, si edhe analizoi e vlerësoi të gjitha provat që gjendeshin në dosjen e hetimit administrativ të Komisionit, si dhe ato të cilat u morën gjatë procesit gjyqësor në Kolegji, dhe që iu nënshtruan debatit gjyqësor prej palëve, duke arsyetuar e konkluduar si vijon.

⁸ Përfaqësuesja e subjektit dorëzoi në seancën e datës 13.02.2025 disa akte që i përkasin fashikullit të kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë mbi vlefësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal, viti 2012, ndaj z. A. F.: (i) Vendim “Për regjistrimin e emrit të personit”, datë 17.07.2012, me anë të së cilit prokurori ka disponuar me regjistrimin e emrit të shtetasit A. F. si person të cilit i atribuohet vepra penale. (ii) Kërkesë “Për gjykimin e çështjes penale nr. {***}, të vitit 2012, në ngarkim të të pandehurit A. F.”, për veprën penale “Mosbindja ndaj urdhrin të punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal, për procedimin penal, sipas nenit 236 të K. Penal. (iii) Akt ekspertimi mjekoligjor, nr. {***} prot., datë 08.10.2012, lëshuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, për shtetasin A. F. (iv) Akt ekspertimi mjekoligjor nr. {***}, datë 28.09.2012, lëshuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, për punonjësin e policisë K. J. (v) Akt ekspertimi mjekoligjor, nr. {***}, datë 28.09.2012, lëshuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, për punonjësin e policisë A. H. (vi) Shkresa nr. {***} prot., datë 29.09.2012, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me anë të së cilës përcillet kërkesa “Për vlefësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit A. F.”; shkresa “Kthim përgjigje” nr. {***}, datë 12.02.2025, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Kërkesë e subjektit, nr. {***}, datë 07.02.2025, drejtuar GJKKO-së. Gjithashtu, në këtë seancë, përfaqësuesja e subjektit, lidhur me konfliktin e interesit, dorëzoi Urdhrin nr. {***}, datë 07.02.2015, dhe Urdhrin nr. {***}, datë 12.01.2015, të drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, “Mbi organizimin e punës së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore”. Shkresë nr. {***}, datë 27.01.2025, e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, lidhur me statusin e çështjes së denoncuesit K. A.

⁹ Në Kolegji, më datë 21.01.2025, është depozituar denoncimi i shtetasit K. A. dhe, më datë 04.02.2025, është depozituar denoncim i shtetasit A. B.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit në lidhje me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

20. Për pasuritë “apartament banimi me sipërfaqe 84.54 m²” dhe “garazh me sipërfaqe 14 m²”, ndodhur në {***}”, Tiranë, Komisioneri Publik ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, i lidhur me nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

20.1. Komisioni, me aktin “Rezultate të hetimit administrativ”, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës për këtë pasuri, pasi ka konstatuar se: [...] Duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur mundësi financiare për: (i) pagesën e shumës prej 40.000 eurosh në vitin 2008 (balanca negative paraprake në vlerën - 1.336.380 lekë); (ii) pagesën e kështit 5.000 euro në vitin 2011 (balanca negative paraprake në vlerën -1.384.679 lekë); (iii) pagesën e kështit të fundit në vlerën 5.000 euro, në datën 26.09.2014 (balanca negative paraprake në vlerë - 93.965 lekë) [...].

20.1/a. Komisioni në vendim, për këtë pasuri, ka arritur në përfundimin se: [...] duke pasur parasysh deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaramtën *vetting*, raportin e ILDKPKI-së, deklaramtat periodike vjetore, provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe provat shkresore të administruara sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, vlerësoi se burimet e përdorura për financimin e pasurisë janë në harmoni me deklaramet e subjektit në deklaramtën e pasurisë *vetting* dhe me deklaramet dhe logjikën e përdorur gjatë procesit të rivlerësimit dhe se, referuar analizës financiare të rishikuar, subjekti ka justifikuar blerjen e pasurisë me të ardhura të ligjshme [...].

20.1/b. Në deklaramtën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaramuar: “*Apartament banimi me sipërfaqe 84.54 m²” dhe “garazh me sipërfaqe 14 m²”, blerë me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.09.2014, me çmim total blerjeje 50.000 euro, në rrugën “{***}”, {***}, Tiranë. Si burim krijimi, subjekti i rivlerësimit ka deklaramuar: “Kredi hipotekore dhe konsumatore, e para me vlerë 24.500 euro, sipas kontratës së huas me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 12.03.2008, si dhe e dyta, me vlerë 5.500 euro, sipas kontratës së huas, datë 12.03.2008, të marra nga Banka Emporiki (sot American Bank of Investment ShA). Diferenca prej 20.000 eurosh është paguar me para në dorë, e ndarë në 3 këste (respektivisht 10.000 euro në 2008, 5.000 euro në vitin 2011 dhe 5.000 euro në vitin 2014), nga kursimet e familjes. Shuma prej 5.000 eurosh, e shlyer në vitin 2011, është paguar për llogarinë time nga kunati im, L. D., dhe i është shlyer atij prej meje me anë të kursimeve të familjes në vitin 2012”. Vlera: 50.000 Euro. Pjesa takuese: 100%.*

20.1/c. Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, të datës 23.04.2024, ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga Komisioni lidhur me vlerësimin e burimeve të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e pasurive “apartament banimi me sipërfaqe 84.54 m²” dhe “garazh me sipërfaqe 14 m²”, konkretisht: (i) për të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes së subjektit në shoqërinë “{***}”; (ii) mbulimi/financimi i shpenzimeve të kredisë nga vjehri, SH. B.; (iii) mbi përlllogaritjen e shpenzimeve dhe kostot e jetesës së familjarëve gjatë

qëndrimin në ShBA; (iv) mbi të ardhurat e fituara në lotari sportive; (v) deklaratimet e gjendjes *cash* dhe ligjshmërinë e tyre.

20.2. Në funksion të shqyrtimit të ankimit të Komisionerit Publik, lidhur me analizën e burimeve financiare të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, trupi gjykues konstaton se:

20.2/a. Në lidhje me të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në shoqërinë “{***}”, në vlerat 420.000 lekë në vitin 2008, dhe 300.000 lekë në vitin 2009, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në bisedimet përfundimtare të datës 18.02.2025, në referencë të akteve të depozituara nga subjekti gjatë shqyrtimit gjyqësor, por edhe në konsideratë të jurisprudencës së Kolegjit, vlerësoi se u provua marrëdhënia e punësimit e personit të lidhur, znj. Preçi, me shoqërinë “{***}”, duke çmuar përfshirjen e këtyre të ardhurave në analizën financiare të subjektit, sipas deklaratimeve në deklaratat e interesave periodike për vitet 2008 – 2009.

20.2/b. Për pasojë, në kushtet kur Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka vlerësuar se këto shkaqe të prezantuara si të tilla në ankim, në mungesë të një hetimit të plotë, morën zgjidhje nga hetimi gjyqësor, trupi gjykues, duke e vlerësuar të drejtë këtë pretendim, i përfshiu këto të ardhura në analizën financiare të subjektit. Në këto rrethana, në arsyetimin në vijim, Kolegji do të analizojë dhe shqyrtojë ato shkaqe ankimi, të cilat mbetën në vlerësimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, si arsye mbi të cilat i kërkohet gjykatës ndryshimi i vendimit.

20.3. Në lidhje me mbulimin/financimin e shpenzimeve të kredisë nga vjehri i subjektit (SH. B.), për periudhën 2008 – 2010, në vlerën totale prej 8.750 eurosh, Komisioneri Publik e ka vlerësuar të pambështetur vlerësimin e Komisionit mbi këto shpenzime, për sa kohë që shumat e pretenduara të financuara nga vjehri nuk rezultojnë të jenë deklaruar nga subjekti, as në deklaratat periodike vjetore dhe as në deklaratën *vetting*.

20.3/a Sipas Komisionerit Publik, në momentin e krijimit të një marrëdhënieje huaje/dhurimi, huadhënësi/dhuresi klasifikohet si “një person tjetër i lidhur” dhe duhet të justifikojë ligjshmërinë e burimeve të përdorura për krijimin e pasurisë. Edhe pse në këtë rast nuk ka prova që të konfirmojnë ekzistencën e një marrëdhënie të tillë, nuk rezultojnë të jetë kryer nga Komisioni ndonjë analizë financiare në lidhje me mundësinë financiare të huadhënësit/dhuresit për të justifikuar pagesat.

20.3/b. Komisioneri Publik ka vlerësuar se të ardhurat e deklaruar si financim/mbulim nga i vjehri, z. SH. B., vetëm gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit, vlerësohet se nuk duhet të konsiderohen si të ardhura me burime të ligjshme në analizën financiare të subjektit dhe personit të lidhur me të për vitet respektive.

20.4. Komisioni në vendim, lidhur me këtë situatë, ka arsyetuar ndër të tjera se: “Në analizë të të gjitha parashtrimeve dhe dokumenteve që subjekti ka paraqitur, si dhe qëndrimin të mbajtur në Kolegj / Komision në raste të ngjashme, në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi që në analizën financiare të rishikuar, këstet për pagimin e kredisë të mos konsiderohen si shpenzime të subjektit, për sa kohë: (i) këto pagesa të kryera nga vjehri i tij janë deklaruar që në përgjigje të pyetësorit standard; (ii) bazuar në dokumentacionin ligjor të depozituar, nuk

mund të konkludohet që familja e bashkëshortes nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për pagesat e kësteve të kredisë”.

20.5. Në kuadër të analizimit të këtij pretendimi të Komisionerit Publik, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, trupi gjykues konstatoi se, gjatë procedurës së hetimit administrativ të kryer në Komision, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjes nr. 4¹⁰ të pyetësorit standard, të datës 10.07.2020, ndër të tjera, ka deklaruar:

i) Në vitin 2008, vjeherri im, z. SH. B., ka financuar pagesën e kësteve të kredisë të paguara gjatë vitit 2008, në shumën rreth 2.800 euro, si dhe gjithë shpenzimet e udhëtimit tim dhe bashkëshortes në ShBA, në korrik të vitit 2008.

ii) Nga janari i vitit 2009 deri në shtator të vitit 2009, janë financuar nga vjeherri im, SH. B., nga kursimet e familjes së tij, shuma prej rreth 3.200 (tre mijë e dyqind) eurosh për të paguar këstet e kredisë së marrë pranë ish-Emporiki Bank, sot Abi Bank (kontribut për t'i ardhur në ndihmë vajzës së tij).

iii) Nga janari i vitit 2010 deri në shtator të vitit 2010, janë financuar nga vjeherri im, SH. B., nga kursimet e familjes së tij, shuma prej rreth 2.750 (dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) eurosh për të paguar këstet e kredisë së marrë pranë ish-Emporiki Bank, (kontribut për t'i ardhur në ndihmë vajzës së tij).

Burimi i shumave të financuara nga vjeherri im, z. SH. B., janë kursimet e realizuara nga të ardhurat e pagave të tij, bashkëshortes N. B., dhe djalit E. B. Bashkëlidhur kësaj përgjigjeje, dërgojmë dokumentet justifikuese të burimit të shumave të financuara.

20.5/a. Në vijim, subjekti i rivlerësimit është pyetur¹¹ të shpjegojë mosdeklarimin në deklaratat e interesave privatë të viteve 2008, 2009 dhe 2010, të financimeve / dhurimeve nga vjeherri, z. SH. B., ku është shprehur: *“Mosdeklarimi vjen për shkak se gjatë plotësimit të deklaratave, nuk është kërkuar burimi i kësteve të kredisë, thjesht në deklaratë ka një rubrikë ku shënohet për kreditë bankare shuma totale, principal plus interes, dhe kësti mujor, ndërkohë që nuk ka rubrikë ku të shënohet burimi i këtij kësti mujor. Financimi i kryer nga vjeherri për këto këste në shumat e deklaruara, nuk është dhurim, që unë ta deklaroja si dhurim. Është thjesht një financim me destinacion të paracaktuar nga vetë ai, i një shpenzimi konkret dhe që është përdorur pikërisht për të paguar këto këste”.*

20.5/b. Në mbështetje të deklarimeve të tij, përgjatë procesit hetimor administrativ në Komision, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 06.12.2023, të lëshuar nga vjeherri i tij, shtetasi SH. B., i cili deklaron se: *“Me të ardhurat e mia, të bashkëshortes sime N. B., dhe të djalit tim E. B., të siguruara nga puna, i kam ardhur në ndihmë vajzës dhe familjes së saj në vitet 2008 – 2010, për të paguar këstet e kredisë së tyre pranë bankës Abi Bank, për blerje banese. Për shkak të vështirësive financiare, pasi ato sapo*

¹⁰ Pyetja nr. 4 e pyetësorit standard: *“A keni marrë ndonjëherë ndonjë dhuratë me vlerë më të lartë se 500 euro, apo a ju ka financuar ndokush ndonjëherë shpenzimet në këtë shumë apo në shumë më të lartë se kjo, që nga marrja e detyrës për herë të parë? Nëse po, lutemi përcaktoni datën, shumën, dhuruesin, arsyen dhe burimin e kësaj dhurate apo pagese”.*

¹¹ Pyetja nr. 8 e pyetësorit 2, datë 15.12.2022.

ishin martuar dhe kishin blerë banesë, dhe dëshirës sonë për të dhënë kontributin familjar ndaj vajzës sonë të vetme, deklaroj se, në vitin 2008 kam mbuluar këstet e kredive në vlerën prej 2.800 eurosh, në vitin 2009 kam mbuluar këstet mujore gjatë muajve janar – shtator, në shumën 3.200 euro dhe, në vitin 2010, kam mbuluar këstet mujore gjatë muajve janar – shtator, rreth 2.750 euro [...]”. Gjithashtu, subjekti ka dorëzuar edhe deklaratën noteriale¹² nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.12.2023, lëshuar nga kunati i tij, shtetasi E. B.

20.5/c. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet në Kolegj, ashtu si edhe në Komision, ka pretenduar se financimi i kryer nga ana e vjehrrit për pagimin e kësteve të kredisë në shumat e deklaruara, nuk është dhurim apo hua, që subjekti të mbartte detyrimin për deklarim. Babai i bashkëshortes ka kryer një financim/mbulim shpenzimi, me destinacion të përcaktuar nga vetë ai, me vullnetin e tij të plotë.¹³ Sipas subjektit, në kushtet kur në deklaratat periodike vjetore nuk parashikohet deklarimi i burimit të kësteve të kredisë, në kuadër të procesit të rivlerësimit, ai ka dhënë për herë të parë shpjegime dhe deklarime në lidhje me këtë çështje me përgjigjet e pyetjes nr. 4 të pyetësorit standard, i cili u vjen në ndihmë organeve të rivlerësimit për të thelluar analizën financiare, të kryer në kuadër të vlerësimit të kriterit të pasurisë.

20.6. Trupi gjykues çmon të theksojë se, bazuar në ligjin nr. 84/2016 dhe në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrim ligjor për deklarimin në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratat e interesave periodikë vjetorë, të burimit që ka shërbyer për financimin e shpenzimeve për likuidimin e kësteve të kredisë. Ky interpretim mban në konsideratë edhe përmbajtjen e Shtojcës 2 “Deklarata e Pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe rubrikave përkatëse të saj, si dhe formatin e rubrikave përkatëse të deklaratës së interesave periodikë vjetorë. Pikërisht për shkak të këtij ometimi ligjor, pyetësori standard, në kuadër të këtij procesi, ka përfshirë edhe një pyetje e cila ka pasur për qëllim të plotësojë e të mbledhë informacion nga subjektet e rivlerësimit edhe për

¹² Në këtë deklaratë, ndër të tjera, shtetasi E. B. deklaroi se: “Me të ardhurat e prindërve dhe të ardhurat e mia, të siguruara nga puna, të administruara nga kryefamiljari SH. B., jam në dijeni dhe kam dhënë miratimin për t’i ardhur në ndihmë motrës sonë dhe familjes së saj në vitet 2008 – 2010, për të paguar këstet e kredisë së tyre pranë bankës Emporiki Bank. [...] Për shkak të vështirësive financiare, pasi ato sapo ishin martuar dhe kishin blerë banesë, dhe dëshirës sonë për të dhënë kontributin familjar ndaj motrës sime të vetme, deklaroj se babai, në vitin 2008 ka mbuluar këstet e kredive në vlerën prej 2.800 eurosh, në vitin 2009 ka mbuluar këstet mujore gjatë muajve janar – shtator, në shumën 3.200 euro dhe, në vitin 2010, ka mbuluar këstet mujore gjatë muajve janar – shtator, rreth 2.750 euro”.

¹³ Sipas subjektit, financimi është akti i sigurimit të burimeve për të financuar një nevojë, program ose projekt. Financimi ka destinacion të përcaktuar dhe jepet me qëllim mbulimin e nevojës konkrete. Financimi jepet për mbulimin e nevojës financiare dhe nuk bën diferencë nëse kjo ka të bëjë me nevojën për arsimim, shëndetësi, ushqim, strehim, udhëtim, ndërtim etj. Pra, nuk rezulton asnjë diferencë midis nevojës për të financuar një mjekim dhe nevojës për financuar një këst kredie apo një udhëtim.

Dhurimi, sipas Kodit Civil, është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër, një send të caktuar ose një të drejtë reale të cilat ajo i pranon. Sendi ose e drejta reale e dhuruar nuk ka një destinacion të përcaktuar nga dhuruesi, por përfituesi mund ta disponojë lirisht atë.

Këto dy koncepte (financimi dhe dhurimi) kanë diferencë mes tyre, pasi financimi jepet për të mbuluar një nevojë konkrete, ndërsa dhurimi është kalim pronësie, i cili nuk lidhet me nevojë konkrete apo destinacion konkret.

financime për shpenzime në vlerë mbi 500 euro, madje e evidentuar në pyetësor si një situatë faktike tërësisht e ndryshme nga ajo e dhurimit. Gjatë gjykimit të çështjes, rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit, në pyetësorin standard me të cilin fillon hetimi administrativ, ka deklaruar në mënyrë të qartë, të detajuar dhe shteruese për këtë financim nga vjehri i tij, shumën, kohën dhe qëllimin e dhënies së saj.

20.7. Trupi gjykues vëren gjithashtu se pranimi nga ana e Komisionerit Publik dhe përlllogaritja në analizën financiare e shpenzimeve të padeklaruara më parë në deklarimet periodike, konkretisht shpenzime mobilimi, kosto qiraje apo udhëtimi, të deklaruara nga subjekti për herë të parë në pyetësorin standard, krijon një standard të dyfishtë në raport me moskonsiderimin, financimin/mbulimin e shpenzimeve të kredisë, deklaruar në të njëjtin pyetësor, me pretendimin se nuk rezulton që subjekti apo personi i lidhur me të të kenë deklaruar këtë financim në deklaratat periodike vjetore. Për rrjedhojë, ky qëndrim jokosekuent i Komisionerit Publik rëndos në mënyrë të padrejtë situatën financiare të subjektit.

20.8. Në konsideratë të konstatimit të Komisionerit Publik në ankim mbi mungesën e një analize financiare të kryer nga Komisioni në lidhje me mundësinë financiare të vjehrit të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar pagesat, Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj kreu një analizë financiare mbi mundësinë e krijimit të shumës 8.750 euro me burime të ligjshme, nga z. SH. B. dhe familjarët e tij, referuar deklarimeve të subjektit se si burim i shumave për pagesat e kësteve të kredisë kanë shërbyer të ardhurat nga paga, të anëtarëve të familjes së origjinës së bashkëshortes¹⁴. Kjo analizë u krye në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit në jurisprudencën¹⁵ e tij për shtrirjen e analizës financiare të personave të tjerë të lidhur, vetëm në drejtim të verifikimit të mundësisë për të krijuar me të ardhura të ligjshme pasurinë objekt dhurimi apo huaje, pa e shtrirë këtë detyrim mbi të gjitha pasuritë e personave të tjerë të lidhur.

20.8/a. Në analizën financiare të kryer në Kolegj, të ardhurat neto nga paga të familjes së bashkëshortes së subjektit janë përlllogaritur mbi vërtetimet e lëshuara për z. SH. B.¹⁶ (babai i

¹⁴ Kjo analizë u krye bazuar në dokumentacionin përkatës depozituar nga subjekti bashkëlidhur pyetësorit standard, konkretisht: vërtetimi nr. {***} prot., datë 03.07.2020, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier, për z. SH. B., për periudhën 1 gusht 2009 deri më datë 31 maj 2010; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, lëshuar nga Prefekt i Qarkut Fier, për z. SH. B., për periudhën 01.05.2004 – 31.12.2007; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, lëshuar nga Prefekt i Qarkut Fier, për z. SH. B., për periudhën 01.01.2008 – 31.05.2009; vërtetim, datë 02.06.2016, lëshuar nga Prefekti i Qarkut Fier, me anë të të cilit vërtetohet se z. SH. B. ka punuar pranë këtij institucioni në detyrën e Prefektit të Qarkut Fier për periudhën 17.10.2005 – 31.05.2009 dhe, në fund të periudhës së punës, ka përfituar shpërblim 2 paga neto mujore, në shumën 192.600 lekë; vërtetim për bazën e vlerësuar, lëshuar nga DRSSH Fier, për znj. N. B., për periudhën 01.09.2006 – 31.12.2009; vërtetim për bazën e vlerësuar, lëshuar nga DRSSH Fier për znj. N. B., për periudhën 01.01.2010 – 31.12.2012; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, lëshuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për z. E. B., për periudhën 03.11.2008 – 11.01.2010; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes për z. E. B., për periudhën 15.02.2010 – 31.10.2010.

¹⁵ Shih vendimet nr. 15/2019 (JR), datë 17.06.2019, paragrafi 110; nr. 20/2019 (JR), datë 31.07.2019, paragrafi 28, dhe; nr. 2/2023 (JR), datë 02.02.2023, paragrafi 17.3, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

¹⁶ Totali të ardhurave neto nga paga për periudhën 2008 – 2009 është në vlerën 1.610.509 lekë.

bashkëshortes), znj. N. B.¹⁷ (nëna e bashkëshortes) dhe z. E. B.¹⁸ (vëllai i bashkëshortes). Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur sipas ILDKPKI-së, si dhe duke u bazuar në deklaratimet e subjektit se është martuar më datë 26.11.2007, si rrjedhojë, shpenzimet e jetesës për vitet 2008 – 2010 janë përlllogaritur për 3 persona. Vlerat e pagesës së kështit të kredisë janë përlllogaritur bazuar në deklaratimet e subjektit në pyetësorin standard (në vitin 2008, në vlerën 2.800 euro; në vitin 2009, në vlerën 3.200 euro, dhe; në vitin 2010, në vlerën 2.750 euro), konvertuar me kursin mesatar të vitit përkatës. Nga kjo analizë, rezultoi se familja e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit kishte mundësi të financonte me burime financiare të ligjshme pagesat e kësteve të kredisë (2008 – 2010) për subjektin dhe bashkëshorten e tij.

20.9. Në kushtet kur në ankim, ndër të tjera, Komisioneri Publik e mbështet vlerësimin e tij mbi këto të ardhura edhe në konsideratë të jurisprudencës së Kolegjit, konkretisht duke iu referuar qëndrimit të mbajtur në çështjen (JR)¹⁹ nr. 7/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit A. M., trupi gjykues çmon të theksojë se referimi në ankim i përket një situatë faktike tërësisht të ndryshme, sa i përket llojit të mbështetjes, kohështrirjes prej 12 vitesh e paqartësisë së subjektit në atë çështje për qëllimin e përdorimit të saj ndër vite, vlerës së konsiderueshme, madje në disa vite, edhe në kufijtë e vlerës së detyrueshme për deklaratim të shpenzimeve në deklaratat e interesave periodikë vjetorë (prej vitit 2014 e në vazhdim), lidhur me mosdeklarimin e kontributeve financiare të dhëna nga të tretët përgjatë periudhës së deklaratimit dhe në deklaratën *vetting*.

20.9/a. Në çështjen objekt ankimi, shuma e pretenduar është në total 8.750 euro, e shtrirë në një periudhë kohore 3-vjeçare (2008 – 2010), ndërsa në çështjen e cituar nga Komisioneri Publik: (i) bëhet fjalë për një kontribut total afërsisht 3.000.000 lekë, me kontribute periodike/vjetore përgjatë gjithë periudhës së deklaratimit 2004 – 2016; (ii) kjo vlerë është pretenduar t'i jetë financuar nga prindërit e bashkëshortit, me përgjigjet e dhëna për pyetësorin nr. 7 dhe jo në pyetësorin standard, pra në një fazë të avancuar të hetimit administrativ, (iii) burimi i shumave të financuara kanë qenë të ardhurat nga aktiviteti bujqësor, si dhe; (iv) subjekti e ka pretenduar këtë vlerë si financim të destinuar për mbulimin e më shumë se një shpenzimi; është përdorur për pagim të kësteve të kredisë, si dhe kësteve të shkollimit të djalit në shkollë jopublike.

20.9/b. Ndërsa, në rastin objekt shqyrtimi, në dallim me atë të referuar nga Komisioneri Publik, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar që në pyetësorin standard vlerën e financuar për periudhën

¹⁷ Totali të ardhurave neto nga paga për periudhën 2008 – 2010 është në vlerën 1.441.643 lekë.

¹⁸ Totali të ardhurave neto nga paga për periudhën 2008 – 2010 është në vlerën 1.050.690 lekë.

¹⁹ Në çështjen nr. 7/2023 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit A. M., trupi gjykues ka mbajtur këtë qëndrim: “14.6. Trupi gjykues analizoi deklaratat periodike vjetore dhe nuk konstatoi që subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur të kenë deklaruar shumën 300.000 lekë të përfituar nga babai i bashkëshortit, deklarim ky që do të përbënte provë, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. As në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur nuk kanë deklaruar këtë të ardhur. Në këto kushte, si dhe për faktin që nuk rezulton asnjë gjurmë shkresore lidhur me këtë të ardhur, si dhe me konsideratë jurisprudencën e Kolegjit, pavarësisht mundësisë financiare që mund të ketë pasur vjehri i subjektit, këto të ardhura të pretenduara vetëm gjatë pyetësorëve, të deklaruara pas pyetjes së Komisionit, të papërcaktuara realisht, bëjnë të bazuar pretendimin e Komisionerit Publik për mospërfshirjen e tyre në mesin e të ardhurave të ligjshme të subjektit të rivlerësimit. Në analizën financiare të kryer në Kolegj, kjo shumë nuk është përfshirë si e ardhur e ligjshme”.

2008 – 2010, të përcaktuar me shumën konkrete, destinacionin e përdorimit të këtij financimi, ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e familjes së bashkëshortes, si dhe ka rezultuar që familja e bashkëshortes ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme, përfituar prej anëtarëve të saj gjatë periudhës 2008 – 2010, për të justifikuar financimin e kryer për pagimin e kësteve të kredisë në këtë periudhë.

20.10. Në përfundim të analizimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues, në konsideratë edhe të marrëdhënies së posaçme prind-fëmijë dhe mungesës së nevojës për formalizimin e këtij financimi, pasi analizoi dhe konkludoi se familja e bashkëshortes së subjektit kishte mundësi me burime financiare të ligjshme të financonte pagesat e kësteve të kredisë, vlerësoi bindëse pretendimet e subjektit për konsiderimin e tyre në analizën financiare për burimet e krijimit të kësaj pasurie. Për pasojë, ky shkak ankimi i Komisionerit Publik gjendet i pabazuar në prova dhe ligj.

21. Lidhur me shkakun e ankimit mbi rishikimin e shpenzimeve të udhëtimit (transporti dhe qëndrimi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës).

21.1. Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni mbi përlogaritjen e kostos për qëndrimin në ShBA të subjektit dhe familjes së tij, në shumën 5 USD/dita, jo vetëm nisur nga kohëzgjatja e periudhës së qëndrimit, por kryesisht bazuar dhe në deklarinimin e bërë nga subjekti i rivlerësimit në procesverbalin e ILDKPKI-së, së datës 9 mars 2016.

Komisioneri Publik konstaton se nuk rezulton që të jetë bërë ndonjë deklarinim nga subjekti lidhur me shpenzimet mjekësore gjatë shtatzënieve dhe lindjes së fëmijëve nga bashkëshortja në ShBA, shpenzime të cilat, në zbatim të rekomandimit të ONM-së, duket se janë të konsiderueshme²⁰. Komisioneri Publik konsideron të pambështetur edhe vlerësimin e Komisionit mbi rishikimin e mbulimit të një pjese të shpenzimeve të udhëtimit nga babai i bashkëshortes, sipas deklarinimeve të subjektit në pyetësorin standard, për sa kohë që ky pretendim i subjektit bie në kundërshtim me deklarinimet e tij në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 09.3.2016.

21.2. Në lidhje me këtë shkak ankimi, Komisioni ka arsyetuar dhe konkluduar si vijon:

34.2. Në përfundim të procesit, në analizë të parashtrimeve dhe dokumenteve shkresore që subjekti ka paraqitur, Komisioni vlerësoi se subjekti ka argumentuar bindshëm pretendimet e tij në lidhje me shpenzimet e jetesës në Amerikë, duke përfshirë këto shpenzime në analizën financiare të rishikuar, sipas përlogaritjeve të subjektit të rivlerësimit.

21.3. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, pasi u analizuan aktet e fashikullit të çështjes lidhur me shpenzimet e qëndrimit jashtë vendit, trupi gjykues konstaton se disa nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ dhe të artikuluara edhe në vendimin e arsyetuar, të cilat janë konsideruar nga Komisioni, janë si më poshtë:

²⁰ Mesatarisht rreth 10.000 USD, në varësi nëse është një lindje normale apo një lindje me operacion cezarian.

21.3/a. Gjatë procedurës së hetimit administrativ të kryer në Komision, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjeve nr. 1²¹ dhe nr. 12²² të pyetësorit nr. 1, të datës 10.07.2020, sipas së cilës i kërkohej të deklaronte udhëtimet jashtë vendit dhe shpenzimet përkatëse, ndër të tjera, ka deklaruar: *15.07.2009 – 16.08.2009, udhëtim në ShBA me bashkëshorten. Kemi qëndruar në banesën e shoqes së bashkëshortes, L. T., me adresë “{***}”. Unë kam ndenjur deri më datë 15.08.2009 (kam mbërritur në Shqipëri më datë 16.08.2009), ndërsa bashkëshortja ka qëndruar atje deri më datë 14.11.2009. Kemi ndenjur në banesën e saj, me strehim dhe ushqim pa pagesë. Qëllimi ishte lindja e fëmijës, pasi bashkëshortja ishte shtatzënë. Shpenzimet tona për këtë udhëtim janë mbuluar nga kursimet e familjes”.*

21.3/b. Në vijim, subjekti është pyetur nga Komisioni për të dhënë shpjegime në lidhje me marrëdhënien me shtetasit L. dhe O. T., duke u shprehur: *Me L. dhe O. jemi njohur në verën e vitit 2008 në Columbus, OH, kur për herë të parë vizituam ShBA-në. Prej asaj kohe, kemi ruajtur marrëdhënie shoqërore. Të dy janë ofruar të na mirëprisnin në banesën e tyre për sa gjatë të ishte e nevojshme, duke qenë se ishte e bollshme. Gjithashtu, janë ofruar për të na suportuar me të gjitha nevojat e përditshme në mënyrë që tranzicioni ynë të ishte sa më i thjeshtë.*

21.3/c. Ndërkohë që për këtë udhëtim në ShBA, në pyetësorin standard subjekti deklaroi se shpenzimet e qëndrimit janë mbuluar nga palët e treta, rezultoi se në procesverbalin e mbajtur më herët në ILDKPKI, në datën 09.03.2016, në përgjigje të pyetjes nr. 10, konkretisht për pyetjen *Sa kanë qenë shpenzimet për daljet private?*, subjekti ka deklaruar se: *[...] për qëllime private, me sa mbaj mend, kam qenë një herë në Itali me bashkëshorten, kam qenë në ShBA rreth 10 - 11 herë, duke u nisur edhe nga fakti që ka jetuar dhe punuar bashkëshortja ime, shpenzimet janë mbuluar nga të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes.*

21.3/d. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: *Pyetja e drejtuar nga inspektori i ILDKPKI lidhet me shpenzimet e udhëtimit/daljes dhe jo me shpenzimet e qëndrimit. Këtë deklaram kam bërë edhe në pyetësorin standard, ku të gjitha biletat e udhëtimit ku unë dhe familja ime kemi udhëtuar privatisht, kam deklaruar mbulimin e shpenzimeve të biletave të udhëtimit (përveç udhëtimit të datës 18.07.2008 deri më 27.08.2008, ku bileta e udhëtimit është financuar nga vjehrrin im, si më sipër sqaruar), ndërsa në lidhje me qëndrimin në ShBA apo udhëtime të tjera, kam shpjeguar me saktësi rastet kur në këto udhëtime unë me familjen kemi qëndruar te banesa e miqve dhe të afërmeve, të cilat kanë qenë pa kosto²³, sikurse*

²¹ Pyetja nr. 1: *“Në cilat adresa keni banuar që nga momenti që keni marrë detyrën për herë të parë? Për secilën prej tyre, përcaktoni kush ka qenë pronari i objektit, a keni paguar qira dhe, nëse po, kujt ia keni paguar”.*

²² Pyetja nr. 12: *“Që kur keni filluar detyrën, a keni udhëtuar jashtë shtetit, ju vetë apo ndonjë pjesëtar i familjes suaj, duke përfshirë edhe pushimet? Nëse po, shënoni datat, destinacionin dhe qëllimin e udhëtimit apo udhëtimeve, si dhe identitetin e personave që kanë udhëtuar me ju. Ku keni qëndruar gjatë këtyre udhëtimeve jashtë shtetit? Shënoni emrin e hotelit, shpenzimet për qëndrimin, qytetin, shtetin dhe adresën përkatëse”.*

²³ [...] Subjekti i ka kërkuar Komisionit të korrigjojë shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit për të gjitha udhëtimet, të cilat janë deklaruar në pyetësorin standard se janë mbuluar nga persona të tretë, për shkak se familja e tij është akomoduar dhe ka qëndruar në banesat e tyre, pa paguar për strehim dhe ushqim. Sipas subjektit, është fakt i njohur se të gjithë qytetarët shqiptarë që udhëtojnë në ShBA, qëndrojnë në shtëpitë e të afërmeve dhe jo në hotel apo vende të tjera alternative dhe, si kusht si për marrjen e vizës, ashtu dhe për lotarinë amerikane, nga

kam shpjeguar edhe më lart. Pra, në procesverbalin e ILDKPKI-së, kam deklaruar përballimin e shpenzimeve të udhëtimit/daljeve dhe jo shpenzimet e qëndrimit.

21.4. Nga analizimi i të gjitha deklarimeve të subjektit në lidhje me shpenzimet e udhëtimit, trupi gjykues konstaton se pyetja e adresuar nga inspektori i ILDKPKI-së është e natyrës së përgjithshme, duke mos iu referuar udhëtimeve konkrete apo duke mos specifikuar nëse i referohet shpenzimeve të udhëtimit (transportit) apo shpenzimeve të qëndrimit jashtë vendit. Vetëm në kuadër të hetimit administrativ të kryer në Komision, pyetjet²⁴ lidhur me udhëtimet jashtë shtetit kanë qenë të specifikuara mbi shpenzimet përkatëse, të cilave subjekti i rivlerësimit u është përgjigjur në mënyrë të detajuar, duke përcaktuar veçmas shpenzimet e udhëtimit (transportit) dhe ato të qëndrimit për çdo udhëtim që ka kryer jashtë vendit, si dhe burimin e mbulimit të tyre. Për këtë arsye, ndryshimet në dukje në deklaratimet e subjektit në pyetësorin *standard* lidhur me burimin e mbulimit të kostove të qëndrimit jashtë vendit, krahasuar me deklaratimet e mëparshme të subjektit para inspektorit të ILDKPKI-së, janë rrjedhojë e mënyrës së formulimit të pyetjeve dhe të kuptuarit të tyre, pyetje të cilat janë plotësuese/detajuese të deklarimeve pranë ILDKPKI-së.

21.5. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik mbi përlllogaritjen e kostos ditore të qëndrimit jashtë vendit, sjellim në vëmendje se Kolegji, në përcaktimin e metodologjisë²⁵ për përlllogaritjen e shpenzimeve të qëndrimit jashtë vendit, ka përcaktuar se për çdo ditë qëndrimi, këto shpenzime, për personat e rritur (18+vjeç), llogariten në vlerën 50 euro/dollarë amerikanë; për fëmijët (5 - 18 vjeç), 25 euro/dollarë amerikanë dhe; për fëmijët (0 deri ditën që mbush 5 vjeç), në vlerën 15 euro/dollarë amerikanë. Por, në rastet kur nga subjekti i rivlerësimit provohet se shpenzimet e qëndrimit për të dhe/ose personat e lidhur me të janë mbuluar nga persona të tretë, atij/atyre do t'u llogariten vetëm sasia e “të hollave të xhepit” prej 5 eurosh/dollarësh amerikanë.

21.6. Sa më sipër, jurisprudenca e konsoliduar e Kolegjit²⁶ e kondicionon aplikimin e standardit të përlllogaritjes së kostos ditore të qëndrimit në shumën 5 USD/dita me të provuarit e mbulimit të shpenzimeve të qëndrimit nga pala e tretë pritëse. Me qëllim identifikimit e bazueshmërisë së deklarimeve të subjektit lidhur me mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe qëndrimit në ShBA nga palët e treta, në raport me dokumentacionin justifikues ligjor të administruar, trupi gjykues konstaton se bashkëlidhur përgjigjes së pyetësorit *standard*, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

(i) Deklaratë noteriale me vulë apostile, datë 02.07.2020, e lëshuar nga shtetasja L. T., e cila konfirmon se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë qëndruar në shtëpinë e saj pa qira, duke i siguruar ushqim dhe nevoja të tjera, nga data 1 gusht 2009 deri në nëntor 2009, kur janë kthyer

ambasada kërkohet garanci ose ftesë nga të afërm që jetojnë në ShBA dhe kanë të ardhura të mjaftueshme, që mund t'i presin dhe t'i akomodojnë në banesë [...].

²⁴ Pyetja nr. 13 e pyetësorit *standard* “ku keni qëndruar gjatë këtyre udhëtimeve jashtë shtetit? Shënoni emrin e hotelit, shpenzimet për qëndrimin, qytetin, shtetin dhe adresën përkatëse”.

²⁵ Shih vendimin nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

²⁶ Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nr. 19/2022 (JR), datë 10.06.2022, prg. 29.7.2; nr. 45/2022 (JR), datë 17.11.2022, paragrafi 77; nr. 54/2023 (JR), datë 19.12.2023, paragrafi 28.7.

në Shqipëri. Në deklaratë specifikohet se: *Valentini qëndroi disa javë dhe, më pas, u largua në Shqipëri, ndërsa gruaja e tij dhe, më vonë vajza e tyre e porsalindur, qëndruan gjatë gjithë kohës, siç u tha më lart.*

(ii) Deklaratë e të ardhurave të kësaj shtetase për vitin 2009, si dhe deklaratën e tatim fitimit për aktivitetin tregtar “{***}”, me ortak O. dhe L. (T.) F., si dhe

(iii) Dokument/titull pronësie i banesës, në emër të shtetases L. (T.) F.

21.7. Trupi gjykues vëren se dokumentet e sipërcituara tregojnë të dhëna për kohëzgjatjen e periudhës së qëndrimit të subjektit dhe bashkëshortes së tij në ShBA dhe mbulimin e kostove përkatëse të qëndrimit përgjatë kësaj periudhe, si dhe se ka informacion mbi: (i) nivelin e të ardhurave vjetore të palës pritëse, si dhe; (ii) posedimin e një banese në pronësi të palës pritëse, duke provuar kështu vendqëndrimin dhe mundësitë akomoduese të tyre. Nga analizimi i deklaratës noteriale, rezulton se pala pritëse, znj. L. (T.) F., ka konfirmuar mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit në ShBA të subjektit dhe të bashkëshortes, për shkak të lidhjeve shoqërore, për periudhën nga 01.08.2009, ndërsa qëndrimi në ShBA i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit daton më herët, më 15.07.2009. Për rrjedhojë, trupi gjykues i llogariti shpenzimet për këtë periudhë dyjavore (15.07.2009 – 01.08.2009) në vlerën 50 euro/dollarë amerikanë për çdo ditë qëndrimi. Ndërsa, për periudhën tjetër 01.08.2009 – 14.11.2009, referuar jurisprudencës së Kolegjit, si edhe dokumentacionit të përcjellë nga subjekti, trupi gjykues vlerësoi t'i llogaritë shpenzimet ditore të qëndrimit në ShBA të subjektit të rivlerësimit, bashkëshortes dhe vajzës së tij të porsalindur, në shumën prej 5 USD/dita për çdo ditë qëndrimi, për secilin²⁷, për rrjedhojë, ky shkak ankimi i Komisionerit Publik gjendet i pabazuar.

21.8. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik në ankim, por edhe qëndrimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në parashtrime, se e gjen të pambështetur vlerësimin e Komisionit mbi rishikimin e mbulimit të një pjese të shpenzimeve të udhëtimit nga babai i bashkëshortes, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrolloi analizën financiare të Komisionit, nga ku rezultoi se në përllogaritjen e udhëtimit datë 18.07.2008 – 27.08.2008, në ShBA, kosto e udhëtimit 600 USD/person nuk është përllogaritur si shpenzim i kryer nga vjehri i subjektit, por nga subjekti dhe bashkëshortja e tij. Në përllogaritjen e udhëtimit datë 21.11.2008 – 24.11.2008, në Itali, kosto e udhëtimit 200 euro²⁸ është përllogaritur si shpenzim i kryer nga bashkëshortja e subjektit dhe jo nga vjehri i subjektit.

21.8/a. Trupi gjykues vëren se reduktimi i vlerës së zërit “shpenzime udhëtimi” për vitin 2008, përllogaritur fillimisht nga Komisioni në rezultatet e hetimit në vlerën 481.892 lekë dhe reduktuar më pas në vendim, vjen si pasojë e përllogaritjes së kostove të qëndrimit në ShBA, nga 50 USD/dita në 5 USD/dita dhe jo nga konsiderimi i shpenzimeve të udhëtimit si të

²⁷ Subjekti i rivlerësimit, për periudhën e qëndrimit 15.07.2009 – 15.08.2009; bashkëshortja e subjektit për periudhën 15.07.2009 – 14.11.2009; vajza V., për periudhën 14.09.2009 – 14.11.2009.

²⁸ 100 Euro është përllogaritur kosto e udhëtimit me traget vajtje-ardhje dhe 100 Euro kosto për 2 ditë qëndrimi. Sipas deklaratimit në pyetësorin standard, bashkëshortja ka udhëtuar për në Itali me traget, e shoqëruar nga prindërit e saj.

mbuluara nga prindërit e bashkëshortes. Për rrjedhojë, në kushtet kur shpenzimet e udhëtimit për vitin 2008, në Komision i janë ngarkuar subjektit të rivlerësimit e personit të lidhur (dhe jo babait të saj), ky pasqyrim u gjet i drejtë nga trupi gjykues, ndaj shkakut i ankimit të Komisionerit Publik u vlerësua i pabazuar.

21.9. Në drejtim të pretendimeve të ngritura nga Komisioneri Publik, për sa i përket shpenzimeve të mundshme mjekësore gjatë shtatzënisë së bashkëshortes dhe lindjes së fëmijëve²⁹ në ShBA, për të cilat Komisioneri Publik në ankim, referuar rekomandimit të ONM-së³⁰, i vlerëson këto shpenzime të konsiderueshme³¹, trupi gjykues fillimisht konstaton se Komisioneri Publik nuk duket sikur ka një kërkesë specifike, të veçantë për këto shpenzime.

21.9/a. Lidhur me pretendimin se subjekti nuk ka deklaruar shpenzime të këtij lloji në asnjë nga deklaratat periodike, as në deklaratën *vetting*, si dhe as përgjatë procesit hetimor administrativ³² në Komision, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk është pyetur posaçërisht nga Komisioni për shpenzime të këtij lloji përgjatë hetimit administrativ dhe, si pasojë, në fashikullin e çështjes nuk janë administruar të dhëna apo dokumentacion në lidhje me to, pasi subjektit nuk i është kaluar barrë prove për këto shpenzime. Madje, as gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore në Komision, Vëzhguesi Ndërkombëtar nuk rezulton t'i ketë drejtuar ndonjë pyetje subjektit lidhur me shpenzimet e lindjes së fëmijëve në ShBA.

21.10. Subjekti i rivlerësimit, në seancën gjyqësore të zhvilluar në Kolegj më datë 21.01.2025, paraqiti si provë të re në proces, e cila u administrua më pas nga Kolegji, përgjigjen nga *Ohio Department of Medicaid*³³ (ODM), e datës 08 maj 2024, sipas së cilës, subjekti kërkonte të vërtetonte faktin se nuk kishte kryer shpenzime për lindjen e fëmijëve në ShBA, pasi ky shërbim mjekësor ishte mundësuar në ShBA nëpërmjet “Medicaid”, i cili është një program i përbashkët federal dhe shtetëror që, së bashku me Programin e Sigurimit Shëndetësor të Fëmijëve (CHIP), ofron mbulim shëndetësor për amerikanët, duke përfshirë fëmijët, gratë shtatzëna, prindërit, të moshuarit dhe individët me aftësi të kufizuara. Në përgjigjen e këtij institucioni, znj. R. C. ka informuar bashkëshorten e subjektit, ndër të tjera, *se sistemi i përdorur në Medicaid në vitet 2009 dhe 2011 nuk është më i përdorshëm nga ODM-ja.*

²⁹ *Vajza V. P. ka lindur më datë 14.09.2009 në Ohio, ShBA. Fëmija i dytë i subjektit, djali D. P., ka lindur më datë 08.12.2011, në Ohio, ShBA.*

³⁰ <https://policyscout.com/health-insurance/learn/costs-childbirth-by-state>

³¹ *Mesatarisht rreth 10.000 USD, në varësi nëse është një lindje normale apo një lindje me operacion cezarian.*

³² *Në përgjigje të pyetjes 9 të pyetësorit nr. 1, për deklarimin nëse ka pasur ndonjë shpenzim më të lartë se 2.500 euro nga momenti i marrjes së detyrës, subjekti nuk ka deklaruar ndonjë shpenzim që lidhet me shtatzënitë dhe lindjen e fëmijëve në ShBA.*

³³ *Medicaid është një program i përbashkët federal dhe shtetëror që, së bashku me Programin e Sigurimit Shëndetësor të Fëmijëve (CHIP), ofron mbulim shëndetësor për amerikanët, duke përfshirë fëmijët, gratë shtatzëna, prindërit, të moshuarit dhe individët me aftësi të kufizuara. Medicaid është burimi i vetëm më i madh i mbulimit shëndetësor në Shtetet e Bashkuara. Për të marrë pjesë në Medicaid, legjislacioni federal kërkon që shtetet të mbulojnë grupe të caktuara individësh, familje me të ardhura të ulëta, shtatzëna dhe fëmijë të kualifikuar si të tillë, si dhe individë që marrin të ardhura shtesë nga sigurimet (SSI). Shtetet kanë opsione shtesë për mbulim dhe mund të zgjedhin të mbulojnë grupe të tjera, të tilla si individët që marrin shërbime në shtëpi dhe në komunitet dhe fëmijët në kujdestari, të cilët nuk janë të kualifikuar ndryshe.*

Megjithatë, MITS³⁴, sistemi i përdorur në shumicën e çështjeve për verifikim, tregon dy periudha të shkurtra kohore për të cilat ju jeni mbuluar nga Ndihma Mjekësore Emergjente e ODM-së (ODM's Alien Emergency Medical Assistance); periudha e parë e ndihmës ka qenë nga 14.09.2009 deri më 16.09.2009, dhe mbulimi dytë ka qenë në periudhën 08.12.2011 – 10.12.2011.

21.11. Trupi gjykues konstaton se periudhat e cituara në këtë përgjigje, lidhur me ndihmën mjekësore që ka përfituar bashkëshortja e subjektit, përkojnë me datat e lindjeve të dy fëmijëve të subjektit, vajza, e lindur më datë 16.09.2009 dhe djali, i lindur më datë 08.12.2011 e, për rrjedhojë, subjekti nuk kishte se çfarë të deklaronte, për sa kohë nuk kishte kryer shpenzime për lindjen e fëmijëve në ShBA. Megjithatë, trupi gjykues, duke mos konstatuar ndonjë kërkesë specifike të Komisionerit Publik në ankim apo edhe në parashtrimet e paraqitura në Kolegj nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme e çmon pa peshë në vlerësimin e çështjes këtë rrethanë të paraqitur nga Komisioneri Publik, referuar rekomandimit të ONM-së.

Lidhur me shkakun e ankimit për “rishikimin e të ardhurave të përfituara nga bashkëshortja në ShBA”

21.12. Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *vetting* dhe deklaratat periodike vjetore, si dhe në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, ka deklaruar vlera të ndryshme të përfituara nga bashkëshortja e tij në ShBA, si në formën e ndihmës / asistencës sociale, ashtu dhe në formën e rimbursimit të taksave. Aktet e depozituara gjatë hetimit administrativ nuk provojnë përfitimin e vlerave të deklaruara dhe pretenduara nga subjekti, vlera të cilat duket se janë marrë në konsideratë nga Komisioni në analizën financiare të rishikuar.

21.12/a. Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë paraqitur prova / akte në mbështetje të pretendimeve të tij gjatë hetimit administrativ, lidhur me shumat e pretenduara si të përfituara nga bashkëshortja në formën e ndihmës sociale, si dokumente zyrtare, lëvizje të llogarive bankare, çek bankar apo ndonjë të dhënë për të mbështetur dhe provuar shumat e pretenduara dhe kohën e tërheqjes së tyre. Komisioneri Publik ka një vlerësim të ndryshëm nga Komisioni edhe në lidhje me rishikimin e shpenzimeve të llogaritura, për sa i përket zërit “shpenzime qiraje”, si pjesë përbërëse e zërave mbi të cilat janë llogaritur kostot e jetesës së familjarëve në ShBA, për sa kohë që edhe vetë shpenzimet e qirasë nga ana e Komisionit janë llogaritur aq sa ka pretenduar subjekti, pa u mbështetur në dokumentacion³⁵.

21.13. Në analizë të shkaqeve të ankimit sa më sipër, trupi gjykues mori fillimisht në shqyrtim pretendimin lidhur me të ardhurat e deklaruara nga rimbursimi i taksave në ShBA nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit. Në deklaratimet periodike pranë ILDKPKI-së dhe

³⁴“MITS”, shkurtim i Medicaid Information Technology System (Sistemi i Teknologjisë së Informacionit Medicaid).

³⁵ Komisioneri Publik referon në vendimin nr. 8/2023 (JR), datë 02.03.2023, prg. 20.10.

deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në rubrikën “*Përshkrimi i të ardhurave*” si vijon:

Në deklaratën e pasurisë *vetting*, rezultojnë të deklaruara të ardhura nga rimbursimi i taksave në vlerën 18.578,31 USD; në DIPPV-në e vitit 2011, vlera e deklaruar është 2.400 USD; në DIPPV-në e vitit 2012, vlera e deklaruar është 1.500 USD; në DIPPV-në e vitit 2013, vlera e deklaruar është 7.836 USD; në DIPPV-në e vitit 2014, vlera e deklaruar është 8.259 USD. Totali i të ardhurave nga rimbursimi i taksave, i deklaruar në deklaratat periodike vjetore 2011 – 2014 rezulton në vlerën 19.995 USD.

21.14. Në kuadër të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për këtë të ardhur, subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision, ka dorëzuar dokumentacionin justifikues në lidhje me kthimin e taksave federale dhe lokale për periudhën 2010 – 2013, nga zyra e shërbim taksave “*HRB Tax Group*” Inc., të noterizuara dhe apostiluara si vijon: (i) *Form 1040A, U.S Individual Income Tax Return, Department of the Treasury - Internal Revenue Service (Formulari 1040A i Deklarimit të të Ardhurave për Individët Amerikanë, Departamenti i Thesarit – Shërbimi i të Ardhurave të Brendshme)* për vitet 2010, 2011, 2012, 2013; (ii) *Form IT 1040 EZ, Ohio Department of Taxation, Individual Income Tax Return for Full-year Ohio Residents*, për vitet 2010, 2011, 2012, 2013.

21.15. Trupi gjykues, nëpërmjet NjShL-së, bazuar në dokumentacionin e mësipërm, kreu verifikimin dhe analizimin³⁶ e tyre, nga i cili rezultoi se për vitin 2010³⁷, subjekti ka përfituar të ardhura nga rimbursimi i taksave federale dhe lokale në vlerën 1.855 USD; për vitin 2011, në vlerën 1.235,25 USD; për vitin 2012, në vlerën 7.533,81 USD, dhe; për vitin 2013, në vlerën 7.953,5 USD. Komisioni ka përlllogaritur si rimbursim nga taksat për vitin 2010, vetëm vlerën 227 USD që i përket “*Local Tax*” (taksave vendore) dhe nuk ka përlllogaritur rimbursimin e kryer nga “*Federal Tax*”, në vlerën 1.892 USD. Gjithashtu, Komisioni, për vitin 2011 dhe vitin 2013, nuk ka zbritur nga të ardhurat e përfituara nga rimbursimi, vlerën e paguar ndaj kompanisë “*{***}*” Inc. (vlerën 221,75\$, për vitin 2011, dhe vlerën 305,5\$ për vitin 2013). Totali i të ardhurave të përfituara nga rimbursimi i taksave për periudhën 2010 – 2013, pas zbritjes së tarifave të shërbimit të paguara ndaj kompanisë së konsulencës “*{***}*” Inc, sipas dokumentacionit të depozituar, rezulton në vlerën 18.577,56 USD, vlerë kjo pothuajse e njëjtë me vlerën 18.578,31 USD, të deklaruar nga subjekti në deklaratën *vetting*.

21.16. Nga sa më lart, trupi gjykues e konsideron të drejtë përlllogaritjen e kryer nga Komisioni, lidhur me rimbursimin e taksave të bashkëshortes së subjektit në ShBA, për sa kohë deklaratimet e subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting*, lidhur me vlerën e të ardhurave me burim nga rimbursimi i taksave, përputhen dhe mbështeten në aktet e administruara gjatë procesit të rivlerësimit në Komision.

³⁶ Në analizën financiare, të ardhurat nga rimbursimi i taksave u përlllogaritën duke u konsideruar të përfituara në vitin pasardhës (taksat e vitit 2010 janë rimbursuar në vitin 2011, e kështu edhe për vitet në vazhdim).

³⁷ Deklaruar në DIPPV-në e vitit pasardhës.

21.17. Lidhur me të ardhurat nga asistenca sociale dhe ndihmat ushqimore, Komisioni ka konkluduar në vendim se: Në përfundim të procesit, pasi u verifikuan edhe një herë dokumentet shkresore të administruara dhe u kryen përlllogaritjet përkatëse, u kryen ndryshimet në analizën financiare të rishikuar në lidhje me të ardhurat në SHBA nga “Cash Issuance History” dhe nga “Assistance Group Eligibility History”.

21.18. Në funksion të këtij konkluzioni, trupi gjykues mori në analizë të gjithë dokumentacionin e administruar përgjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe informacionin që subjekti i rivlerësimit paraqiti në Kolegj, për sa i përket të ardhurave të përfituara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në formën e ndihmës/asistencës sociale në ShBA.

21.19. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, rezultojnë të deklaruara të ardhura nga asistenca sociale për familjen, në vlerën 20.083 USD (18.691 USD + 1.392 USD)³⁸. Në total, vlera e dekluar sipas deklarimeve periodike vjetore³⁹ 2010 – 2014 dhe vitit 2016, të përfituara nga ndihma sociale, rezulton 14.842 USD. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar në total të ardhura nga ndihma sociale në vlerën 21.211 USD.

21.20. Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacionin e mëposhtëm justifikues:

- i. “Cash Issuance History”, për periudhën 25.09.2009 – 2010 (sipas printimit elektronik nga sistemi i hedhjes së pagesave, nga Franklin Department of Job and Family Services, Ohio; printuar nga punonjësja C. M. B.), i noterizuar dhe apostiluar.
- ii. “Assistance Group Eligibility History”, për periudhën 2009 – 2014 (sipas printimit elektronik nga sistemi i hedhjes së pagesave, nga Franklin Department of Job and Family Services, Ohio; printuar nga punonjësja C. M. B.), e noterizuar dhe apostiluar.
- iii. Njoftim vendimi për “Supplemental Nutrition Assistance”, për periudhën 4 tetor 2016 – 31 mars 2017, lëshuar nga Ulster Country Department of Social Services, NY, USA, i noterizuar dhe apostiluar.

21.21. Nga analiza e akteve dhe rrethanave që kanë rezultuar nga hetimi, trupi gjykues konstatoi se, fillimisht këto dy zëra (*cash assistance dhe food stamp – ndihma cash dhe ushqimore*), të përfshira në analizën paraprake të dërguar me rezultatet e hetimit administrativ, kanë qenë të përlllogaritura në shumën totale 9.681 USD, ndërkohë në analizën përfundimtare, këto dy zëra u përlllogariten në shumën totale 21.211 USD, sipas pretendimeve e shpjegimeve

³⁸ Subjekti, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka sqaruar se vlera 1.392 USD i përket periudhës tetor 2016 deri në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*.

³⁹ Në DIPPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar të ardhura nga “cash assistance”, në vlerën 1.497 USD, dhe të ardhura nga “food stamps”, në vlerën 1.160 USD. Në DIPPV-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar të ardhura nga “cash assistance”, në vlerën 1.500 USD, dhe të ardhura nga “food stamps”, në vlerën 900 USD. Në DIPPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar të ardhura nga “cash assistance”, në vlerën 1.480 USD, dhe të ardhura nga “food stamps”, në vlerën 3.120 USD. Në DIPPV-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar të ardhura nga “food stamps”, në vlerën 2.285 USD. Në DIPPV-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar të ardhura nga “food stamps”, në vlerën 1.300 USD. Në DIPPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar të ardhura nga “food stamps”, në vlerën 1.035 USD.

të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit dhe rishpjegimeve të tij pas riçeljes⁴⁰ së hetimit administrativ nga Komisioni, si dhe dokumentacionit të paraqitur në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në parashtrimet e tij në Komision, subjekti i rivlerësimit, përveçse ka shpjeguar natyrën dhe kushtet e përfitimit të të ardhurave nga asistenca me para *cash (cash assistance)*⁴¹ dhe të ardhurave nga asistenca ushqimore (“*the food assistance program*”, njohur ndryshe si “*food stamp*”, sot “*SNAP*”)⁴², ka prapësuar edhe mënyrën e të lexuarit nga Komisioni, të dokumentacionit justifikues të vënë në dispozicion nga ana e tij në lidhje me këto të ardhura, e cila ka sjellë një përllogaritje të të ardhurave në analizën paraprake financiare në vlera më të ulëta se të ardhurat e pretenduara dhe të dokumentuara.

21.22. Për të provuar të ardhurat me burim nga *cash assistace* dhe *food stamps*, subjekti ka paraqitur dy tipologji dokumentesh: (i) dokumenti *Cash Issuance History*, i cili është një dokument që tregon historikun e arkëtimeve *cash* në periudhat përkatëse, dhe i përket periudhave të përfitimit të të ardhurave *cash assistance* për vitet 2009 dhe 2010; (ii) dokumenti *Assistance Group Eligibility History*, që i referohet të ardhurave nga *asistenca ushqimore / food stamps*, në të cilin paraqitet historiku i periudhës së përfitimit të këtyre të ardhurave dhe shuma përkatëse e përfituar. Ky dokument i përket viteve 2009 – 2010, ndërkohë në dosje administrohet dokumentacion edhe për periudhën në vijim 2011 – 2014.

21.23. Trupi gjykues vëren se Komisioni, fillimisht në analizën paraprake, rezulton të ketë bërë mbledhje aritmetike, nominalisht për të ardhurat nga asistenca, vetëm për pjesën e muajit të miratuar dhe për pagesën e muajit të parë të periudhave (disa muaj), në të cilat është miratuar asistenca. Për muajt e tjerë të periudhave, nuk është bërë përllogaritje e të ardhurave mujore të përfituara nga asistenca. Konkretisht, për periudhën (*begin – end – “nisje” – “përfundim”*) 01.11.2009 – 28.02.2010, në analizë paraprake, Komisioni ka përfshirë vetëm vlerën 259 USD, duke e konsideruar këtë vlerë si shumë të përfituar për të gjithë periudhën 4-mujore.

21.24. Në shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se termi *benefit amount* përfaqëson masën mujore të përfitimit muaj pas muaji, gjatë të gjitha periudhave të miratuara.

⁴⁰ Me vendimin e datës 26.12.2023, Komisioni ka vendosur riçeljen e hetimit administrativ, pas të cilit, subjektit, ndër të tjera, i është kërkuar qartësimi dhe saktësimi i mënyrës së përllogaritjes së të ardhurave të siguruar nga “*Cash Issuance History*” dhe nga “*Assistance Group Eligibility*”, në ShBA.

⁴¹ Të ardhurat nga asistenca në para *cash (cash assistance)*, të pasqyruar në dokumentin “*Cash Issuance History*”, përfitohen çdo muaj nëpërmjet kartës “*EPPI Card*” ose direkt në llogarinë bankare. Programi i përfitimit të kësaj të ardhure është deri në 36 muaj dhe i jep mundësi çdo familjeje që jeton në Ohio të përpiqet për të krijuar një stabilitet financiar.

⁴² Të ardhurat nga asistenca në ushqime (“*The Food Assistance Program*”, njohur ndryshe si “*food stamp*”, sot “*SNAP*”) janë të ardhura mujore të përfituara direkt në kartën “*Ohio Direction Card*”, e cila është një kartë speciale për të blerë ushqime dhe përdoret në supermarkete dhe dyqane të përcaktuara. Me këto të ardhura, nuk lejohet të blihen pije alkoolike, karburant, cigare, ushqime për kafshë, ilaçe dhe ushqime të gatshme. Këto të ardhura janë mujore; masa e tyre e përfitimit përcaktohet në disa mënyra. Në muajin e parë të përfitimit të *SNAP-it*, të ardhurat përpjesëtohen në bazë të marrjes së aplikimit nga institucioni dhe përllogariten ditët, nga dita e aplikimit deri në fund të muajit. Për të përpjesëtuar muajin e parë të përfitimeve, agjencia duhet të përcaktojë se sa do të ishte ndarja e ndihmës ushqimore “*SNAP*” për të gjithë muajin (shpjegimi për përfitimin e masës mujore është i përcaktuar sipas metodës së zgjedhur për aplikim). [...] Si bazë përfitimi për të ardhurat nga “*SNAP*” janë të ardhurat e familjarëve në ShBA.

Sipas subjektit, si në vendin tonë, ashtu edhe në ShBA, asistenca përfitohet me bazë mujore. Mënyra e vlerësimit dhe përfshirjes së vlerave të përfituara nga Komisioni nuk ka kuptim logjik dhe ekonomik, që vlera e përfituar për periudhën të përpjesëtohet me numrin e muajve dhe kjo të ndodhë në çdo periudhë miratimi. Nëse i referohemi mënyrës së përfshirjes së të ardhurave nga Komisioni, do të rezultonte se për një periudhë kohore nga 2 dhe më shumë muaj, masa e përfitimit mujor do të ishte rreth 50 USD/muaj. Subjekti i ka kërkuar Komisionit që kjo metodologji përllogaritjeje të aplikohet në mënyrë sistematike për të gjitha vitet 2009 – 2014 që ka përfituar *food stamps*.

21.25. Trupi gjykues, pasi mori në analizë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe qëndrimin përfundimtar të Komisionit në lidhje metodikën e përllogaritjes së të ardhurave nga *cash assistance* dhe *food stamps*, masën e përfituar të të ardhurave, vlerësuar në raport me dokumentacionin e administruar në fashikullin e Komisionit, dhe referencat ligjore të vëna në dispozicion nga subjekti, referenca të tjera të aksesuara nga burime të hapura, si dhe në analizë të kopjeve të manualit elektronik për përfitimin e të ardhurave nga asistenca⁴³, vlerëson se këto janë të ardhura me bazë mujore⁴⁴ dhe, siç evidentohet në manual, ka miratim të masës së përfitimit mujor dhe të periudhës për sa muaj do të merret ky përfitim. Trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, përllogarit totalin e të ardhurave të përfituara në formën e ndihmës/asistencës sociale, në shumën 21.211 USD, konkretisht; (i) të ardhurat e përfituara nga “Cash Insurance History”, për periudhën 2009 – 2010, u përllogaritën në shumën 1.623 USD; (ii) të ardhurat e përfituara nga “Assistance Group Eligibility”, për periudhën 2009 – 2014, u përllogaritën në shumën 18.553 USD; (iii) të ardhurat e përfituara nga “Supplemental Nutrition Assistance”, për periudhën 04.10.2016 – 31.10.2016, u përllogaritën në shumën 1.035 USD.

21.26. Përpos kësaj, referuar burimeve të hapura që japin të dhëna zyrtare mbi kostot minimale të jetesës në ShBA ndër vite⁴⁵, për efekt të llogaritjes së vlerës maksimale të përfitimit nga *food stamps*, duket se masa mujore e të ardhurave të përfituara nga bashkëshortja e subjektit në vitet respektive, të përllogaritura sipas një metodike⁴⁶ që merr për bazë nivelin e të ardhurave mujore neto dhe numrin e pjesëtarëve të familjes⁴⁷, gjendet brenda normave të të ardhurave mujore nga *food stamps*, të miratuara në ShBA në ato vite. Sipas të dhënave publike për vitet 2010 – 2014, masa maksimale mujore e përfitimit për një familje me 1 (një) anëtar është 200

⁴³ Printuar nga faqja zyrtare e internetit e “Department of Job and Family Services”, Ohio, www.emanuals.jfs.ohio.gov, link-u i së cilës nuk është i aksesueshëm.

⁴⁴ <https://emanuals.jfs.ohio.gov/CashFoodAssist/FACM/FAH4000/5101-4-4-27.stm>.

⁴⁵ U.S. Department of Agriculture, Food and Nutrition Service, SNAP, Cost of Living Adjustment (COLA) Information, 2024, <https://www.fns.usda.gov/snap/allotment/COLA>, aksesuar më datë 31.07.2024.

⁴⁶ The amount of food stamps that an AG receives each month is determined by subtracting 30 percent of the AG's net monthly income from the maximum allotment for the appropriate AG size. (see appendix 25-c for Food Stamp Allotment Proration). (Shuma e ndihmës ushqimore që merr një Grup Asistence (AG) çdo muaj përcaktohet duke zbritur 30 për qind të të ardhurave neto mujore të “AG”-së nga përfitimi maksimal për madhësinë e AG-së përkatëse. (shih shtojcën 25-c, për Ndarjen Proporcionale të Ndihmës Ushqimore).

⁴⁷ Një shembull i përllogaritjes së përfitimeve mujore nga “SNAP” për një familje në ShBA, mund të konsultohet në link-un: <https://www.cbpp.org/research/food-assistance/a-quick-guide-to-snap-eligibility-and-benefits>.

USD; me 2 (dy) anëtarë është 367 USD; me 3 (tre) persona është 526 USD dhe me 4 (katër) anëtarë është 668 USD.

21.27. Për sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit, që ka konsideruar në analizën përfundimtare shumën e të ardhurave nga *cash assistance* dhe *food stamps* me bazë mujore për periudhat e miratuara dhe, bazuar në një vlerësim logjik të të dhënave të dokumentacionit dhe në referenca ligjore, kjo shpjegon edhe diferencën midis shumës totale të pretenduar nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit, e ardhur në formën e ndihmës ekonomike / asistencës sociale nga shteti, në shumën 21.211 USD, me atë të përlllogaritur fillimisht nga Komisioni, në shumën rreth 9.681 USD.

21.28. Në konsideratë të shkakut të ankimit të Komisionerit Publik, në lidhje me vlerat e ndryshme që shoqërojnë deklaratimet e këtyre të ardhurave ndër vite, me atë të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, për të ardhurat me burim nga *Assistance Group* dhe *food stamps*, por edhe nga rimbursimi i taksave, trupi gjykues çmon se ato mund të konsiderohen si pasaktësi në deklaram, të karakterit formal, gabime materiale, dhe pa pasoja në këtë proces, në kushtet kur kjo e ardhur është rezultat i mbledhjeve aritmetike të disa zërave / të dhënave të pasqyruara në dokumentet tatimore. Kjo pasaktësi konsiderohet jorevelante, për sa kohë deklaratimet e të ardhurave në deklaratën e pasurisë *vetting* përputhen me dokumentacionin e administruar në dosje.

21.29. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti nuk paraqiti prova të tjera (si *statement bankar* etj.) për të mbështetur pretendimet e tij mbi vlerën e të ardhurave të përfituara nga asistencë sociale, nga analizimi i akteve, rezulton se gjatë procedurës së hetimit administrativ të kryer në Komision, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjes nr. 9 të pyetësorit nr. 2, lidhur me llogaritë bankare jashtë vendit dhe paraqitjen e dokumentacionit justifikues ligjor për kohën e krijimit, lëvizjet dhe gjendjet në këto llogari bankare (përfshirë burimin e të ardhurave), për periudhën kohore deri në vitin 2014, ka sqaruar se: [...] *Në lidhje me llogarinë e pagës së bashkëshortes, e çelur prej saj në vitin 2012, kjo llogari është mbyllur po ana e saj në vitin 2014, kur është kthyer në Shqipëri së bashku me djalin. Nga ky vit deri në vitin 2018, nuk kemi pasur as unë dhe as bashkëshortja një llogari bankare në Amerikë. Për sa i përket dokumentacionit justifikues ligjor të llogarisë së hapur në vitin 2012, nga ana e bashkëshortes sime i është kërkuar bankës "Citizens Bank" informacion për të gjitha të dhënat e llogarisë në emër të saj. Nga ana e bankës, na është kthyer përgjigje se informacioni i kërkuar nuk mund të na vihet në dispozicion pasi kanë kaluar 7 (shtatë) vite nga momenti i transaksionit të fundit dhe gjithë dokumentacioni dhe të dhënat për këtë llogari janë asgjësuar. Lidhur me burimin e të ardhurave, sikundër kam deklaruar në DPV-të periodike, ato burojnë nga punësimi i bashkëshortes sime dhe kthimi i taksave që kryhej çdo vit nga shteti amerikan. Bashkëlidhur përgjigjes së pyetësorit të mësipërm, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar "kthim përgjigjen" e Citizens Bank, datë 23.11.2022, e noterizuar dhe apostiluar, e cila konfirmon se, bazuar në politikat e bankës për mbajtjen e të dhënave deri në një periudhë 7 (shtatë)-vjeçare, të dhënat bankare të znj. F. P. janë pastruar dhe, si pasojë, janë në pamundësi për t'i gjetur në sistemet e bankës.*

21.30. Trupi gjykues çmon se, në kushtet kur transaksionet në formën e ndihmës ekonomike dhe asistencës sociale në një shtet si ShBA kryhen vetëm nëpërmjet sistemit bankar, dhe dokumentacioni i referuar më lart në këtë vendim si: dokumenti nga *Franklin Department of Job and Family Services*, Ohio, nga sistemi i hedhjes së pagesave, printuar nga punonjësja C. M. B., i noterizuar dhe apostiluar; njoftim vendimi për *Supplemental Nutrition Assistance*, lëshuar nga *Ulster County Department of Social Services, NY, U.S.A.*, i noterizuar dhe apostiluar, pasqyrojnë të dhëna të mjaftueshme dhe të besueshme për të provuar përfitimin dhe vlerën e të ardhurave të asistencës sociale nga bashkëshortja e subjektit. Për rrjedhojë, ky shkak ankimi i Komisionerit Publik gjendet i pabazuar.

21.31. Komisioneri Publik në ankim, por edhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në qëndrimin e mbajtur në konkluzionet e paraqitura në Kolegj, e ka konsideruar të padrejtë rishikimin e shpenzimeve të llogaritura, për sa i përket zërit “shpenzime qiraje”, si pjesë përbërëse e zërave mbi të cilat janë llogaritur kostot e jetesës së familjarëve në ShBA, për sa kohë që edhe vetë shpenzimet e qirasë nga ana e Komisionit janë llogaritur aq sa ka pretenduar subjekti, pa u mbështetur në dokumentacion.

21.32. Trupi gjykues, në funksion të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, pasi u njoh me kërkimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, me shpjegimet dhe prapësimet e dhëna lidhur me to nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pasi analizoi dokumentacionin e administruar në Komision, konstaton se:

21.32/a. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në pyetësin standard, si dhe në pyetësin nr. 2, se bashkëshortja e tij, për periudhën nëntor 2011 – prill 2012, ka jetuar me qira, në vlerën 638 USD / muaj, ndërsa për periudhën maj 2012 deri në mes të shkurtit 2014, ka jetuar me qira, në vlerën 500 USD / muaj. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka depozituar⁴⁸ edhe disa komunikime elektronike (*email-e*) të bashkëshortes (të noterizuara dhe apostiluara).

21.32/b. Gjatë hetimit në Komision, ndër të tjera, subjekti ka pretenduar zbritjen nga zëri “shpenzime jetese”, të vlerës korresponduese të qirasë, e cila është përlllogaritur në analizën financiare të kryer edhe si shpenzim më vete, sipas vlerave të qirasë të deklaruara prej subjektit e të cituara më lart. Sipas subjektit, ai nuk mund të ngarkohet dy herë me të njëjtin shpenzim për qiranë, edhe sipas vlerës së deklaruar prej tij, edhe sipas zërave të përfshirë në koston e shpenzimeve të jetesës, sipas të dhënave zyrtare.

21.32/c. Për të mbështetur pretendimin e tij, subjekti ka paraqitur tabelën e pragjeve të njësive konsumatore me dy të rritur dhe dy fëmijë (“*Threshold Component Shares for BLS-DPINR Research Supplemental Poverty Measure (SPM) Thresholds for Consumer Units with Two Adults with Two Children*”), marrë nga faqja zyrtare e të dhënave statistikore të punës në ShBA (U.S. Bureau of Labor Statistics), ku ndër komponentët përbërës të shpenzimeve të jetesës për familjet që jetojnë me qira, janë edhe shpenzimet për strehim/qira. Referuar këtyre

⁴⁸ Në këto komunikime, bashkëshortja e subjektit kërkon informacion lidhur me periudhën dhe vlerën e qirasë, ku sipas përgjigjes, rezulton se, për periudhën 19.10.2011 – 10.05.2012, ka paguar qira në vlerën 638 USD/muaj. Lidhur me periudhën maj 2012 – shkurt 2014, subjekti ka depozituar komunikimin elektronik (*email*) me “{***}”, sipas të cilit, është e pamundur të gjendet dokumentacioni, për shkak të një zjarri të rënë në zyrë në vitin 2016.

të dhënave, pesha specifike që zënë shpenzimet për qira në totalin e shpenzimeve të jetesës, për vitin 2011 është 36%, për vitin 2012 është 35.3%, për vitin 2013 është 36.2%, për vitin 2014 është 36.4%. Në analizën ligjore në vendim, Komisioni i ka gjetur të drejta pretendimet e subjektit dhe nuk e ka ngarkuar atë dy herë për këtë shpenzim.

21.33. Në ankim, ndër të tjera, Komisioneri Publik e mbështet vlerësimin e tij mbi këto të ardhura, edhe në qëndrimin e mbajtur nga Kolegji në jurisprudencën e tij, konkretisht në çështjen (JR) nr. 8/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit K. G. Trupi gjykues konstaton se çështja e cituar nga Komisioneri Publik, ndonëse në dukje paraqet një situatë të krahasueshme me rastin në shqyrtim, nga verifikimet e kryera rezulton se rrethanat e situatës faktike të subjektit lidhur me pagesën e qirasë, u vlerësuan si tërësisht të ndryshme nga rasti i i referuar në ankim si jurisprudencë e Kolegjit, pasi:

a) Në çështjen e referuar nga Komisioneri Publik, pretendimi lidhur me përllogaritjen e saj dy herë në shpenzimet e subjektit u paraqit vetëm gjatë gjykimit të ankimit të Komisionerit Publik në Kolegj, duke u vlerësuar si një përpjekje e subjektit për përmirësimin e situatës financiare të tij, ndryshe nga çështja objekt ankimi, ku nuk shtrohet për diskutim argumenti i rënies në dekadencë të kërtimeve të subjektit të rivlerësimit në Kolegj, për sa kohë pretendimet e subjektit të rivlerësimit për këto shpenzime janë paraqitur me shpjegimet ndaj rezultateve të hetimit paraprak dhe kjo çështje përbën shkak ankimor të ngritur nga Komisioneri Publik.

b) Në çështjen e referuar nga Komisioneri Publik, përllogaritja e Komisionit për shpenzimet e qirasë së një apartamenti bazohej tërësisht dhe vetëm në një vlerë të kërkuar, e potencuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, përfshinte një familje me më shumë se pesë anëtarë madhorë e disa të mitur, e përshkruhej një dinamikë jetese afatgjatë. Vlera e pretenduar si e shpenzuar për qiranë ishte deklarative, pra e pambështetur në asnjë provë dhe indicie, duke e bërë të pabesueshëm versionin e pretenduar nga ai subjekt për pagimin / kryerjen realisht të këtij shpenzimi. Nga ana tjetër, trupi gjykues në atë çështje vendosi të mos e zbriste përqindjen e vlerës së qirasë nga shpenzimet jetike bazike të përllogaritura për subjektin (K. G.), familjen, prindërit, vëllanë dhe bashkëshortët e fëmijët, pasi në analizën tërësore të aspekteve të tjera të rrethanave faktike të tij, pretendohet një vlerë minimale shpenzimesh qiraje dhe jetike në kuadër të një familjeje me tri kurora, 6 deri 7 të rritur dhe, më së paku një fëmijë për një apartament familjar. Në balancën mes shpenzimeve të pretenduara dhe qirasë së paguar, për këto rrethana, trupi gjykues vlerësoi se zbatimi i standardit zyrtar të shpenzimeve dhe qirasë, sikurse e ka deklaruar vetë subjekti i rivlerësimit, ishte zgjidhje e drejtë dhe proporcionale. Në çështjen objekt ankimi, dy marrëdhëniet e qirasë së banesave, nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit konfirmohen nga kompanitë përkatëse. Në një rast, konfirmohet edhe vlera e qirasë së banesës prej 638 USD/muaj, e paguar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, konkretisht për periudhën 19.10.2011 – 10.05.2012. Ndërsa, për periudhën tjetër, maj 2012 – shkurt 2014, është e pamundur të gjendet dokumentacioni, për shkak të një zjarri të rënë në zyrën e administrimit të banesave në vitin 2016, sipas konfirmimit me *email* nga kjo e fundit.

21.34. Në përfundim të analizimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues vlerësoi se, bazuar në provat dhe indiciet e besueshme të referuara⁴⁹ gjatë gjykimit në Kolegj, u provua vlera e qirasë së paguar për periudhën e pretenduar. Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga subjekti në këtë drejtim dhe shpjegimet e tij *konsistente* përgjatë procesit për të konfirmuar vlerën e tyre, kohën në të cilën ato gjejnë zbatim dhe referencën në burimet e hapura⁵⁰, në drejtim të vlerësimit në tërësi të faktorëve që mbështesin panoramën konkrete, në raport me shpenzimet e jetesës sipas dokumentacionit zyrtar, si dhe duke mbajtur në konsideratë rrethanat konkrete të familjes së subjektit, trupi gjykues vlerëson që mënyra e përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës është kryer drejt nga Komisioni. Në kushtet kur përqindja që zë zëri *shpenzime qiraje* në shpenzimet e jetesës është e rëndësishme dhe e ndjeshme në përlllogaritjen e këtij zëri, duke variuar në vite në vlerat 35% - 36% të totalit të shpenzimeve për jetesë, trupi gjykues vlerëson se ngarkesa dy herë për këtë shpenzim do të ishte e padrejtë, pasi do ta vendoste subjektin në një pozitë rënduese në lidhje me situatën e tij financiare.

21.35. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson të drejtë përlllogaritjen e Komisionit mbi shpenzimet e qirasë në ShBA, si pjesë përbërëse të shpenzimeve jetike të familjes së subjektit deri në masën e përcaktuar në indeksin vjetor të shpenzimeve, në përputhje me dokumentacionin e administruar. Për rrjedhojë ky shkak ankimi i Komisionerit Publik gjendet i pabazuar.

22. Lidhur me shkakun e ankimit për moskonsiderimin e shumës prej 4.000 eurosh, të përfituara në lotot sportive në vitin 2010.

22.1. Komisioneri Publik pretendon mospërfshirjen e shumës së përfituar në loto në mesin e burimeve të ligjshme, e cila ka shërbyer më pas për mbulimin e shpenzimeve dhe kursimeve, pasi bie ndesh me jurisprudencën e Kolegjit, dhe subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë përkatësinë dhe ligjshmërinë e këtyre të ardhurave.

22.2. Në lidhje me këtë shkak ankimi, Komisioni në vendim ka arsyetuar se: *Në analizë të parashtrimeve të subjektit, fakteve dhe rrethanave të rezultuara nga hetimi administrativ, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, në përfundim të procesit, Komisioni nuk mund të arrijë në konkluzionin se, shumën e deklaruar si e përfituar nga lotot sportive, është një shumë e përfituar nga ndonjë veprim i kundërligjshëm i subjektit të rivlerësimit.*

⁴⁹Referuar burimeve të hapura lidhur me vlerën mesatare të qirave në këtë zonë - https://www.zillow.com/homedetails/Plumaria-Dr-Gautier-MS-39553/206367700_zpid/, rezulton se qiraja mesatare mujore e tregut të lirë sipas "Home Rent Limits State Ohio 2012", për vitin 2012, për një apartament të ngjashëm me atë të cilin ka marrë subjekti në vitin 2012, në të njëjtën zonë, ka qenë 625 USD. Gjithashtu, nga një kërkim sipërfaqësor në burime të hapura (google maps), me fjalë kyçe "{***}", në shtetin e Ohio-s, rezultojnë të dhëna që provojnë faktin që familja e subjektit ka jetuar në këtë adresë, ku shkruhet shprehimisht: "The most recent tenant is Valentin Preçi" (Qiramarrësi i fundit është Valentin Preçi).

⁵⁰ Referuar burimeve nga faqja zyrtare e të Byrosë së Statistikave të Punës në ShBA (U.S. Bureau Labor Statistics) <https://www.bls.gov/pir/spmhome.htm>, ku ndër komponentët përbërës të shpenzimeve të jetesës për familjet që jetojnë me qira, janë edhe shpenzimet për strehim / qira. Referuar këtyre të dhënave, pesha specifike që zënë shpenzimet për qira në totalin e shpenzimeve të jetesës, për vitin 2011 është 36%, për vitin 2012 është 35.3%, për vitin 2013 është 36.2%, për vitin 2014 është 36.4%.

Komisioni, duke i vlerësuar bindëse provat dhe shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit, vlerësoi që në analizën financiare të rishikuar, shumën 4.000 euro ta konsiderojë si të ardhur për vitin 2010. Por, edhe në rastin e mosmarrjes në konsideratë të këtyre të ardhurave, analiza financiare për vitin 2010 nuk afektohet, pasi në analizën financiare të rishikuar, ky vit rezulton me një balancë pozitive prej 178.289 lekësh.

22.3. Në kuadër të analizimit të këtij shkakut ankimi të Komisionerit Publik, me fokus përkatësinë dhe ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga lotot sportive, trupi gjykues, pasi kontrollon aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi si më poshtë:

22.3/a. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, në rubrikën “Përshkrimi i të ardhurave”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar “të ardhura të fituara pranë kompanisë “{***}” më datë 06.11.2010, nga biletat me numër serie {***}, {***}, {***} dhe {***} (sipas vërtetimit), në vlerën 7.451 euro.

22.3/b. Këtë deklaram, subjekti i rivlerësimit e ka shoqëruar, në kuadër të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, me dokumentacionin justifikues “Vërtetim”, datë 07.11.2010, lëshuar nga kompania “{***}” ShA., që vërteton se shtetasi Valentin Preçi, i identifikuar me kartë identiteti nr. {***} ka fituar neto pranë kompanisë “{***}” në datën 06.11.2010, gjithsej shumën 7.451 euro, nga biletat me numër serie {***}, {***}, {***} dhe {***}. Ky vërtetim është dorëzuar edhe më herët në ILDKPKI, më datë 09.03.2016, në kuadër të kontrollit periodik ndaj subjektit të rivlerësimit.

22.3/c. Në DIPPV-në e vitit 2011, në rubrikën “Të ardhura dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”, subjekti ka deklaruar *fituar lotari sportive te shoqëria “{***}”, datë 06 nëntor 2010, në vlerë 7.451 euro.*

22.3/ç. Gjatë procedurës së hetimit administrativ të kryer në Komision, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjes nr. 10 të pyetësorit nr. 2, të datës 15.12.2022, për të shpjeguar kohën dhe vendin e blerjes së biletave, mënyrën e tërheqjes së shumës, si dhe nëse për këtë shumë ishin paguar detyrimet tatimore, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, është shprehur se: *[...] në datën 06.11.2010, kam qenë së bashku me vëllanë tim, shtetasin A. P., për të pirë një kafe pranë një bar-kafeje, ndodhur te “{***}” (me sa më kujtohet e ka pasur emrin sallon “{***}”). Vëlla im, i apasionuar në sport, vendosi që të tentonte fatin e tij, duke vendosur këto bileta dhe duke përzgjedhur disa ndeshje, duke më kërkuar dhe mua që të merrja pjesë në këto bileta. Me sa më kujtohet, shuma që kam vendosur është 50 euro për të gjitha biletat dhe, të nesërmen, më njoftojnë që i kisha fituar të pesta, duke i tërhequr ato në pikën e ambientit ku mora edhe biletat. Për të konfirmuar këtë fakt, paraqes vërtetimin e lëshuar nga administratori i shoqërisë dhe menaxheri i saj, ku kam tërhequr shumat. Kjo është hera e parë dhe e fundit që kam vendosur bileta. Lidhur me detyrimet tatimore, pasi jam interesuar për pagimin e tyre, më informuan se vlera e detyrimeve tatimore më është mbajtur në burim nga vetë shoqëria [...]. Lidhur me destinacionin e shumës, [...] unë kam mbajtur një shumë të përafërme prej 4.000 eurosh, të cilën e kam shpenzuar po atë vit për shpenzime jetike. Lidhur me pyetjen e fundit, deklaroj se nuk kam marrë pjesë asnjëherë tjetër në lojërat e fatit, përveçse në këtë rast të deklaruar nga ana ime.*

22.4. Trupi gjykues, duke e konsideruar të drejtë dhe bindës arsyetimin dhe konkluzionin e Komisionit në raport me të ardhurën e deklaruar me burim lotot sportive, njëkohësisht i gjen të pabazuara shkaqet e ngritura nga Komisioneri Publik, për arsyet si vijon:

Së pari: Në lidhje me dokumentimin e së ardhurës, Komisioneri Publik nuk mban në konsideratë sjelljen e subjektit të rivlerësimit në raport me këtë fakt dhe përgjegjësinë për të deklaruar çdo të ardhur të siguruar, duke shpjeguar shumën dhe burimin e ligjshëm të krijimit të saj. Nën këto premisa, në DIPPV/2010, si dokumenti i parë kur është siguruar e ardhura, subjekti ka deklaruar shumën konkrete të siguruar, së bashku me dokumentin e lëshuar nga shoqëria e basteve sportive, që specifikon periudhën dhe biletat e rezultuara sportive. Ky dokument me të cilin është pajisur subjekti, është deklaruar edhe në momentin kur është ftuar dhe ka dhënë deklaramë në ILDKPKI, në vitin 2016, si edhe në deklaratën *vetting*, duke u treguar konsistent në çdo rast. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka shpjeguar destinimin e saj, si dhe përdorimin e vlerës së mbetur pas tërheqjes. Në këtë këndvështrim, subjekti ka përmbushur detyrimin ligjor për të deklaruar në mënyrë të saktë të ardhurën e fituar, si dhe identifikuar burimin e saj. Lidhur me këtë situatë faktike, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe përcaktimet e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit, deklaratat e interesave privatë dhe pasurorë mund të përdoren si provë nga Kolegji i Apelit.

Së dyti: Në lidhje me burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave, në bazë të konfirmimit të lëshuar, shuma e përfituar dhe tërhequr prej subjektit përbënte të ardhurën neto, pra atë të mbetur dhe dorëzuar pas mbajtjes së detyrimeve tatimore të pagueshme për këtë fakt. Në analizë të kuadrit ligjor të zbatueshëm, në lidhje me detyrimet tatimore lidhur me këto pagesa në kohën e kryerjes së tyre, referuar nenit 8, shkronja “g” e ligjit për tatimin mbi të ardhurat,⁵¹ të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit konsiderohen e ardhur e tatueshme. Në vijim, referuar nenit 33 “Mbajtja e tatimit në burim”, të këtij ligji dhe kuadrit nënligjor për tatimet⁵² mbi të ardhurat, përcaktohet detyrimi për mbajtjen në burim i tatimit i të ardhurave. Një rregullim më specifik për këtë fushë përcaktohet në ligjin nr. 10033, datë 11.12.2008, “Për lojërat e fatit”, i ndryshuar, ku konkretisht në nenin 44 të tij, me titull “Detyrimet tatimore”, parashikohet se: *1. Fitimet, që organizatori i lojërave të fatit realizon nga ushtrimi i veprimtarisë së tij, janë të tatueshme, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi. 2. Tatim-fitimi i shoqërisë (organizatorit) llogaritet dhe paguhet në bazë të dispozitave të legjislacionit tatimor në fuqi. 3. Të ardhurat, që përfitohen nga lojtarët apo fituesit, që marrin pjesë në lojërat e fatit dhe kazinotë, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale.*

⁵¹ Neni 8, shkronja “g” e ligjit nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, parashikon: *Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme: (g) Të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen.*

⁵² Neni 2.3.9 i Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, parashikon: *“Edhe në rastet kur paguesi i së ardhurës është person juridik dhe fizik i regjistruar në organet tatimore shqiptare ..., tatimi mbahet në burim në masën 10% të pagesës dhe derdhet në organin tatimor përkatës brenda datës 20 të muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa”.*

Neni 2.6.3 i Udhëzimit parashikon: *“Për pagesa të tjera, që lidhen me të ardhurat e listuara në gerrat “b” deri “g”, të nenit 8, paguesi i të ardhurave mban në burim tatimin, sipas tarifave të përmendura në pikën 2.5.2. më lart, dhe e derdh atë në organin tatimor përkatës, jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës”.*

22.5. Nga rrethanat konkrete të rastit, rezulton se subjekti: (i) ka dhënë shpjegime mbi mënyrën e ndarjes së kësaj shume ndërmjet tij dhe vëllait, duke mbajtur vetëm shumën prej 4.000 euro; (ii) për këto të ardhura, ka deklaruar përdorim për shpenzimet e kryera për muajt nëntor dhe dhjetor 2010, pra ato nuk kanë shërbyer për krijimin e kursimeve dhe as të pasurive brenda atij viti ose në vitet vijuese; (iii) deklarimi i shpenzimit të kësaj shume brenda 2 muajve të fundit të vitit 2010, përpos se nuk është materializuar në ndonjë pasuri apo kursim *cash*, në bazë të rregullimit ligjor të kohës, nuk kanë qenë objekt i një deklarimi të tillë, sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003. Në mënyrë të shprehur, detyrimi për deklarimin e shpenzimeve (pavarësisht se edhe në atë rast shuma është më e vogël se 500.000 lekë), ka lindur vetëm pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 85/2012.

22.6. Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik se biletat fituese nuk identifikojnë personin fitues të lotos, trupi gjykues e vlerëson ezaurues sqarimin e subjektit se lotaria sportive, si në vendin tonë ashtu edhe jashtë, nuk identifikon në asnjë rast personin fitues të biletës. Personi identifikohet nëpërmjet biletës origjinale, paraqitjes së saj në sportel dhe kontrollit nëse bileta ka dalë ose jo fituese. Në rastin konkret, në kushtet kur menaxheri i pikës së basteve, si dhe administratori shoqërisë, kanë konfirmuar autenticitetin e biletave dhe shumën e përfituar prej tyre, pretendimi i Komisionerit Publik është i pabazuar.

22.7. Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik se qëndrimi i Komisionit mbi konsiderimin e shumës prej 4.000 eurosh në vitin 2010, në mesin e burimeve të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve dhe kursimeve, bie ndesh me jurisprudencën e Kolegjit⁵³, trupi gjykues konstaton se përpjekja e Komisionerit Publik për ta paraqitur situatën faktike të çështjes / deklarimit të subjektit, në raport me vendimmarrjen e Kolegjit përmes vendimit nr. 8/2018 (JR), nuk është e drejtë, pasi gjendemi përpara rasteve të ndryshme, për arsye se:

a) Në çështjen që merret si referencë nga Komisioneri Publik, bëhet fjalë për të ardhura që pretendohen të fituara nga lotot sportive, mbi baza tërësisht deklarative, pa asnjë të dhënë konkrete të verifikueshme nga institucionet e rivlerësimit, ato tatimore apo agjencitë e lojërave të fatit. Sasia e shumës të përfituar ka qenë në një masë të konsiderueshme⁵⁴ dhe ato kanë shërbyer si burim për krijimin e një pasurie të paluajtshme, në emër të subjektit të rivlerësimit. Deklarimet e subjektit kanë qenë kontradiktore, pasi njëherë subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar këto ardhura nga lotaritë sportive si të ardhura të krijuara nga vetë ai, në deklaratën periodike të vitit 2003, duke konfirmuar të njëjtin deklarim në deklaratën e pasurisë *vetting* në vitin 2017, ndërkohë që në ankim ka ndryshuar qëndrim, duke pretenduar se këto të ardhura janë krijuar nga lotaritë sportive të fituara nga i biri.

b) Ndërsa, në çështjen objekt shqyrtimi, shuma e përfituar nga lotot sportive nuk rezulton të ketë shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie, subjekti i ka deklaruar këto të ardhura në DPV-në e vitit 2011, madje deklarimet e tij mbi përkatësinë e të ardhurave mbështeten

⁵³ Komisioneri Publik i referohet vendimit nr. 8/2018 (JR) të KPA-së, që i përket subjektit të rivlerësimit L. K., konkretisht paragrafi 46.

⁵⁴ Nga vendimi, deduktohet se si burim për blerjen e një apartamenti kanë shërbyer, ndër të tjera, edhe të ardhurat nga lotot sportive, afërsisht në vlerën 3.600.000 lekë.

edhe në vërtetimin⁵⁵ e kohës, i paraqitur nga subjekti, ku përcaktohen gjeneralitetet e subjektit dhe të dhënat e kartës së identitetit. Deklarimet e subjektit kanë qenë konsistente në të gjitha rastet që është pyetur mbi këtë të ardhur dhe shpjegimet e dhëna prej tij kanë qenë konkrete, mbi kohën e përfitimit, vendin, shumën dhe destinacionin e saj. Gjithashtu, rezulton që ky të jetë një rast sporadik, i izoluar, i subjektit të rivlerësimit, në krijimin e të ardhurave nga lojërat e fatit.

22.8. Në konkluzion të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues çmon se Komisioni ka bërë një vlerësim korrekt dhe objektiv të rrethanave të faktit, duke ndarë në mënyrë të qartë përgjegjësinë në raport me këtë deklaram, dhe konfirmuar provueshmërinë nga ana e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e subjektit deklarues, si të komponentit të deklaramit në kohën e përfitimit të së ardhurës, ashtu edhe të identifikimit të ligjshmërisë së saj. Të gjitha të dhënat e deklaruara prej subjektit, përfshirë dokumentacionin e lëshuar nga shoqëria tregtare, përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për të verifikuar, hetuar e konkluduar në raport me ekzistencën e kësaj të ardhure, marrjen në dorëzim të saj, si edhe të aplikimit të çdo mase ligjore për të përlogaritur e mbajtur në burim detyrimet e lindura.

22.9. Në një vlerësim harmonik të provave e rrethanave të mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit gjeti bindës dhe të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit dhe, ashtu si Komisioni, vlerësoi ta konsiderojë shumën prej 4.000 eurosh si të ardhur në analizën financiare të vitit përkatës. Por, edhe në versionin e mospërfshirjes së saj në analizën financiare, rezultati financiar i vitit 2010 rezulton sërish me balancë pozitive.

23. Lidhur me shkakun e ankimit për kursimet e deklaruara në gjendjen *cash*:

23.1. Komisioneri Publik, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit⁵⁶, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni në lidhje me trajtimin e zërave të pasurive: “apartament banimi me sipërfaqe 84.54 m²” dhe “garazh me sipërfaqe 14 m²”, për atë kohë sa, nga analiza financiare rezulton se kursimet e deklaruara në *cash* nuk mbulohej nga burime të ligjshme dhe, në përputhje me kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, këto kursime të deklaruara, sipas Komisionerit Publik, nuk mund të shërbejnë si burim krijimi për mbulimin e shpenzimeve apo krijimin e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme në vitet e mëpasshme.

23.2. Në funksion të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, me qëllim identifikimin e saktë të gjendjes së likuiditetit *cash* ndër vite, u analizua mënyra e deklaramit të subjektit të rivlerësimit në deklaramtën e pasurisë *vetting* dhe në deklaramtat periodike vjetore, nga e cila rezultoi se:

23.2/a. Në deklaramtën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime *cash* nga të ardhurat e familjes, në vlerën 10.200 USD, kursime *cash* në lekë nga të ardhurat e familjes, në vlerën 70.000 lekë.

⁵⁵ Ky dokument, fillimisht është dorëzuar më parë pranë ILDKPKI-së, më datë 09.03.2016, si dhe bashkëlidhur deklaramtës *vetting*.

⁵⁶ Referohuni arsytimit mbi kursimet *cash* në vendimin nr. 18/2022 (JR), prg. 31 e në vijim; vendimit nr. 26/2022 (JR).

23.2/b. Në deklaratat e interesave periodikë vjetorë, subjekti ka deklaruar: në DIPPV / 2005: gjendje cash në shtëpi, e përfituar nga kursimet e pagës, vlera 200.000 lekë; në DIPPV / 2006: 500.000 lekë gjendje cash; në DIPPV / 2007: shtuar gjendja cash nga të ardhurat e përfituara nga paga për vitin 2007, në shumën 700.000 lekë; në DIPPV / 2008: pakësuar gjendja cash e deklaruar më parë dhe përdorur për blerje apartamenti, në shumën 1.250.000 lekë, gjendje cash në fund të vitit nga kursimet e të ardhurave familjare vjetore, 400.000 lekë; në DIPPV / 2009: pakësuar gjendja cash në shumën 400.000 lekë; në DIPPV / 2010: kursime nga të ardhurat familjare cash dhe në bankë (kartë “Gold” e bashkëshortes në ShBA), shuma, rreth 3.700 USD dhe 50.000 lekë; në DIPPV / 2011: kursyer nga të ardhurat familjare cash gjatë vitit 2011, në shumën 2.000 USD; në DIPPV 2012: gjendje likuiditetet në lekë, të kursyera për vitin 2012, në shumën 200.000 lekë; -- gjendja cash në shtëpi nga kursimet e familjes në ShBA, shuma 6.000 USD; në DIPPV 2013: gjendje likuiditetet në lekë, të kursyera për vitin 2013, në shumën 250.000 lekë, gjendje cash në shtëpi nga kursimet e familjes në ShBA për vitin 2013, shuma 11.000 USD; në DIPPV / 2014, subjekti nuk ka deklaruar shtesa/pakësim/gjendje likuiditete cash në banesë; në DIPPV / 2015: pakësuar gjendja cash, në shumën 400.000 lekë; në DIPPV / 2016: pakësuar gjendja cash e deklaruar më parë, në shumën 130.000 lekë, -- pakësuar gjendja cash e deklaruar, në vlerën 12.500 USD.

23.3. Në lidhje me trajtimin e kursimeve cash të vitit 2012, nëse këto deklarime të subjektit i referohen kursimeve të vitit korrent (shtesa) apo kursimeve totale cash deri në atë vit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e dorëzuara në Kolegj, sa i takon ecurisë së likuiditeteve cash deri në datën 31.12.2016, i referohet shpjegimeve që ka dhënë në përgjigje të rezultateve të hetimit në Komision⁵⁷.

23.4. Në një vështrim krahasues, për sa i përket deklarimit të subjektit në DIPPV-në e vitit 2012⁵⁸, në raport me deklarimet e mëparshme të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave periodikë vjetorë, duket se subjekti e ka pasur të qartë mënyrën e deklarimit në to, pasi, në disa raste ka specifikuar në deklarim, “shtuar gjendja cash” dhe “pakësuar gjendja cash”. Në kushtet kur në deklarimin e DIPPV-së së vitit 2012, subjekti ka deklaruar vetëm gjendje cash në shtëpi, në shumën 6.000 USD, në këtë logjikë të deklarimit, duhet konsideruar se të gjitha kursimet në fund të vitit 2012 kanë qenë në shumën 6.000 USD. Nga sa më lart, trupi gjykues, në një lexim të kujdesshëm të deklarimit të subjektit në deklaratën⁵⁹ e interesave

⁵⁷ Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit në Komision, ka shprehur dakordësi me analizën e kryer nga Komisioni për shtesat dhe pakësimet e deklaruara çdo vit, por ka kundërshtuar mënyrën e llogaritjes së tyre, referuar deklarimit të vitit 2012. Subjekti, duke cituar deklarimin e tij në DIPPV-në për vitin 2012, pretendon se këtë vit ka pasur shtesë të kursimeve cash në shumën 6.000 USD dhe jo se gjendja e të gjitha kursimeve ka qenë 6.000 USD.

⁵⁸ Subjekti i rivlerësimit, në DIPPV-në e vitit 2012, në rubrikën “Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit”, deklaron: (i) gjendje likuiditetesh në lekë, të kursyera për vitin 2012, në vlerën 200.000 lekë, pjesë takuese 100%; (ii) gjendje cash në shtëpi nga kursimet e familjes në ShBA, në vlerën 6.000 USD, pjesa takuese 100%.

⁵⁹ Subjektet deklaruese, në zbatim të dispozitave ligjore, lidhur me deklarimin e pasurive dhe interesave privatë, në deklarimin periodik të tyre, duhet të deklarojnë shtesat dhe pakësimet në pasuritë e tyre, krahasuar me deklarimin e mëparshëm. Përveç përcaktimit shprehimisht të objektit të deklarimit në nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, në rubrikën “Deklarimi i interesave privatë” jepen shpjegime të qarta se, në deklarim duhet të pasqyrohen shtesat dhe ndryshimet e interesave pasurore, përfshirë gjendjen cash, llogari rrjedhëse, depozitë etj.

periodikë të vitit 2012, e gjeti të bazuar pretendimin e Komisionerit Publik për përlllogaritjen e vlerës së deklaruar prej 6.000 USD në këtë deklaratë, si *gjendje* të akumuluar të kursimeve *cash* deri më 31.12.2012 dhe jo si *shtesë* të krijuar përgjatë vitit 2012.

23.5. Lidhur me pretendimin e ngritur nga Komisioneri Publik, se *të ardhurat e deklaruara prej subjektit në gjendjen cash, përgjatë viteve në DIPP-të respektive, nuk duhet të përlllogariten si burim për krijimin e pasurive*, trupi gjykues vëren se ky shkak ankimi, në thelb, nuk përbën një pretendim konkret për vite të caktuara deklarimi sipas DIPPV-ve, por vetëm rezultat logjik, pasi do të mund të merrej në konsideratë, vetëm në hipotezën e eventualitetit të pranimit të shkaqeve të ankimit të pretenduara prej tij.

23.6. Lidhur me deklarinimet e gjendjes *cash* dhe ligjshmërinë e tyre, trupit gjykues, nga kontrolli i analizës financiare, pasi reflektoi në të qëndrimet e mësipërme, i rezultoi se kursimet e deklaruara në *cash* ndër vite nga subjekti i rivlerësimit mbulohen nga burime të ligjshme, në përputhje me kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, këto kursime të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* vlerësohen se kanë shërbyer si burim krijimi për mbulimin e shpenzimeve apo krijimin e pasurive të paluajtshme apo të luajtshme. Në këto kushte, ky shkak ankimi, *ipso jure*, rezulton i pabazuar si derivat i rrëzimit të shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik të analizuara si më lart, duke mos i bërë të cenueshme vlerësimet dhe konkluzionet e Komisionit (përpos pasaktësive materiale në analizën financiare të këtij të fundit, për të cilën është kryer korrigjimi në Kolegj).

23.7. Në përfundim të kontrollit për kriterin e rivlerësimit të pasurisë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e kriterit të pasurisë. Deklarimet e tij për burimet e përdorura për financimin e pasurive “*apartament banimi me sipërfaqe 84.54 m²*” dhe “*garazh me sipërfaqe 14 m²*”, ndodhur në {***}, Tiranë, janë në harmoni me deklarinimet e tij në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe se, referuar analizës financiare, subjekti ka justifikuar krijimin e pasurisë me të ardhura të ligjshme. Mungesa e burimeve financiare të ligjshme për analizën financiare të periudhës 2003 – 2016, në shumën prej (-) 348.692 lekësh, u vlerësua nga trupi gjykues thuasje e papërfillshme, duke mos u konsideruar se e vendoste subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarinimit të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, pretendimet e paraqitura në ankim nga Komisioneri Publik dhe qëndrimi i mbajtur gjatë seancave gjyqësore në Kolegj nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, u vlerësuan të pabazuara.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e kontrollit të figurës

24. Komisioni, lidhur me kontrollin e kriterit të figurës, ka arritur në përfundimin se: *subjekti i rivlerësimit Valentin Preçi ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarinimit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element, që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës [...].*

24.1. Nga analizimi i akteve të dosjes së Komisionit, trupi gjykues konstaton se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka dërguar informacion⁶⁰ lidhur me të dhënat në sistemin TIMS, përfshirë automjetet / targat me të cilat ka udhëtuar subjekti i rivlerësimit, personi i lidhur, si dhe personat e tjerë që kanë lëvizur me këto automjete. Ndër udhëtimet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, janë evidentuar dy episode, konkretisht: (1) më datë 24.06.2012, ora 00:46, është regjistruar dalje me mjetin me targa {***}, ku në kolonën shofer është regjistruar shtetasi *A. F.* dhe si pasagjer, subjekti i rivlerësimit, së bashku me dy persona shoqërues⁶¹, me vend kalim kufitar “pika kufitare Murriqan” dhe hyrje në territorin shqiptar të subjektit të rivlerësimit në të njëjtën datë, në orën 03:59, me të njëjtin automjet, të njëjtin shtetas si shofer dhe të njëjtët persona shoqërues; (2) më datë 17.07.2012, ora 20:38, është regjistruar dalje me mjetin me targa {***}, me dy persona, ku në kolonën shofer është regjistruar shtetasi *M. F.* dhe si pasagjer, subjekti i rivlerësimit, me vend kalim kufitar “pika kufitare Morinë”.

24.2. Subjekti i rivlerësimit, në pyetësorin standard, datë 10.07.2020, lidhur me udhëtimet e kryera jashtë shtetit, ndër të tjera, ka deklaruar se:

[...] datë 24.06.2012, udhëtim në Mal të Zi, brenda ditës. Kam udhëtuar me z. A. F., i cili po shkonte për arsyet e tij në Mal të Zi. Rastësisht kam mësuar se kishte për të shkuar në Mal të Zi dhe i kam kërkuar të udhëtoj me të, me qëllim për t'i dërguar një pako me medikamente mikut tim E. M. [...].

Për udhëtimin e datës 17.07.2012 : *[...] udhëtim në Prizren me shtetasin M. F. Takimi ishte i rastësishëm dhe, meqenëse erdha në dijeni të udhëtimit të tij, mendova të shkoja, me qëllim të shihja qytetin e Prizrenit [...].*

24.3. Komisioni ka arritur në përfundimin se: *[...] subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime që cenojnë figurën, etikën dhe integritetin e tij si magjistrat [...], dhe rendit⁶² ato rrethana që e kanë bindur Komisionin, të cilat mund të grupohen si vijon: [...] subjekti i ka deklaruar vetë këto dy udhëtime në pyetësorin standard; takimi ka qenë rastësor dhe ka ndodhur kohë përpara se ata shtetas të ekspozoheshin politikisht apo të procedoheshin penalisht dhe se të dhënat e organeve ligjzbatuese [...] nuk kanë provuar kontakte apo komunikime elektronike / telefonike, udhëtime të tjera të subjektit me këta shtetas.*

24.4. Komisioneri Publik, referuar të dhënave publike pasqyruar gjerësisht, publikisht dhe, shpeshherë pas vitit 2013, ka konstatuar se të dy shtetasit, *M. F.* dhe *A. F.*, kanë qenë subjekte të hetimeve penale dhe dënimeve, në zbatim të vendimeve gjyqësore për kryerjen e veprave penale me rrezikshmëri të lartë. Sipas Komisionerit Publik, këto rrethana duhet të ndërjegjësonin subjektin e rivlerësimit, aq më tepër në funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në juridiksionin tokësor të së cilës kanë ndodhur ngjarjet / veprat penale, të deklaronte në deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, faktin e udhëtimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në periudhën qershor –

⁶⁰ Shkresë nr. {***} prot., datë 30.06.2020, protokolluar në Komision me nr. {***}, datë 01.07.2020.

⁶¹ Në automjet, së bashku me subjektin e rivlerësimit dhe *A. F.*, kanë udhëtuar edhe personat shoqërues, *A. G.* dhe *J. SH.*

⁶² Referohuni faqes 74 të vendimit të Komisionit.

korrik 2012, në dy episode të ndara me këta shtetas. Deklarimi nga subjekti i rivlerësimit do t'u mundësonte autoriteteve verifikuese, fillimisht kryerjen e hetimeve përkatëse dhe arritjen në përfundimin përkatës, në harmoni me rrethanat e faktit, nëse ekzistonte apo jo kontakti i papërshtatshëm.

24.5. Në Rekomandimin e ONM-së, datë 23.04.2024, ndër të tjera, parashtrohet si në vijim: [...] Për sa i përket këtyre takimeve të rastësishme, është me rëndësi të theksohet se nuk ka pasur një analizë të kontakteve dhe historisë së tyre; Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit nëse ai duhej apo nuk duhej të deklaronte kontaktet në deklaratën e kontrollit të figurës dhe, në mungesë të një analize kritike, me lehtësi arriti në përfundimin e mungesës së problematikave. Është kërkesë ligjore që subjekti i rivlerësimit duhet të tregojë për kontaktet e mundshme të papërshtatshme, veçanërisht përderisa një nga vëllezërit, sipas informacioneve publike nga burime të faqeve digjitale të lajmeve, ishte i akuzuar më parë për shfrytëzim të prostitucionit dhe pastrim të parave. Në këndvështrimin tonë, subjekti i rivlerësimit dështoi të përmbushte këtë detyrim. Mungon gjithashtu analiza, nëse formalisht ai [subjekti i rivlerësimit] ka dështuar të deklarojë kontaktet dhe se a mund të kualifikohet kjo sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu mungon një vlerësim i kujdesshëm i natyrës reale të këtyre kontakteve. Komisioni, bazuar vetëm në shpjegimet e subjektit, në mënyrë të parakohshme, ka arritur në përfundimin se këto ishin kontakte të rastësishme, pa kryer një vlerësim të hollësishëm. Komisioni duhet të ndiqte një qasje më tepër kritike dhe të vlerësonte nëse këta individë ishin akuzuar si persona të përfshirë në krimin e organizuar, dhe si dhe apo plotësisht kjo do të afektonte pozitën e subjektit të rivlerësimit si magjistrat. Duke pasur parasysh famën e familjes F., një vëzhgues i zakonshëm ka të ngjarë të mos jetë dakord që një magjistrat të udhëtojë me individë të tillë [...].

24.6. Komisioneri Publik, në konsideratë të rekomandimit të ONM-së, konstaton se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm, edhe për kriterin e kontrollit të figurës, parashikuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka plotësuar saktë "Deklaratën për kontrollin e figurës", sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kontaktet me shtetasin M. F., i cili rezulton si person i përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016.

24.7. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna gjatë seancave gjyqësore të zhvilluara në Kolegj, ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse në Komision, lidhur me arsyet dhe qëllimin e udhëtimeve njëditore me këta shtetas, duke i konsideruar krejt rastësore dhe të vetme. Subjekti pretendon se takimet me shtetasit A. F. dhe M. F., përkatësisht në qershor dhe korrik të vitit 2012, nuk plotësojnë kriteret për t'i kualifikuar ata si kontakte të papërshtatshme, në kuptim të ligjit (neneve 3/6, 3/15 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016). Prandaj, sipas tij, nuk ka ekzistuar detyrimi për t'i deklaruar në deklaratën e kontrollit të figurës.

24.8. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në ankimin e paraqitur, Komisioneri Publik: (i) ka shmangur tërësisht nga vlerësimi rrethanën, që mban parasysh në konstatimin e kontaktit të papërshtatshëm (duke mos arsyetuar në asnjë moment mënyrën se si ai e klasifikon të plotësuar këtë kriter, sipas neneve 3/6, dhe 38/4 të ligjit) e, në eventualitetin se do ta vlerësonte të plotësuar këtë kusht, përsëri, (ii) ka shmangur tërësisht nga vlerësimi mungesën e

rrethanave lehtësuese, sipas pikave 5 dhe 7 të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016 (se si nuk plotësohen eventualisht kriteret e pikave 5/a dhe 7/d të nenit 38 të këtij ligji). Plotësimi i këtyre kërkesave, sipas subjektit, përbën obligim, që vlerësuesi (sipas rastit Komisioni ose Komisioneri Publik) duhet të plotësojë detyrimisht, në çdo rast kur pretendon ekzistencën objektive të një kontakti të papërshtatshëm. Pasoja në rastin e mungesës së këtyre dy analizave, sipas eventualitetit që paraqitet, është ajo e paplotësisë dhe, për rrjedhojë, pabazueshmërisë së një pretendimi / vlerësimi / apo shkaku ankimi të tillë.

24.9. Në kuadër të analizimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstaton fillimisht se pretendimi i Komisionerit Publik lidhur me këtë kriter nuk ka të bëjë me ekzistencën e një kontakti të papërshtatshëm të subjektit të rivlerësimit apo rrethit të familjarëve të përcaktuar nga neni 39 i ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, por duke e klasifikuar me deklarin e pamjaftueshëm të kriterit të kontrollit të figurës, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit, sa i përket mosdeklarimit nga subjekti i rivlerësimit të faktit se ai ka pasur kontakte me një person të përfshirë në krimin e organizuar, z. M. F., me të cilin ka udhëtuar në Prizren, në korrik të vitit 2012.

24.10. Në funksion të zgjidhjes së situatës së paraqitur në këtë shkaku ankimi, në raport me mënyrën se si ka konkluduar Komisioni në vendim, çështjet që shtrohen për analizë para trupit gjykues janë:

(i) *A kualifikohet udhëtimi me shtetasin M. F. si kontakt i papërshtatshëm, në kuptim të ligjit nr. 84/2016?*

(ii) *A ndodhej subjekti në kushtet që do të duhej të deklaronte në deklaratën e kontrollit të figurës të dhëna për kontaktin me këtë individ?*

(iii) *A gjendemi para situatës ku rrethanat lidhur me udhëtimet e subjektit të rivlerësimit me këta dy individë mund të çmohen me pasojë në drejtim të treguesit të “etikës” së magjistratit?*

24.11. Trupi gjykues vëren se, nga raporti i DSIK-së, nuk rezulton të ketë informacion dhe të dhëna konkrete për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që formulari i kontrollit të figurës nuk është i plotë dhe i besueshëm, sipas përcaktimeve të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 38 dhe 39 të ligjit nr. 84/2016. Lidhur me standardet dhe procedurat e kontrollit të figurës, në përfundim, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit.

24.12. Në deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës nr. 3 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur me “jo” pyetjes së mëposhtme: “c. A keni pasur kontakte të papërshtatshme në formën e një takimi, komunikimi elektronik ose çfarëdoq mënyre tjetër takimi të qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës?”.

24.12/a. Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje, trupi gjykues çmon se duhet mbajtur në konsideratë e gjithë situata faktike dhe ligjore, në kohën kur janë realizuar takimet e subjektit me personat në fjalë, e konkretisht: i) konceptin se çfarë nënkupton një kontakt i papërshtatshëm; ii) dijenia në momentin e takimit, nisur jo vetëm nga bindja e tij, por edhe të dhënat objektive të verifikueshme në kohën e udhëtimit; iii) sjellja dhe ecuria e veprimeve të subjektit, pas rënies në kontakt me të dhënat publike pas ndodhjes së takimit.

24.13. Nisur nga pretendimet e ngritura në ankim, trupi gjykues vëren se konceptet juridike mbi atë se çfarë nënkupton kontakt i papërshtatshëm, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, dhe qëllimit të tij dhe mbi bazën e këtij koncepti, cili është detyrimi i subjektit të rivlerësimit në raport me formularin për kontrollin e figurës, duhen sqaruar në raport me shkallën e aplikimit të këtyre normave, me rastin objekt gjykimi, konkretisht:

24.13/a. Koncepti mbi kontaktin e papërshtatshëm jepet në nenin 3, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, duke evidentuar si elemente të domosdoshme të tij: i) takimin/komunikimin e qëllimshëm; ii) papajtueshmërinë me detyrën e tij; si dhe rrethanat e pikës 4, germa “d”, paragrafi i dytë i nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, duke u evidentuar posaçërisht: iii) takimi jorastësor, dhe iv) publiciteti (dijenia e hetimit/dënimit për një vepër, sipas nenit 3/15 të ligjit nr. 84/2016), përmes njohjes, publikimit, ose dokumentimit në regjistrat përkatës.

24.13/b. Sipas këtyre përcaktimeve të qarta në ligj, në kuptim të tij, një takim, për t’u cilësuar si “kontakt i papërshtatshëm” duhet që: i) takimi të mos jetë rastësor (i paqëllimshëm); ii) në momentin e realizimit të takimit / kontaktit, personi i dyshuar / hetuar / dënuar, të jetë i tillë për një nga veprat penale të parashikuara në nenin 3, pika 1 e ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar...” (si një referim i nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016); iii) subjekti i rivlerësimit të ketë dijeni për ekzistencën e një hetimi/dënimi, ndaj personit që po e takon jorastësisht, dhe iv) hetimi/dënimi i të kontaktuarit të ketë publicitetin e duhur përmes njohjes, publikimit ose dokumentimit në regjistra publikë.

24.13/c. Elementet e mësipërme ligjore kornizohen në elementin objektiv (ku përfshihet hetimi/dënimi i personit në momentin e takimit) dhe elementin subjektiv (ku përfshihet dijenia e subjektit të rivlerësimit për dënimin e të takuarit/kontaktuarit), dijeni, e cila prezumohet në rastin kur të dhënat e dënimit janë ose duhet të jenë të njohura, publikuara ose dokumentuara në regjistrat përkatës.

24.13/d. Vetëm në kushtet e plotësimit të njëkohshëm të këtyre dy elementeve, konfirmohet nevoja për të analizuar nëse takimi ka qenë rastësor apo i qëllimshëm dhe, në varësi të kësaj përgjigjeje, subjektet mbartin detyrimin ligjor të deklarimit në formularin e kontrollit të figurës. Thënë ndryshe, mungesa e njërës prej elementeve objektive / subjektive dhe të natyrës së takimit, pasjell pasojën e mospasjes së një kontakti të papërshtatshëm e, për rrjedhojë, moslindjen e asnjë detyrimi për deklarim në formularin e kontrollit të figurës.

24.14. Nga të dhënat publike, të cilat referohen në ankim edhe nga Komisioneri Publik, lidhur me hetime penale apo vendime gjyqësore penale, pasqyruar gjerësisht, publikisht pas vitit 2013, rezulton se A. F. është hetuar për një vepër të rëndë penale, që ka ndodhur në vitin 2013. Nga ana tjetër, z. M. F. dhe e shkuara e tij janë bërë objekt informacioni mediatik dhe hetuar vetëm në vitin 2015 dhe, në rrethana të cilat kanë pasur për shkas zgjedhjen e tij në një funksion shumë të lartë publik, në Kuvendin e Shqipërisë, si dhe ndryshimet ligjore⁶³, të miratuara në atë kohë.

⁶³ Ligji nr. 138/2025, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar.

24.15. Në lidhje me kalimin në kufi, në datën 17.07.2012, me shtetasin M. F., subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar, ndër të tjera, se takimi ka qenë rastësor, në biznesin e një të afërmeje të tij, e cila e ka prezantuar me z. M. F., si biznesmen nga zona që është edhe vetë subjekti. Meqenëse M. F. ishte rrugës për në Prizren, për punë të biznesit të tij, dhe kishte vend në makinë, subjekti vendosi të përfitonte nga rasti për të udhëtuar, pasi nuk kishte qenë ndonjëherë në atë qytet. Pas disa orësh, janë ritakuar e kthyer mbrapsht. Sipas subjektit, ky ka qenë takimi i parë dhe i fundit, dhe nuk ka pasur informacion për ekspozim penal apo politik të tij.

24.16. Nga aktet e dosjes, rezulton se në vitin 2015, Prokuroria e Përgjithshme ka vendosur regjistrimin e tri procedimeve penale⁶⁴ në ngarkim të z. M. F.: (i) për veprën penale⁶⁵ “Vrasje me paramendim”, kryer në bashkëpunim në vitin 1999, ku ka rezultuar se ka përdorur më së paku tre emra në Belgjikë; (ii) veprën penale⁶⁶ “Refuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publike”; (iii) për veprën penale⁶⁷ “Ndërtimi i paligjshëm”.

24.16/a. Të tria procedimet e mësipërme janë bashkuar dhe janë dërguar për gjykim nga organi i akuzës. Në përfundim të gjykimit të çështjes⁶⁸, rezulton se shtetasi M. F. është shpallur fajtor dhe dënuar për veprat penale “Refuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarin”, parashikuar nga neni 257/a, paragrafi 2 i Kodit Penal; “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287, germa “b”, paragrafi i parë i Kodit Penal, si dhe “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal. Ndërkohë, për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me paramendim”, kryer në bashkëpunim, është deklaruar i pafajshëm.

24.17. Për sa i përket verifikimit të elementit objektiv, trupi gjykues, referuar të dhënave të bëra publike (pas vitit 2015), si edhe praktikës së letërporosisë së mbajtur ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe autoriteteve ligjzbatuese holandeze, konstatoi se, në vitin 2002, shtetasi P. S. (si një nga katër emrat me të cilët njëhej shtetasi M. F., në bazë të burimeve

⁶⁴ Referuar fakteve të relatuar në pjesën arsyetuese të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr. {***} i vendimi ({***}), datë 26.03.2024, aksesuar në faqen <https://gjykataelarte.gov.al>, datë 16.07.2024.

⁶⁵ Prokuroria e Përgjithshme ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, në Regjistrin e Njoftimeve të Veprave Penale, për veprën penale “Vrasja me paramendim”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 78/1 dhe 25 të Kodit Penal, në ngarkim të këtij shtetasi. Shtetasi M. F. (alias D. F., B. M., P. S.) i atribuohet fakti penal i vrasjes me paramendim në datën 05.03.1999, në Bruksel të Belgjikës, të shtetasi shqiptar A. K., i lindur më 13.01.1975, në Shkodër, Shqipëri, vepër e kryer në bashkëpunim edhe me shtetas të tjerë.

⁶⁶ Më datë 01.04.2015, Prokuroria e Përgjithshme ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, për veprën penale “Refuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasi M. F. Në funksion të hetimit të këtij procedimi, emri i të pandehurit M. F. është regjistruar edhe për veprën penale “Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”⁶⁶, parashikuar nga neni 287/b i Kodit Penal.

⁶⁷ Më datë 16.06.2015, Prokuroria e Përgjithshme ka regjistruar edhe procedimin penal nr. {***}, për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasi M. F.

⁶⁸ Po aty.

të hapura aktuale) është dënuar me 3 (tre) vite burgim për *veprimtarinë kriminale të trafikimit të lëndëve narkotike*. Në vitin 2015, ai është proceduar penalisht dhe dënuar në Shqipëri për veprën penale të *Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*, parashikuar nga neni 287, germa “b”, paragrafi i parë i Kodit Penal.

24.17/a. Trupi gjykues, bazuar në sa më sipër, konstaton se shtetasi M. F. konsiderohet si person *i përfshirë në krimin e organizuar*, në kuptim të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës: *person i përfshirë në krimin e organizuar është personi i dënuar ose i proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.*

24.18. Për të konkluduar mbi këtë çështje, ligji e parashikon të domosdoshme si një *conditio sine qua non* edhe plotësimin e elementit subjektiv, kështu, për t’u konsideruar kontakti i papërshtatshëm, duhet gjithashtu që, në bazë të konceptit të nenit 3, pika 6 dhe nenit 38, pika 4, germa “d”, subjektivisht të provohet dijenia alternative përmes: i) anëtarësisë së njohur; ii) anëtarësisë së publikuar, ose iii) anëtarësia të rezultojë e dokumentuar në regjistrat përkatës.

24.18/a. Lidhur me kushtin e parë, që anëtarësia të jetë e njohur, trupi gjykues vëren se njohja, si një nga format e nevojshme për ta klasifikuar takimin si kontakt me person të papërshtatshëm, duhet që ky subjekt (i papërshtatshmi), të jetë njohur si i tillë, në mënyrë që subjekti i rivlerësimit ta ketë të qartë profilin e personit që takon (krijon kontakt). Kjo njohje duhet të burojë nga rrethana të tjera objektive apo subjektive, të atij niveli dhe standardi, saqë të mos lënë asnjë dyshim se subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të padiskutueshme ka njohje me të kontaktuarin, si dhe faktin e përfshirjes së tij në krim të organizuar. Në rastin konkret, kontakti i vetëm i vetëdeklaruar me shtetasin M. F. është në pyetësinorin standard, pa u evidentuar asnjë lloj tjetër marrëdhënieje e mëpasshme, si dhe në mungesë të çdo lloj rrethane që mund të krijojë dyshim për favorizim në proceset ligjore të këtij personi. Pra, këto janë rrethana që nuk krijojnë dyshim se përse subjekti i rivlerësimit duhet të kishte njohje për një procedurë penale të zhvilluar mbi një fakt më të largët sesa një dekadë nga takimi midis subjektit dhe z. M. F.

24.18/b. Përpos kësaj, për vetë profilin e procedimit / hetimit / dënimit të dhënë, nuk është e mundur as logjikisht që një person i përfshirë në një krim (që, sikurse do të rezultonte më pas, u bë kandidat për deputet), të ishte i prirur që të deklaronte apo të vendoste në dijeni të tretët për ekzistencën e një dënimi të mbi një dekadë më parë, madje jo në emër të tij, por i njohur si z. P. S. dhe, mbi të gjitha, t’ia deklaronte këtë fakt një prokurori (subjektit të rivlerësimit).

24.18/c. Hetimi i Komisionit dhe i organeve ndihmëse për vlerësimin e këtij kriteri provuan gjithashtu se subjekti i rivlerësimit nuk kishte asnjë lidhje familjare / gjaku / krushqie / miqësore, si dhe nuk kishte as lidhje interesi apo lidhje shoqërore me ta. Një rrethanë e tillë u provua edhe nga raporti i Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), i cili konfirmoi se: *Jo vetëm që nuk administrohen prova, por as informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të*

papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimit të organizuar.

24.18/ç. Sa analizuar më lart, nuk rezulton asnjë e dhënë objektive për ekzistencën e njohjes së subjektit të rivlerësimit me personin M. F., si anëtar i krimit të organizuar. Hetimi i thelluar i Komisionit, në bashkëpunim me agjencitë e tjera ligjzbatuese, konfirmuan mungesën e çdo lloj kontakti tjetër më të hershëm apo të mëpasshëm, të deklaruar prej subjektit në pyetësorin standard. Nën këto rrethana, trupi gjykues vlerëson se nuk ekziston forma e parë alternative e elementit subjektiv të dijenisë.

24.18/d. Lidhur me kushtin tjetër të kërkuar, publikimi, në kuptimin e të bërit prezent të një fakti apo rrethane të caktuar, sipas shprehjes në ligj, trupi gjykues vëren se për t'u konsideruar një e dhënë / informacion i publikuar, nënkuptohet paraqitja e tij në një mënyrë të përshtatshme, të aksesueshme për publikun ose për rrethin e personave që kërkon t'u bëhet me dije fakti. Në rastin konkret, që një e dhënë / informacion të konsiderohet i njohur apo publik, duhet që ajo të rezultonte i botuar / publikuar në media apo në rrjete të ndryshme sociale të kohës në çfarëdolloj forme e çfarëdolloj informacioni që, direkt apo indirekt të përcillnin dyshime apo indicie për problematika ligjore (penale) të shtetasit M. F., si i përfshirë në krim dhe, posaçërisht në krim të organizuar brenda ose jashtë vendit.

24.18/dh. Sikurse provohet nga korrespondenca me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, z. M. F. është zgjedhur deputet i Kuvendit të Shqipërisë në vitin 2013, duke qëndruar në këtë funksion deri në nëntor të vitit 2015, kur është larguar me dorëheqje. Prezumimi i tij i pafajshëm dhe i papërfshirë në asnjë veprimtari të paligjshme (e, aq më tepër në krim të organizuar) lind nga parashikimi kushtetues i nenit 71, pika 2, germa “dh”, ku, të qenët i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, përbën shkak për refuzimin e dhënies së mandatit, apo edhe nëse është fituar, përfundon menjëherë, nëse një fakt i tillë ndodh pas marrjes së tij.

24.18/e. Nisur nga prezumimi i mësipërm, trupi gjykues konstaton se, në kohën kur ka ndodhur kontakti, asnjë institucion qendror publik, i pavarur e ligjzbatues në vendin tonë, nuk ka pasur të publikuar asnjë të dhënë penale në ngarkim të shtetasit M. F., si para, ashtu edhe gjatë marrjes së mandatit prej tij në periudhën e viteve 2013 – 2015. Nën këtë kontekst historik dhe kronologjik të ngjarjeve, nuk ka asnjë mundësi objektive që subjekti i rivlerësimit, në korrik të vitit 2012, të kishte pasur dijeni nga të dhëna publike, për ekzistencën e një procedimi / hetimi / dënimi në ngarkim të shtetasit M. F. në një vend të Evropës, të përpara më shumë se një dekadë nga takimi, ndërkohë që të gjitha organet ligjzbatuese në vend nuk kanë verifikuar dhe as publikuar asnjë rrethanë të tillë, deri në atë pikë sa ai të marrë mandatin e deputetit dhe ta ushtrojë atë për më tepër sesa 2 (dy) vite.

24.18/f. Lidhur me kushtin tjetër, dokumentimin në regjistrat publikë, si një nga format nga ku mund të lindë dijenia për ekzistencën e një kontakti të papërshtatshëm, ashtu sikurse ka provuar hetimi i Komisionit e, më pas, aktet e depozituara prej subjektit në Kolegj, për shtetasin M. F., nuk ka ekzistuar asnjë e dhënë që e përfshinte atë në krim të organizuar. Trupi gjykues vëren se, ligjërisht dhe logjikisht, regjistrimi në databaza publike ose të agjencive ligjzbatuese, të cilat referojnë të dhëna konkrete mbi ekzistencën e procedimeve / hetimeve

apo dënimeve ndaj një personi / personave të caktuar, apo të dhëna në regjistra të agjencive të ndryshme përmbajnë indicie në lidhje me përfshirje të personit në krim të organizuar. Pretendimet e para në lidhje me këtë person janë paraqitur vetëm kur filluan verifikimet përmes letërporosisë me autoritetet holandeze, në prill të vitit 2015, periudhë nga e cila kishin kaluar rreth 3 vite nga ngjarja e takimit / kontaktit të subjektit të rivlerësimit me këtë shtetas.

24.19. Në raport me këto të dhëna të debatuar gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, rezultoi e provuar se deri në vitin 2015, të gjitha organet ligjzbatuese kombëtare dhe ato në kontakt me agjencitë e huaja homologe, nuk kanë pasur të dhëna të administruara në regjistrat e tyre mbi procedimin / hetimin / dënimin apo kërkime për ekstradimin e shtetasit M. F., së paku deri në prill të vitit 2015. Duke mos ekzistuar asnjë e dhënë e tillë e regjistruar në regjistrat përkatës publikë apo privatë, kjo e pamundëson dijeninë e subjektit për ekzistencën e një të dhëne, qoftë edhe në formën e dyshimit për problematika penale të shtetasit M. F. në vitin 2012, që i korrespondon kohës së të vetmit takim të zhvilluar.

24.20. Për rrjedhojë të sa më sipër, në lidhje me kontaktin me shtetasin M. F., konkludohet se: (i) Udhëtimi me të është vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit standard, përpara se për një rrethanë të tillë t'i kërkoheshin shpjegime. (ii) Kontakti me këtë person i referohet një periudhe padijenie të plotë për përfshirje eventuale të tij në krim të organizuar në Shqipëri dhe jashtë saj. Kjo padijeni konfirmohet me rrethanat e tjera vijuese të zgjedhjes së tij deputet dhe ushtrimit të këtij funksioni për mbi 2 (dy) vite, duke filluar nga viti 2013. (iii) Nuk rezultoi asnjë takim tjetër, qoftë edhe rastësor, pas atij të udhëtimit disaorësh në korrik të vitit 2012. (iv) Nuk u provua asnjë njohje dhe as lidhje me këtë person, për sa kohë që edhe nga hetimi për më gjatë se 1 (një) vit ndaj tij dhe familjes së tij, nuk rezultoi qoftë edhe i përmendur në bisedat e tij apo rrethit të tij familjar / shoqëror, njohja e, aq më pak, lidhja e ngushtë e pretenduar e subjektit të rivlerësimit me këtë shtetas. (v) Shoqërimi i subjektit me këtë shtetas ka qenë i lidhur ngushtësisht vetëm me rrethanën e deklaruar, duke mbetur i vetëm dhe i kufizuar, në mungesë të çdo kontakti tjetër për gjithë periudhën gati 13 (trembëdhjetë)-vjeçare, që nga ai fakt e deri më sot.

24.21. Në konkluzion të analizës së mësipërme, trupi gjykues çmon se, në rastin konkret, është e pamundur të argumentohet dijenia e subjektit të rivlerësimit dhe, për pasojë, të mbahet qëndrimi që subjekti ishte i ndërgjegjshëm që në vitin 2012 për të shkuarën e z. M. F. Akoma më e vështirë është të argumentohet që ka vend zbatimi i masës disiplinore, për shkak të një dijenie të prezumuar, të pabazuar në asnjë kriter të artikulueshëm objektiv. Rrethanat e bëra të njohura, duke nisur nga viti 2015, kanë treguar se e shkuara e z. M. F. dhe problemet e mëparshme me ligjin jashtë Shqipërisë, për shkak edhe të përdorimit të identiteve të tjera, ishte e panjohur për gjithë strukturat institucionale dhe elektoratit shqiptar, përfshirë edhe atë në zonën nga ku ai u lind e rrit dhe kishte prejardhjen familja e tij. Z. M. F. ishte deputet pikërisht në atë zonë, prej nga edhe u zgjodh nga votuesit në një ndër detyrat më të larta.

24.21/a. Kjo mungesë tërësore e dijenisë së të shkuarës së largët të z. M. F. nuk u kontestua as nga Komisioneri Publik dhe as nga Drejtuesi i SPAK, në asnjë fazë të procesit, madje edhe Vëzhguesi Ndërkombëtar, në pyetjet e ngritura subjektit të rivlerësimit në seancë, nuk kanë kontestuar për asnjë çast padijeninë e së shkuarës së z. M. F. nga subjekti, gjatë kohës kur

ndodhi udhëtimi me të, apo me z. A. F., në qershor e korrik të vitit 2012. Në të njëjtën linjë, në asnjë fazë të procesit, nuk rezulton që të jenë parashtruar pyetje e rrethana faktike apo ligjore, që do të tregonin qoftë edhe në nivelin e indicieve, që subjekti i rivlerësimit ishte apo duhet të kishte ditur në vitin 2012, që M. F. kishte një të shkuar me probleme me ligjin. Këtij aspekti, dijenisë së problemeve me ligjin për individët me të cilët shoqërohen, kontaktojnë apo ndërthurin jetën personale të subjekteve të rivlerësimit, trupa të ndryshëm gjykues, në çështje të ndryshme, i kanë dhënë vëmendje parësore në mënyrë konsistente. Në mungesë të dijenisë, pritshmëria për sjellje që tregon distancim është e pamundur të argumentohet.

24.22. Në të njëjtën mënyrë, trupa të ndryshëm të Kolegjit, nuk kanë vlerësuar zbatimin e masës disiplinore, për shkak të dijenisë së hamendësuar e prezumuar të së shkuarës penale të një individi, qoftë mbi baza familjare, shoqërore apo edhe krahinore të përbashkëta, sikurse mund të jetë nënkuptimi në çështjen konkrete. Dijenia e së shkuarës penale apo aktualitetit në shkëlqje të ligjit, është vlerësuar si shkak për masë disiplinore, vetëm kur e kundërta do të ishte e pamundur të argumentohet. Ky parim, që në disa raste merr ngjyrim gjuhësor thujse procedural penal, nuk përbën në thelb ndryshimin e barrës së provës, duke e çliruar subjektin e rivlerësimit, por mban në konsideratë parimin që është e pamundur të provosh diçka që nuk ekziston. Nën këtë dritë, trupi gjykues, nëpërmjet testit të standardit të dyshimit të arsyeshëm, në rrethanat konkrete, argumenton përse prezumimi i dijenisë do të ishte një koncept i padrejtë, joobjektiv dhe disproporcional për ta pasur si të vetmin argument për të vendosur shkarkimin nga detyra. Ky ka qenë qëndrimi i Kolegjit edhe në çështje të tjera⁶⁹, në të cilat çështjen e dijenisë për të shkuarën penale të një personi tjetër të lidhur me subjektin, trupi gjykues ka vlerësuar të mos e ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, bazuar në prezumime, të cilat nuk do t'i qëndronin testit objektiv dhe të kohës, e mund të ishin një barrë e padrejtë për subjektin.

24.23. Trupi gjykues vlerëson se vendosja e një barre prove të tillë mbi subjektet, për të provuar përse ata nuk kishin dijeni, do të ishte jo vetëm një interpretim tejet i zgjeruar i barrës së provës për subjektet në procesin e rivlerësimit, por do të dobësonte seriozitetin dhe rëndësinë që ka dallimi mes kontakteve të papërshtatshme rastësore e atyre të qëllimshme. Duke iu referuar rrethanave konkrete të çështjes, vlerësojmë se fakti që z. M. F. ka qenë deputet i Kuvendit të Shqipërisë nënkupton që të gjithë kontaktet e tij, përfshirë ata për shkak të detyrës, pavarësisht nga rrethanat, do të ishin në një situatë të ngjashme me subjektin e rivlerësimit, për të rrëfyer qoftë edhe takimet episodike me të (ose të vëllanë), me përgjegjësinë që, nëse nuk kanë ruajtur në kujtesë edhe episode kalimtare, mund të konsideroheshin se fshihnin një marrëdhënie me një person të përfshirë në krimin e organizuar. Një qasje e tillë, përveçse mund të passillte abuzivizëm, bie ndesh edhe me objektivin e procesit të rivlerësimit, si një proces që ka për synim largimin nga sistemi të magjistratëve që kanë kontakte e mund të vihen nën ndikim nga elementë të krimit të organizuar. Qartazi, trupi gjykues vëren se rrethanat e takimit të subjektit të rivlerësimit me z. M. F., që nuk janë kontestuar nga përgjimi ambiental, nga organet ligjzbatuese, nga

⁶⁹ *Vendimi i Kolegjit nr. 11/2022 (JR), datë 27.04.2022; vendim nr. 3/2024 (JR), datë 29.01.2024; vendim nr. 5/2025 (JR), datë 23.01.2025.*

informacionet e tjera të poseduara nga organet e drejtësisë, por është deklaruar në procesin e rivlerësimit nga subjekti, në pyetësonin standard, tregojnë për mirëbesim të tij për të treguar transparencë edhe për një takim rastësor me këtë individ.

24.24. Trupi gjykues konstaton se, përveç kualifikimit të pasaktë që i bëhet kësaj rrethane në ankim, të deklaruar prej subjektit në pyetësonin standard mbi udhëtimet me shtetasit A. F. dhe M. F., nga ana tjetër, çmon të vlerësojë nëse proceduralisht dhe materialisht, subjekti gjendet në mospërmbushje të kriterit ligjor të nenit 38, pika 3, të ligjit nr. 84/2016 dhe të praktikës së Kolegjit në lidhje me interpretimet që i ka bërë standardeve të vlerësimit të figurës.

24.25. Referuar nenit 38, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vëren se Komisioni (në rastin e argumentimit të vendimmarrjes së tij) dhe Komisioneri Publik (në rastin e paraqitjes së një ankimi, kur ndan një vlerësim të ndryshëm me Komisionin) duhet që në vlerësim të paraqesin rrethanat që citon ligji, jo rrethana *a priori*, që marrin parasysh për konstatimin (pra, ekzistencën e një kontakti të papërshtatshëm), si dhe rrethanat lehtësuese të këtij konstatimi (edhe nëse pretendojnë / vlerësojnë ekzistencën e një kontakti të tillë). Për arritjen e konkluzionit të paplotësisë së deklaramit në formular, dy premisat e mësipërme duhet të qëndrojnë në mënyrë të njëkohshme. Trupi gjykues vëren se, për kryerjen e analizës ligjore në lidhje me plotësinë ose jo të formularit të kontrollit të figurës, kërkohet që kontakti / takimi i dyshuar të kualifikohet ligjërisht, njëherë si kontakt i papërshtatshëm e, më pas, të vijohet analiza mbi plotësinë ose jo të tij apo të pasjes ose jo të rrethanave lehtësuese. Kjo del e qartë, qoftë nga leximi sistematik i nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, ashtu edhe nga përcaktimi i pikës 3 të këtij neni.

24.26. Në ankimin e Komisionerit Publik, përpos citimit të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, nuk rezulton të ketë arsytim për arsyet për të cilat ai arrin në një vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, në lidhje me: i) konstatimin fillimisht të kontaktit të papërshtatshëm (pra, kualifikimit ligjor të tij), dhe; ii) mungesën e rrethanave lehtësuese, edhe nëse do të konstatonte një kontakt të tillë.

24.27. Trupi gjykues çmon të theksojë se arsytimi në lidhje me pamjaftueshmërinë e deklaramit në formularin e kontrollit të figurës (qoftë kur paraqitet në vendimmarrjen e Komisionit, ashtu edhe kur sillet si shkak ankimi nga Komisioneri) është një element i domosdoshëm për të arritur në konkluzione për vendimmarrje apo për të ngritur një pretendim kaq të fortë / akuzues, duke mbajtur parasysh pasojën që do të sillte një konstatim i tillë, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Mungesa e një arsytimi në këtë drejtim, duke shmangur nga vlerësimi, në mënyrë konkrete për rastin, standardet e pikave 4 – 7, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, e bën të pabazuar pretendimin dhe kërkimin e Komisionerit Publik për konstatimin e pamjaftueshëm të deklaramit të subjektit në lidhje me këtë fakt.

24.28. Në konkluzion të argumenteve më lart, bazuar mbi aktet shkresore të administruara në fashikullin gjyqësor në Komision dhe Kolegj, konkretisht në vetëdeklarimet e tij në pyetësonin standard, sikurse edhe në përgjigjet e paraqitura nga agjencitë ligjzbatuese ndihmëse të procesit mbi këtë kriter, trupi gjykues vlerëson se nuk ka ekzistuar detyrimi për të deklaruar ngjarjen e vitit 2012 si kontakt të papërshtatshëm në deklaratën e kontrollit të figurës nga subjekti. Edhe shkaqet e ankimit të ngritura nga Komisioneri Publik dhe Drejtuesi i SPAK,

nuk përmbushin kriterin ligjor që, në vlerësimin e ndryshëm që bëjnë nga Komisioni, të arsyetojnë rrethanën konkrete të kontaktit. Për pasojë, ky shkak ankimi vlerësohet nga Kolegji i pabazuar, në kuptim të nenit 38, pika 3, që e parasheh në mënyrë taksative / deklarative këtë pasojë.

24.29. Në lidhje me udhëtimin me shtetasin A. F., nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar përgjatë hetimit administrativ në Komision, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjes nr. 12 të pyetësorit standard, datë 10.07.2020, ka deklaruar se: [...] datë 24.06.2012, udhëtim në Mal të Zi, brenda ditës. Kam udhëtuar me z. A. F., i cili po shkonte për arsyet e tij në Mal të Zi. Rastësisht, kam mësuar se kishte për të shkuar në Mal të Zi dhe i kam kërkuar të udhëtoj me të, me qëllim për t'i dërguar një pako me medikamente mikut tim, E. M. [...].

24.30. Në përgjigje të pyetësorit të Komisionit, për të sqaruar të dhënat konkrete në lidhje me këtë udhëtim, subjekti ka shpjeguar⁷⁰ në mënyrë shteruese rrethanat e njohjes dhe të udhëtimit me këtë person, duke pohuar se: (...) Nga momenti që është kthyer në Shkodër, nuk ka pasur asnjëherë ndonjë komunikim, kontakt apo takim, qoftë edhe të rastësishëm, me këtë shtetas

⁷⁰ Subjekti ka shpjeguar se takimi i tij me shtetasin A. F. ka qenë në qytetin e Shkodrës, në datën 24.06.2012, kur ai është nisur nga Tirana për të shkuar në Ulqin, Mal të Zi, me makinën personale rreth orëve të pasdites. Qëllimi i udhëtimit ishte t'i dërgonte disa medikamente mjekësore / ilaçe për dhembje të forta (subjekti kujton se e ka pasur emrin “{***}”) mikut të tij dhe familjes së tij, shtetasit E. M., i cili jeton në Ulqin dhe subjekti ka me të lidhje të vjetra miqësore dhe familjare. Subjekti kujton nga telefonatat me E. shqetësimin dhe urgjencën që ai kishte për gjetjen dhe dërgimin sa më shpejt të atij ilaçi. Subjekti sqaron se ka pyetur në disa farmaci, pasi (ndoshta) kishte mungesë në atë periudhë dhe, gjithashtu, për shkak të nevojës së tij urgjente, marrëdhënieve miqësore, dëshirës për ta takuar, ngushëlluar e ndihmuar, ka vendosur që ilaçet t'ia dërgonte vetë. Subjekti sqaron se, sapo është afruar në qytetin e Shkodrës, makina e tij është dëmtuar në pjesën e poshtme të saj (dëmtim sadokardi), si rezultat i punimeve në rrugë dhe ka konstatuar që kishte rrjedhje vaji dhe, për këtë arsye, duke qenë se udhëtimi i tij ishte i pamundur, në këto kushte, vendosi të shkonte për të parkuar makinën pranë lokalit të të afërmit të tij, i quajtur G.J. P., dhe të interesohet për riparimin e saj. I afërmi i tij, shtetasi G.J. P., u interesua në lidhje me gjetjen e ndonjë mekaniku që mund të riparonte makinën, por me gjithë interesimin e tij dhe të vetë subjektit, ishte e pamundur që ky riparim të bëhej po atë ditë, kjo edhe për shkak se ishte ditë pushimi, ditë e diel (me sa kujton). Në mbrëmje, subjekti sqaron se ka qenë duke darkuar me të afërmin G.J. P. dhe familjen e tij në lokalit të tij, bar-restorant “{***}”. Aty ka ardhur për të darkuar edhe shtetasi A. F. Është përshëndetur me të afërmin e subjektit dhe janë takuar së bashku. Ky ka qenë momenti kur i afërmi i tij i ka thënë se ky shtetas është nga Puka dhe po shkon në Mal të Zi për punët e tij. Subjekti sqaron se e ka pyetur këtë shtetas nëse ishte bezdi për të që ta merrte rrugën e vajtjes (dalje) dhe kujton se ai i ka thënë “aspak”, madje nëse subjekti mbaronte punë shpejt, mund ta merrte edhe në ardhje (hyrje). Pasi kanë konsumuar vaktet respektive (tavolina të ndryshme), janë nisur për në udhëtim dhe e ka dërguar në hotelin në pronësi të shtetasit E. M. Subjekti ka takuar E. dhe i ka dhënë ilaçin. Shtetasi A. F. e ka marrë po në hotelin në pronësi të shtetasit E. M., pasi ka mbaruar angazhimet e tij, dhe është kthyer po në Shkodër. Gjithë kontakti rastësor me shtetasin A. F. ka qenë ky udhëtim. Nga momenti që është kthyer në Shkodër, shtetasi A. F. e ka lënë subjektin në banesën e të afërmit G.J. P. Më pas, subjekti nuk ka pasur më asnjëherë ndonjë komunikim, kontakt apo takim, qoftë edhe të rastësishëm me këtë shtetas. Në momentin që subjekti ka marrë informacion nga media për problemet e këtij shtetasi me ligjin, duke qenë se kontakti ka qenë rastësor dhe marrëdhënia me këtë shtetas ka qenë tërësisht indiferente (nuk ka pasur kurrë asnjë marrëdhënie) dhe është kujdesur që të mos ketë asnjë kontakt, qoftë edhe të rastësishëm me të (prezenca ime në të njëjtat ambiente me këtë shtetas), duke treguar në këtë mënyrë një kujdes edhe më të shtuar, në respekt të parimeve individuale dhe të detyrimit ligjor për statusin e magjistratit.

(...). Për të sqaruar më tej në lidhje me këto rrethana, gjatë gjykimit të çështjes para Kolegjit, subjekti ka paraqitur aktet⁷¹, të cilat janë administruar nga trupi gjykues në cilësinë e provës.

24.31. Për sa i përket dijenisë në raport me atë çka përfaqësonte ky shtetas, sikurse konstatohet edhe në ankimin e Komisionerit Publik, trupi gjykues konstaton se procedimi penal i këtij personi ka filluar pas vitit 2013, për një fakt penal të ndodhur po në këtë vit (2013), për t'u konkluduar me dënimin e tij për kryerjen e veprës penale "Vrasja" (marrë formë të prerë nga Gjykata e Lartë në vitin 2017). Referuar akteve⁷² të aksesuara nga burime të hapura, rezulton se shtetasit A. F. i atribuohet fakti kriminal i vrasjes së shtetasit D. L. në shkurt të vitit 2013 dhe, në bazë të vendimit nr. {***}, datë 29.06.2015, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë (konfirmuar edhe nga Gjykata e Lartë⁷³), rezulton të jetë shpallur fajtor për veprën penale *Vrasja në rrethana të tjera cilësuese*, parashikuar nga neni 79, germa "c" e Kodit Penal (ligji i kohës në momentin e kryerjes së veprës penale), dhe të jetë dënuar me burgim të përjetshëm. Gjithashtu, ai është deklaruar fajtor edhe për veprën penale *Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit*, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

24.32. Trupi gjykues vëren se, duke marrë në konsideratë të gjitha momentet faktike dhe ligjore të procedimit të këtij shtetasi, sikurse rezulton nga burimet e hapura (gjykataelarte.gov.al), përpara vitit 2013, nuk rezulton të ketë ndodhur asnjë fakt / ngjarje, që të lidhë përfshirjen e këtij personi në rrethin e subjekteve të cilësuar si "pjesë e krimit të organizuar". Mungesa e lidhjes shkakësore ndërmjet udhëtimit, të deklaruar prej subjektit në përgjigje të pyetësorit standard, me faktin penal për të cilin rezulton të jetë dënuar ky shtetas, e bën jo vetëm të pamundur dijeninë e subjektit të rivlerësimit për këtë rrethanë (nuk mund të pretendohet dijeni për një rrethanë apo fakt që nuk ka ndodhur ende), por nga ana tjetër, vepra penale e konsumuar nga ky person nuk rezulton të jetë pjesë e rrethit të veprave të parashikuara nga neni 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, që mbartin detyrimin e deklarimit. Në këto kushte, konkludohet se nuk plotësohet kriteri i parë kumulativ, që shërben si një kusht për të pasur një kontakt të papërshtatshëm dhe, për rrjedhojë, të lindë detyrimi i subjektit të rivlerësimit për deklarim në formularin e kontrollit të figurës.

24.33. Lidhur me standardet ligjore që aplikohen, për këtë rast, trupi gjykues arsyeton se nisur nga parashikimet e neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të formularit të lëshuar sipas shtojcës 3 të këtij ligji, në kohën e plotësimit të këtij të fundit, nuk rezulton asnjë nga dy

⁷¹ Deklarata noteriale nr. {***}, datë 09.01.2025, lëshuar nga një prej bashkëshoqëruesve (znj. J. SH.) të shtetasit A. F. në udhëtimin nga Shkodra në Ulqin dhe anasjelltas, e cila konfirmon shpjegimet e subjektit mbi rrethanat konkrete të këtij takimi dhe udhëtimi; deklarata noteriale nr. {***}, datë 30.12.2024, lëshuar nga z. E. M., i cili sqaron rrethanat në lidhje me qëllimin e udhëtimit dhe dinamikat e ngjara në raport me të; certifikatë vdekje nga Akti, e dajës së subjektit, GJ. P., tek i cili ka qëndruar ditën e udhëtimit për në Mal të Zi, si edhe ka qenë personi që e ka prezantuar atë me shtetasin A. F.; deklarata noteriale nr. {***}, datë 07.01.2025, lëshuar nga znj. D. A., e cila konfirmon thëniet e subjektit mbi rrethanat e udhëtimit të tij në Prizren me shtetasin M. F.

⁷² Referuar fakteve të relatuara në pjesën arsyetuese të vendimit nr. 14, datë 24.04.2018, të Gjykatës Kushtetuese, aksesuar: në https://www.gjk.gov.al/web/Lista_e_Vendimeve_92_1.php, më datë 16.07.2024.

⁷³ Me vendimin nr. {***}, datë 08.06.2017, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale, aksesuar në faqen <https://gjykataelarte.gov.al>, datë 16.07.2024.

elementet e kërkuara nga ligji për t'u bërë e deklarueshme një ngjarje/fakt i tillë. Sikurse rezulton, në muajt prill e qershor, kur janë të vetmet kontakte të subjektit të rivlerësimit me A. F., ky i fundit nuk kishte kryer asnjë krim, madje asnjë prej vëllezërve F., në kohën që i ka takuar / kontaktuar / telefonuar subjekti i rivlerësimit, nuk kishin asnjë problem me ligjin, çka tregon se subjekti nuk ka mbajtur shoqëri me persona të përfshirë në krim. Aq më tepër kur, udhëtimi me shtetasin A. F. ka ndodhur në kuadër të rrethanave tërësisht rastësore, konfirmuar kjo edhe nga personat prezentë, referuar deklaramit ligjor⁷⁴ nën përgjegjësinë e tyre të plotë. Trupi gjykues çmon se do të ishte abuzivizëm të ngarkohej me përgjegjësi për një masë disiplinore një subjekt rivlerësimi, për shkak të një njohjeje të hershme dhe episodike me njerëz, që më pas kanë kryer apo janë shpallur fajtorë për vepra penale të panjohura për askënd. Nga ana tjetër, shtetasi A. F., në bazë të verifikimeve të bëra në burimet e hapura të informacionit, në kuptim të nenit 49, pika l/c dhe pika 3, të ligjit nr. 84/2016, nuk rezulton të jetë autor / subjekt i kryerjes së ndonjë prej veprave penale të parashikuara nga neni 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, as para, as gjatë dhe as pas udhëtimit të zhvilluar, si një premisë e domosdoshme për ta klasifikuar si person të përfshirë në krim të organizuar, dhe që passillte detyrimin për deklaram në formularin e kontrollit të figurës.

24.34. Lidhur me çështjen e tretë që shtrohet për analizë në këtë shkak ankimi, që ka të bëjë me faktin nëse gjendemi para situatës ku rrethanat që lidhen me kontaktet e subjektit të rivlerësimit me këta dy persona duhen çmuar në drejtim të treguesit të “etikës”, trupi gjykues analizon si më poshtë:

24.35. Në ankimin e tij, Komisioneri Publik, në konsideratë të rekomandimit të ONM-së, i cili referon se: *[...] Për sa i përket etikës dhe përkushtimit ndaj vlerave profesionale, nuk jemi dakord me pohimin se udhëtimi me vëllezërit F. ishte i rastësishëm. Koincidenat e përmendura në përgjigjet e subjektit të rivlerësimit janë të shumta dhe jobindëse. Fillimisht, takohet rastësisht me z. A. F. dhe udhëton për në Mal të Zi, më pas, disa javë më vonë, me z. M. F. në Kosovë. Për më tepër, M. F. ishte pronar në kompaninë e basteve, nga e cila vlerësuesi kishte marrë një vërtetim konfirmimi, ku thuhet se kishte marrë 7.451 euro në vitin 2010. Këto rrethana paraqesin shumë pikëtakime për t'u hedhur poshtë dhe nuk e mbështesin pretendimin e subjektit të rivlerësimit se këto takime ishin takime të rastësishme, me njerëz krejtësisht të panjohur. Prandaj, duhet të ishte bërë një analizë e plotë për të vlerësuar implikimin etik të këtyre ndërveprimeve, nën kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale, vlerëson se edhe kjo “gjetje” duhet çmuar si rrethanë që lidhet me etikën e magjistratit, në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas parashikimit në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.*

⁷⁴ Për të sqaruar më tej në lidhje me këto rrethana, gjatë gjykimit të çështjes para Kolegjit, subjekti ka paraqitur aktet të cilat janë administruar nga trupi gjykues në cilësinë e provës: deklarata noteriale nr. {***}, datë 09.01.2025, lëshuar nga një prej bashkëshoqëruesve (znj. J. SH.) të shtetasit A. F. në udhëtimin nga Shkodra në Ulqin dhe anasjelltas, e cila konfirmon shpjegimet e subjektit mbi rrethanat konkrete të këtij takimi dhe udhëtimi; deklarata noteriale nr. {***}, datë 30.12.2024, lëshuar nga z. E. M., i cili sqaron rrethanat në lidhje me qëllimin e udhëtimit dhe dinamikat e ngjara në raport me të; certifikatë vdekje nga Akti, e dajës së subjektit G.J. P., tek i cili ka qëndruar ditën e udhëtimit për në Mal të Zi, si edhe ka qenë personi që e ka prezantuar atë me shtetasin A. F.

24.36. Trupi gjykues çmon se situata e paraqitur nga Komisioneri Publik mbi fitimin në loto sportive të subjektit, në shoqërinë “{***}”, duke krijuar lidhje indirekte me shtetasin M. F., nuk duket e bazuar, për të gjitha rrethanat faktike dhe ligjore si vijon:

(i) Përzgjedhja e vendit ku është luajtur lotoja sportive ka qenë pranë ambientit të punës së subjektit, e ardhur si ftesë e vëllait të tij për t’u takuar. (ii) Shoqëria ku ka rezultuar fitues subjekti ka qenë një nga rreth 3 apo 4 shoqëritë që kanë operuar në fushën e lojërave të fatit në Shqipëri, prandaj përzgjedhja e kësaj pike prej subjektit nuk duket se është orientuar mbi baza emri kompanie e, aq më pak ortakërie, por përzgjedhje e zakonshme dhe rastësore e vëllait të tij. (iii) Në momentin e rezultatit pozitiv të bastit sportiv, subjekti ka kërkuar dokumentimin e këtij fakti përmes konfirmimit me dokument ligjor e, pas këtij momenti, ka qenë dhe është detyrimi i organeve përkatëse për të verifikuar dhe vlerësuar ligjshmërinë e atij aktiviteti. (iv) Ndryshe nga sa pretendohet në ankim/rekomandim, konfirmimi ligjor i faktit të ndodhur me dokumentin përkatës, ngarkon me përgjegjësi lëshuesit e tyre, të cilët, respektivisht janë punonjësi i pikës / lokalit dhe administratori i përgjithshëm i subjektit. Ekzistenca e kushëririt të bashkëshortes së subjektit si punonjës në këtë pikë, nuk mund të çmohet si element që do ta shtynte atë për të lëshuar një dokument të pasaktë. Akti i paraqitur prej subjektit, lëshuar nga autoriteti kompetent i shoqërisë, nuk paraqet asnjë lidhje me personin M. F., sikurse pretendohet në arsyetimin e shkakut të ankimit.

24.36/a. Gjithashtu, edhe si një *obiter dictum*, deklarimi i shumës së fituar nga lotot sportive (provuar vetëm në një rast), jo vetëm ka qenë në përmbushje të detyrimit të subjektit, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, për të deklaruar çdo të ardhur dhe burimin e sigurimit të saj, por tregon faktin se subjekti nuk ka pasur arsye për ta fshehur, duke u treguar transparent në vijimësi. Aq më tepër që, ashtu sikurse ka rezultuar edhe nga analiza e detajuar financiare e bërë nga Komisioni dhe e pakundërshtuar nga Komisioneri Publik (për sa i përket vitit 2010), të ardhurat nga lotot sportive nuk kanë shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie gjatë atij viti ose më pas, dhe as për kursimin e të ardhurave *cash* në fund të vitit 2010. Mënyra e shpenzimit të shumës është deklaruar shprehimisht prej subjektit dhe nuk ka asnjë rrethanë ligjore që ta përjashtojë atë nga të ardhurat e ligjshme.

24.37. Nga sa më lart arsyetuar, trupi gjykues çmon se përfitimi i së ardhurës në vitin 2010, takimi me shtetasit A. F. dhe M. F. është zhvilluar në rrethana faktike tërësisht të ndryshme e të pavarura prej tyre, për të cilat janë administruar akte shkresore dhe deklarata individësh, që dëshmojnë pavarësinë tërësore të këtyre situatave. Po ashtu, nga hetimi administrativ i zhvilluar në Komision, në kryqëzim të informacioneve të ardhura nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH), Shërbimet e Çështjeve të Brendshme (SHÇBA), Prokuroria e Përgjithshme etj., nuk rezultoi asnjë provë në asnjë formë, që të dëshmojë qëndrueshmërinë e marrëdhënies së subjektit me këta shtetas pas vitit 2012. Duke abstraguuar nga gjithë sa më sipër, fakti që nga përgjimi ambiental i kryer për A. F. e M. F., nuk ka rezultuar asnjë rast me të cilin ata të kenë referuar subjektin e rivlerësimit, apo nga hetimi të ketë rezultuar ndonjë lidhje e tyre me të, ndërkohë, duke qenë në funksionin e prokurorit, do të ishte hipotetikusht personi i parë tek i cili do të drejtoheshin në momentet kur kanë qenë në dijeni të problemeve me drejtësinë. Ky fakt është dëshmia më domethënëse që e bën bindëse mënyrën se si subjekti i rivlerësimit e cilëson natyrën e marrëdhënies së tij me vëllezërit F.

24.38. Përpos sa më sipër, trupi gjykues çmon se luajtja e një lotoje sportive në një episod të vetëm nuk mund të konsiderohet një veprimtari që cenon figurën apo etikën e magjistratit, për më tepër, të interpretuara këto, në kushtet dhe rrethanat e deklaruara prej subjektit në mënyrë koherente, me kontekstin dhe kohën kur ka ndodhur ky fakt (vitin 2010), dhe i papërsëritur më pas prej tij. Dyshimet e ngritura nga Komisioneri Publik, në raport me rrethanën e këtij basti sportiv, shmangen nga analiza objektive dhe ligjore, në bazë të provave të administruara për këtë episod / deklaram, duke u nxjerrë nga konteksti real dhe konkret i tyre. E thënë ndryshe, kjo ngjarje, e veçuar dhe e *vetëdeklaruar*, nuk mund të argumentohet se do të ishte objektive, nëse do të passillte pasojë penalizimin e subjektit, për shkak të gjithë rrethanave të përmbledhura më sipër, nën dritën e qëllimit të procesit të rivlerësimit.

24.39. Vlerësimi i përgjithshëm i subjektit të rivlerësimit, në bazë të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nuk mund të ndërmerret, as ligjërisht dhe as logjikisht mbi rrethanën e luajtjes së një basti sportiv, pasi del tej *ratios* së ligjit dhe praktikës së qartë dhe mirargumentuar të Kolegjit në këtë drejtim. Shkaku i pretenduar në këtë rast nga Komisioneri Publik, nuk lidhet me asnjë nga kriteret e rivlerësimit, i mjaftueshëm për të marrë masën disiplinore, sipas një prej pikave të nenit 61 e, aq më tepër, nuk argumentohet se si lidhet ky fakt me vlerësimin e përgjithshëm të procedurave dhe sjelljes së subjektit.

24.40. Në praktikën e tij, Kolegji ka orientuar standardet dhe rrethanat që duhet të mbahen në konsideratë në rastin e luajtjes së basteve sportive, duke arsyetuar se: i) për sa kohë që më herët nuk ka rezultuar asnjë procedim disiplinor, në kuptim të shkeljes së etikës ndaj subjektit, përgjatë gjithë karrierës së tij; ii) mospërfshirja e subjektit në këtë veprimtari prej një kohe shumë të gjatë; janë konsideruar si rrethana që nuk mund të konsiderohen si cenuese të etikës, figurës apo integritetit të tij e, për pasojë, *Kolegji e gjen jo të drejtë konkluzionin e Komisionit, sipas të cilit, subjekti i rivlerësimit, duke marrë pjesë në lojërat e fatit, në vitet 2006 – 2008, ka cenuar figurën dhe integritetin e tij, duke ulur shkallën e besueshmërisë të publiku*⁷⁵.

24.41. Cenimi i etikës së magjistratit, duke mbajtur në konsideratë si udhëtimet, ashtu edhe lotot sportive, nuk mund të paraqitet *a priori*, por vetëm duke analizuar këto rrethana dhe perceptimin që këto veprime do të krijonin në publik.

24.42. Trupi gjykues e analizoi këtë shkak ankimi nën dritën e standardeve të Parimeve të Bangalorit, të cilat janë një set rregullash etike, që udhëzojnë sjelljen e magjistratëve, me qëllim sigurimin e drejtësisë, paanshmërisë dhe integritetit në sistemet gjyqësore. Këto parime vlerësohen si thelbësore për të ruajtur besimin e publikut në administrimin e drejtësisë dhe për të garantuar ndershmërinë dhe drejtësinë në proceset gjyqësore. Parimet bazë mbi të cilat mbështeten standardet e etikës, të vendosura në këtë akt, janë: pavarësia, paanshmëria, integriteti, sjellja e hijshme dhe vetëpërmbytëse, profesionalizmi dhe përgjegjësia në punë, respekti dhe aftësia për të dëgjuar, transparenca.

24.43. Shmangia nga këto parime e, për rrjedhojë, cenimi i besimit të publikut te drejtësia, reduktimi i integritetit të sistemit gjyqësor, mund të shkaktohet nga sjellje, gjatë ushtrimit të

⁷⁵ *Vendimi i Kolegjit nr. 25/2019 (JR), datë 14.10.2019, paragrafët 50, 52.*

profesionit dhe jashtë tij, përmes formave si: i) paaftësia për të qenë i paanshëm; ii) përfshirja në veprime të papërshtatshme; iii) mosndjekja e procedurave të duhura; iv) mungesa e respektit për të drejtat e individëve; v) përfshirja dhe angazhimi në korrupsion; vi) marrëdhënie të dyshimta me palët në proces; vii) veprime / sjellje të papërshtatshme dhe joprofesionale në jetën private; viii) përdorimi i informacioneve të brendshme për qëllime personale; ix) mungesa e respektit për etikën profesionale; x) angazhimi në aktivitete politike, që ndikojnë në objektivitetin e procedurës.

24.44. Trupi gjykues vëren se, në shkakun e ankimit ku pretendohet cenimi i etikës, nuk argumentohet parimi i shkelur dhe mënyra e cenimit të tyre prej subjektit. Nga provat e administruara në Komision, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndjekur çështje që lidhen me personat A. F. dhe M. F. apo me familjarë të tyre, çka do të thotë që nuk mund të diskutohet sjellja e tij si magjistrat. Përderisa nuk ka çështje, nuk ka as cenim të Parimeve të Bangalores. Në konkluzion të sa më sipër, nuk ekziston ndonjë premisë apo tregues që të hedhë dyshim në drejtim të cenimit të etikës së subjektit të rivlerësimit si prokuror apo, më tej akoma, të krijojë cenim të besimit të publikut.

24.45. Në përfundim të kërkimit të Komisionerit Publik për vlerësimin e kësaj rrethane si penalizuese, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se ajo është e pabazuar, pasi kjo rrethanë, jo vetëm që nuk përbën cenim të asnjë indikatorit të etikës, por dhe nuk lidhet me asnjë nga komponentët e rivlerësimit, rrethanë që shërben si *condicio sine qua non*, mbi bazën e përcaktimeve ligjore dhe praktikës së konsoliduar të Kolegjit në këtë drejtim.

25. Lidhur me dokumentin “Gjetje”, depozituar në Kolegj nga Vëzhguesi Ndërkombëtar:

25.1. Më datë 04.02.2025, u paraqit në Kolegj akti “Gjetje”⁷⁶. Në këtë akt, Vëzhguesi Ndërkombëtar, në kuadër të mjetit procedural “Gjetje”, parashtron se, ashtu sikurse është paraqitur në rekomandimin e tyre, konfirmuar nga ankimi i Komisionerit Publik, Komisioni nuk arriti të kryente një hetim të plotë mbi natyrën e kontakteve të z. Preçi me vëllezërit F., duke çuar në gabime lidhur me analizën dhe konkluzionet e saj ligjore. Sipas provave⁷⁷ të paraqitura rishtazi nga SPAK, në të cilat ONM-ja ka të drejtë aksesit, sipas nenit 50 të ligjit nr.

⁷⁶ Më datë 04.02.2025, në Kolegj u depozitua dokumenti “Gjetje”, i Vëzhguesit Ndërkombëtar, si dhe dokumentacioni shoqëruar si vijon: akte që i përkasin fashikullit të procedimit penal nr. {***}, viti 2013, për procedimin penal ndaj shtetasit A. F.; vendim nr. {***}, viti 2017, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mbi dënimin e z. A. F.; vendim nr. {***}, viti 2015, i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, ndaj A. F.; vendim nr. {***}, viti 2015, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

⁷⁷ Referuar deklaratës së pasurisë vetting dhe deklaratave periodike/vjetore, të cilat kanë vlerë provuese, sipas nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, z. Preçi ka deklaruar përdorimin e numrit të telefonit {***} nga viti 2008 deri në vitin 2017.

Sipas vendimit nr. {***}, datë 03.04.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, rezulton se shtetasi A. F. kishte numrin e telefonit {***} (faqet 15, 17 të vendimit).

Posedimi i të njëjtit numër telefoni nga shtetasi A. F. konfirmohet edhe në procesverbalin “Deklarime të personit që jep informacion të vlefshëm për hetimin”, datë 06.06.2012, i mbajtur nga oficeri i policisë gjyqësore, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

84/2016, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet numrit të tij telefonik të punës, ka pasur komunikime telefonike me A. F.

25.1/a. Në përgjigje të kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, kompania e komunikimit celular *Vodafone*, ka konfirmuar se Arben Frroku përdorte numrin e telefonit: {***} dhe, nga regjistri i thirrjeve, nga muaji prill 2012, konfirmohen komunikime të drejtpërdrejta ndërmjet celularit të shtetasit A. F. dhe celularit të subjektit të rivlerësimit, z. Valentin Preçi, pikërisht në orët si vijon: 10:33:24, 10:56:36 dhe 11:47:20.

25.2. ONM-ja ka konstatuar se: (i) Provat kundërshtojnë pohimet e z. Preçi se takimet e tij me vëllezërit F., veçanërisht (z. A. F.) ishin rastësore. (ii) Marrja e mirëqenë e shpjegimeve të z. Preçi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk është e mjaftueshme, pasi nuk vlerësoi në mënyrë kritike rëndësinë e kontakteve të tij. (iii) Thirrjet telefonike dhe historiku i udhëtimeve hedhin poshtë pretendimet e z. Preçi dhe tregojnë një lidhje më të ngushtë me vëllezërit F., nga sa deklararon. (iv) Nëse z. Preçi do t'i kishte deklaruar siç duhet këto kontakte, autoritetet e *vetting*-ut do të kryenin një investigim më të plotë për të përcaktuar nëse integriteti i tij profesional ishte cenuar.

25.3. Vëzhguesi Ndërkombëtar, bazuar në gjetjet e mësipërme, arriti në përfundimin se provat e paraqitura bien ndesh me pretendimet e z. Preçi se ai nuk kishte shoqëri me A. F. Të dhënat telefonike tregojnë se ky takim, në qershor 2012, nuk ishte rastësor dhe që ata kishin kontakte me njëri-tjetrin, të paktën që nga prilli 2012. Duke pasur parasysh implikimet serioze të këtij informacioni të ri, Vëzhguesi Ndërkombëtar rekomandoi që të rihapet hetimi për t'i mundësuar trupit gjykues dhe palëve të rishikojnë dhe vlerësojnë ndikimin e kësaj prove në proces.

25.4. Përfaqësuesja ligjore e subjektit të rivlerësimit, në pretendimet e ngritura lidhur me këtë “Gjetje” të Vëzhguesit Ndërkombëtar, sqaroi se ato nuk passjellin ndonjë rezultat të ndryshëm, në drejtim të sjelljes së subjektit me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës, pasi shtetasi A. F. nuk ka qenë në të dyja periudhat e kontaktit objektiv (pavarësisht motiveve), i përfshirë në veprat penale të krimit të organizuar. Subjekti e ka pasur të pamundur për të kujtuar thirrjet disaminutëshe të para shumë viteve, për më tepër kur, referuar situatës kohore, për asnjë nga shtetasit A. F. dhe M. F., nuk ka asnjë informacion publik apo zyrtar për përfshirje në krim të organizuar. Koha e realizimit të thirrjeve, në prill të vitit 2012, provon se nuk paraqesin relevancë dhe as ndikim me çështjet penale që rezultojnë të jenë zhvilluar më pas në Prokurorinë e Tiranës dhe Prokurorinë e Krimeve të Rënda, provuar kjo objektivisht, si me mungesën e të dhënave për njohje të ngushta, ashtu edhe të ecurive hetimore të çështjeve, ku i përfshirë ishte shtetasi A. F.

25.5. Me kërkesën e tij, pas “Gjetjes” së Vëzhguesit Ndërkombëtar, subjekti i rivlerësimit është njohur nga GJKKO-ja dhe ka studiuar fashikujt hetimorë/gjyqësorë, të administruar në funksion të procedimit penal nr. {***}, të vitit 2013, për nevoja të hetimit të veprës penale të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal, në kompetencë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, materiale këto të përdorura nga ana e Vëzhguesit Ndërkombëtar për paraqitjen e “Gjetjes”. Nga përmbajtja e akteve shkresore të këtij fashikulli dhe informacioni i rezultuar në to, konfirmohet se personat, A. F., M. F., familjarët e tyre dhe rrethi shoqëror i afërm i tyre,

janë hetuar intensivisht për më tepër sesa 1 (një) vit, duke u aplikuar të gjitha metodikat e hetimit proaktiv. Përfaqësuesja ligjore e subjektit sqaroi se, nga fashikujt hetimorë të verifikuar, rezulton që: i) numri telefonik i poseduar nga shtetasi M. F. të jetë mbajtur në përgjim për rreth 5 (pesë) muaj pas ndodhjes së faktit; ii) përgjimi ambiantal në banesën e tij të ketë vijuar për disa javë pas ngjarjes; iii) përgjimi ambiantal në automjetin e tij të ketë vijuar për më tepër sesa 3 (tre) muaj nga ndodhja e ngjarjes; iv) tabulatet telefonike të tij të jenë administruar për disa ditë, para dhe pas ngjarjes të shkurtit të vitit 2013. Të dhënat e përfuara nga analiza e të gjitha këtyre burimeve provash, dëshmojnë bindshëm dhe tej çdo dyshimi, për mosnjohjen më të hershme të subjektit me këtë shtetas. Konteksti i ngjarjes së ndodhur dhe kohëzgjatja e hetimeve aktive kanë provuar mungesën e çdo lloj indicie apo dyshimi të pretenduar, se subjekti mund të ishte rreth shoqëror i këtyre personave e, si i tillë, takimet e deklaruara prej tij të merrnin trajtën e një “takimi të qëllimshëm”.

25.6. Pas paraqitjes së “Gjetjes” dhe nevojës për mbajtjen e një qëndrimi ligjor në raport me të, subjekti i rivlerësimit, nisur edhe nga informacioni i përdorur nga Vëzhguesi Ndërkombëtar në “Gjetjen” e tij, i është drejtuar me kërkesë (për informacion dhe akte), Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me qëllim njohjen me çështjet penale, eventuale, në ngarkim të shtetasit A. F.

25.7. Në përgjigje të tyre, bëhet e njohur ekzistenca e dy procedimeve penale ndaj shtetasit A. F., respektivisht në vitin 2012, për veprën penale: *Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të rendit publik*, parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal dhe *Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik*, parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal. Për të dyja këto procedime, subjekti ka vendosur në dispozicion të Kolegjit aktet në lidhje me regjistrimin e emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale, për referimin sipas nenit 242 të Kodit Penal, si edhe kërkesën për gjykim, përpiluar nga organi i akuzës ndaj këtij shtetasi, për këtë akuzë. Ndërsa, për procedimin penal të nisur për veprën penale të parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal, ka paraqitur: i) aktet e ekspertimit mjekoligjor të shtetasit A. F., ii) aktet e ekspertimit mjekoligjor të punonjësve të policisë për ngjarjen, dhe; iii) qëndrimin e Prokurorisë mbi kërkimin për caktimin e masës së sigurimit. Trupi gjykues konstaton se për këtë çështje, nga ana e Prokurorisë (në të cilën subjekti ushtronte funksionet edhe në atë kohë), është kërkuar në gjykatë caktimi i masës së sigurimit “Arrest në burg”, sipas nenit 238 të K. Pr. Penale, qëndrim ky, që provon të kundërtën e sa kërkon të provojë gjetja, çka dëshmon për indiferencë të subjektit ndaj shtetasit në fjalë dhe problemeve të tij në raport me ligjin.

25.8. Nga analiza e këtyre materialeve ligjore, në kontekstin e kontaktit telefonik në datat 21 – 22 prill 2012, trupi gjykues vëren se subjekti nuk ka pasur asnjë arsye për t’i mbajtur mend apo deklaruar më pas në deklaratën për kontrollin e figurës, pasi, së pari, z. A. F. nuk kualifikohet nga ligji si kontakt i papërshtatshëm. Së dyti, në kushtet që bëhet fjalë për telefonatë në drejtim të numrit telefonik *zyrtar*, që i përket Prokurorisë, dhe i është dhënë nga puna, është përdorur dhe mbajtur i disponueshëm për qëllime pune, përkundrajt çdo individ që e ka kontaktuar subjektin. Për këtë rrethanë, silltet në vëmendje materiali kallëzues nr. {***} i vitit 2014 (administruar nga Komisioni me shkresën nr. {***} prot., datë 08.11.2022), në të cilin subjekti i rivlerësimit ka kallëzuar përdorimin me keqdashje të thirrjeve telefonike të bërë ndaj tij nga dy numra telefonikë për më tepër sesa dhjetë ditë, në orare të ndryshme të ditës

dhe natës. Prandaj, ekzistenca e disa thirrjeve disasekondëshe (në total prej 2 minutash e 20 sekonda), të realizuara në kushtet e: i) mungesës së plotë të përfshirjes së shtetasit A. F. në ndonjë veprimtari kriminale; ii) mungesës së çdo të dhëne publike për atë që përfaqësonte ky person; iii) mungesës së ekzistencës së këtij personi në materialet hetimore të trajtuara prej tij si prokuror; iv) ngarkesës së lartë në punë; dhe, v) ekzistencës së kontakteve telefonike nga individë të ndryshëm në numrin zyrtar të punës – janë rrethana që nuk krijojnë asnjë premisë faktike apo logjike se përse subjekti duhej të memorizonte e, më pas të kujtonte përmbajtjen e kësaj bisede të rreth 12 viteve më parë nga deklarimi; vi) subjekti nuk kishte asnjë arsye për të mos i deklaruar këto kontakte, për sa kohë ato nuk rezultojnë penalizuese për të në asnjë rrethanë. Gjithashtu, intervalet disasekondëshe në bisedë me një individ, më shumë sesa marrëdhënie miqësore, shoqërohen me natyrë bisede të përciptë apo shmangie korrespondence.

25.9. Ekzistenca e 5 (pesë) thirrjeve, në datat 21 – 22 prill 2012, me A. F., të një periudhe kohore rreth një vit përpara se ky fundit të kishte ndonjë lloj statusi procedural dhe për një vepër penale që nuk kishte karakter vazhdues, u vlerësua si një faktor që peshon në drejtim të besueshmërisë së shpjegimeve të subjektit, si biseda ndaj të cilave nuk kishte shkak të tregonte ndonjë vëmendje të shtuar. Gjatë gjykimit në Kolegj, rezultoi që në aktet e procedimit penal të vitit 2013 në ngarkim të A. F., nga vendosja në përgjim telefonik për disa javë e këtij shtetasi, e z. M. F., familjes e rrethit të ngushtë shoqëror, si dhe nga vendosja e përgjimit ambiantal të shtëpisë e automjetit të shtetasit M. F., nuk pati asnjë të dhënë / komunikim telefonik që të tregojë lidhje më tepër se rastësore të subjektit të rivlerësimit me këta shtetas.

25.10. Trupi gjykues çmon se kontaktet e shkurtra telefonike në prill të vitit 2012, të cilat janë referuara në “Gjetjen” e Vëzhguesit Ndërkombëtar, nuk përbëjnë ndonjë rrethanë, e cila mund të ndikojë, në dallim nga Komisioni, vlerësimin e Kolegjit, pasi shtetasi A. F. është proceduar në periudhën pas këtyre kontakteve (korrik 2012) dhe në vitin 2013 për një vepër penale që nuk përfshihet në gamën e veprave penale, që e cilësojnë person të përfshirë në krimin e organizuar, sipas nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ndodhitë që kanë gjetur pasqyrim të gjerë në media dhe kanë fituar ndjeshmërinë e publikut i përkasin një kohe të mëvonshme, larg nga momenti i takimit rastësor të subjektit të rivlerësimit, që rezultoi të ishte një takim i vetëm. Për këto arsye, trupi gjykues i vlerësoi të besueshme shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për rrethanat që kontrollojnë komunikimet telefonike të kryera në adresë të numrit të telefonit të tij zyrtar, vite përpara se këta persona të ishin të njohur për publikun, për fakte penale apo plotësimin të deklaratës së figurës.

25.11. Lidhur me pretendimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme për përfshirjen e “Gjetjes” si rrethanë që tregon mosbashkëpunim të subjektit dhe cenim të etikës nga kjo sjellje, trupi gjykues arsyeton se neni 48 i ligjit nr. 84/2016, “Bashkëpunimi gjatë procesit të hetimit”, renditet në kreun VII të ligjit “Procedurat e rivlerësimit” dhe vjen menjëherë pas nenit 47, “Të drejtat e subjektit të rivlerësimit”. Nga praktika hetimore e Komisionit dhe ajo gjyqësore e Kolegjit, subjekti konsiderohet jobashkëpunues, në rastet kur nuk përgjigjet për pyetjet dhe sqarimet e kërkuara nga institucionet e rivlerësimit, i paraqet ato të deformuara apo i përcjell jashtë afatit të caktuar për paraqitjen e tyre. Ndryshe nga këto premisa, rrethana e kontaktit / udhëtimit me z. A. F., pikësëpari ka qenë vullnet i subjektit për ta deklaruar në

përgjigje të pyetësorit standard mbi udhëtimet e kryera. Për evidentimin e kësaj rrethane, nisur nga periudha relativisht e gjatë (nga viti 2012 i udhëtimit deri në vitin 2020 të plotësimit të pyetësorit standard), subjekti është orientuar nga të dhënat e sistemit TIMS për të paraqitur dhe sqaruar para Komisionit detajet e këtij udhëtimi. Nën të njëjtat premisa, subjekti e kishte objektivisht të pamundur të kujtonte kontaktin telefonik, në total 2 minuta e 20 sekonda të zhvilluar me z. A. F., aq më tepër kur kjo rrethanë, edhe e deklaruar prej tij nën këto kushte dhe situatë faktike të kohës, nuk do të passillte asnjë pasojë juridike, që mund të motivonte subjektivisht fshehjen apo mungesën e bashkëpunimit për kontaktin me këtë person.

25.12. Nga sa më sipër, të dhënat e konkluduara nga hetimet e zhvilluara ndaj shtetasit A. F. në vitin 2012 – 2013, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe ato në kuadër të procedimit penal nr. {***}, të vitit 2013, nga Prokuroria e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, tregojnë qartësisht se ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit A. F. nuk ka pasur asnjë lidhje të ngushtë, nga sa pretendohet në ankim dhe “Gjetje” dhe, për rrjedhojë, në bazë të faktit dhe të ligjit, nuk ka mbartur asnjë detyrim ligjor për deklarimin e këtij kontakti në deklaratën për kontrollin e figurës.

25.13. Trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme për përfshirjen e “Gjetjes” si rrethanë që tregon se sjellja e subjektit të rivlerësimit ka krijuar vështirësi për zbulimin e së vërtetës, si dhe ka cenim të etikës së magjistratit. Subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur t’i fshehtë udhëtimet me këta shtetas, në kushtet që i ka vetëdeklaruar në pyetësorin standard dhe ka zgjedhur me vullnet të informojë organet e rivlerësimit dhe ato ligjzbatuese për mundësinë e një kontrolli të thelluar lidhur me to. Për më tepër, në kushtet që nuk rezultojnë të dhëna për kontakte të mëpasshme të subjektit me këta individë, pas bërjes publike të veprimtarisë kriminale apo procedimeve e dënimeve penale të tyre, penalizimi i subjektit për një incident që kushtëzohet kryekëput në mungesën e kujtesës së një ngjarjeje / komunikimi të 12 viteve më herët, nga një person që, në kohën kur ka ndodhur kontakti, nuk mbante asnjë cilësi të spikatur, përpos aktivitetit privat dhe prejardhjes së përbashkët me të (subjektin), do të ishte qasje e padrejtë. Trupi gjykues vëren se një vendimmarrje e tillë, mbi të gjitha, nuk do të mbetej në fuqi në rast kontrolli të vendimit të Kolegjit, nën dritën e proporcionalitetit dhe procesit të rregullt, sipas garancive kushtetuese e konventore. Duke marrë në konsideratë faktin që subjekti rezulton të mos ketë pasur asnjë komunikim me secilin prej këtyre dy individëve, më së paku që në vitin 2013, provuar nga përgjimet ambientale të referuara më sipër, trupi gjykues vlerëson se mungesa e ndonjë elementi të qëllimshëm është i vetmi konkluzion logjik i arsyeshëm. Në këto kushte, shpjegimet e subjektit janë bindëse. Nga analiza e të dhënave të mësipërme dhe kontekstit kohor, trupi gjykues nuk konstaton se ka ndonjë rrethanë që të tregojë cenim të indikatorëve të sjelljes etike të magjistratit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2016.

25.14. Në këtë konkluzion, trupi gjykues çmon të rritshme edhe jurisprudencën e tij të mëparshme⁷⁸, si dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁷⁹, në të cilën

⁷⁸ Vendimi nr. 12, datë 02.04.2024, që i përket subjektit të rivlerësimit A. I..

⁷⁹ Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen “Thanza kundër Shqipërisë”, paragrafi 121.

ka vlerësuar se udhëtime dhe kontakte rastësore të një subjekti tjetër rivlerësimi me persona të cilët, edhe në kohën e udhëtimit kishin rekorde penale, u konstatuan se nuk mund të passillnin masë shkarkimi nga detyra, në kushtet që ishin episodike dhe subjekti nuk rezultonte të kishte ushtruar funksionin i ndikuar nga kontakti me këta persona apo ngjarje, si dhe duke mbajtur në konsideratë pasojat e rënda për jetën dhe karrierën që mund të sjellin procedurat disiplinore për magjistratët deri në shkarkimin nga detyra. Për pasojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti rezulton i besueshëm në kontrollin e kriterit të figurës.

D. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

26. Lidhur me shkakun e ankimit që lidhet me konfliktin e interesit

26.1. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, të datës 23.04.2024, rasti konkret i procedimit penal nr. {***}, viti 2015, me shoqërinë “{***}”, administrator i së cilës është shtetasi M. GJ., përkufizohet si situatë e cila mund të përbëjë rast për heqjen dorë nga procedimi penal, pasi subjekti i rivlerësimit, deri në momentin kur procedimi penal i kaloi një prokurori tjetër, ishte prokurori i çështjes dhe gjendej në kushtet e ekzistencës së arsyeve të njëanësisë, sipas nenit 26 dhe nenit 17, të Kodit të Procedurës Penale. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte treguar kujdes të veçantë për të siguruar paanësinë e magjistratit në lidhje me konfliktin e interesit, sipas indikatorëve të përcaktuar nga pika 4 e nenit 75, të ligjit nr. 96/2016.

26.2. Sa i përket gjendjes së konfliktit të interesit, Komisioni në vendim ka konkluduar se subjekti vërtetoi bindshëm të kundërtën e konstatimeve të hetimit administrativ të Komisionit, ku dukej se subjekti ndodhej në situatën e parashikuar nga neni 5, pika 1, shkronjat “c” dhe “dh” / “v” të ligjit nr. 9367/2005 dhe, në bazë të nenit 17, shkronja “ë” dhe 26/1, të Kodit të Procedurës Penale, ka pasur detyrimin ligjor të heqë dorë nga hetimi i çështjes për të mos vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, duke arsyetuar si vijon:

- *Nga hetimi, nuk kanë rezultuar të dhëna që të vërtetojnë se subjekti njëhej me shtetasin M. GJ. në kohën e trajtimit të procedimit penal (viti 2015) me të dëmtuar shoqërinë “{***}” dhe “{***}” ShPK, ku ky shtetas është ortak dhe administrator.*

- *Nuk u vërtetua asnjë arsye apo motiv që tregon njëanshmëri të subjektivitetit në trajtimin e procedimit në fjalë, si për shkaqe ligjore, ashtu edhe për shkaqe personale apo të ndonjë interesi të mundshëm. Për më tepër, shoqëria “{***}” dhe “{***}” ShPK ka qenë në cilësinë e palës së dëmtuar. Për rrjedhojë, vendimi i pezullimit të hetimeve, i marrë nga subjekti i rivlerësimit, duket qartazi që nuk është një vendim në favor të shoqërisë apo shtetasit M. GJ., ortak dhe administrator i saj.*

- *Nga verifikimi i veprimeve hetimore të kryera rezulton se subjekti ka përmbushur plotësisht detyrën e prokurorit, duke urdhëruar, sipas ligjit, kryerjen e veprimeve hetimore të nevojshme, të cilat janë përpara se shtetasi M. GJ. të kryente donacionin për djalin e tij, në vlerën modeste prej 30.000 lekësh, dhe, më pas, ka vendosur pezullimin për shkak të mosidentifikimit të autorit, pa u ndikuar në vendimmarrje nga asnjë rrethanë e caktuar kohore, që do të përbënte konflikt të mundshëm interesi.*

- Nga aktet në dosje, nuk rezulton që ky procedim penal t'i jetë vënë në dispozicion subjektit pas momentit që ai ka vendosur pezullimin e hetimeve. Përkundrazi, rezulton se ky fashikull është dërguar për herë të parë pranë Prokurorisë nga Komisariati i Policisë Vorë, në datën 24.03.2020, për parashkrim të ndjekjes penale.

26.3. Në kuadër të analizimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstaton se:

26.3/a. Në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” si vijon: “Donacion në Credins Bank për djalin e sëmurë, shuma e derdhur nga M. N. GJ. në llogari, në vlerën 30.000 lekë. Lidhja me subjektin: shoqërore”. Të njëjtin deklaram, subjekti i rivlerësimit e ka bërë dhe në DPV / 2016.

26.3/b. Banka Credins ShA, me shkresën nr. {***} prot., datë 23.10.2020, konfirmon se më datë 04.05.2016, në llogarinë e subjektit është derdhur cash shuma 30.000 lekë, nga z. M. GJ.

26.3/c. Nisur nga të dhënat e mësipërme, Komisioni ka kërkuar informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me çështje penale të hetuara nga subjekti, me z. M. GJ. si shtetas apo në cilësinë e ortakut/administratorit të shoqërisë “{***}”, për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe, nga përgjigjet, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka hetuar procedimin penal nr. {***}, viti 2015, me shoqërinë “{***}” (në cilësinë e palës së dëmtuar), për veprën penale të vjedhjes, hetim i pezulluar nga subjekti më datë 14.10.2015.

26.3/ç. Trupi gjykues, referuar akteve të administruara në dosje, evidenton në mënyrë të përmbledhur rrethanat e lidhura me këtë çështje, si vijon: procedimi penal me numër {***}, i vitit 2015, regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, “Vjedhja”, me të dëmtuar shoqërinë “{***}” dhe “{***}” ShPK, me administrator shtetasin M. GJ., është ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, Valentin Preçi. Me vendimin e datës 14.10.2015, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, pasi ka kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore⁸⁰, ka vendosur pezullim të hetimeve. Komisariati i Policisë Vorë, më datë 24.3.2020, ka dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë disa dosje hetimore për

⁸⁰ Referuar dosjes penale, që i përket procedimit penal nr. {***} dhe kallëzimit penal nr. {***} të vitit 2015, rezulton se: në datën 21.01.2015, është marrë njoftim se në fshatin {***} është vjedhur kasaforta e firmës “{***}”. Policia gjyqësore ka shkuar në vendin e ngjarjes, ku ka rezultuar se në fshatin {***} është vjedhur kasaforta e kësaj firme, ku janë vjedhur në ambientin e brendshëm të kësaj firme një sasi prej 4.571 eurosh dhe 600.000 lekësh. – Nga këqyrja e vendit të ngjarjes dhe pamjeve filmike të kamerave të sigurisë, ka rezultuar se rreth orës 02:30 – 02:50, dy persona kanë hyrë nga muri rrethues, [...]. – Në vendin e ngjarjes, janë marrë në cilësinë e provës materiale tri gjurmë papilare, si dhe disa objekte, [...]. – Në lidhje me ngjarjen, janë marrë deklaratime nga shtetasja K. L., me detyrë recepsioniste dhe menaxhere për hyrjet dhe daljet e vlerave monetare, si dhe janë pyetur si persona të dyshuar shtetasit R. M.; J. K.; M. R.; H. D.; G. S.; S. I.; S. K. dhe R. S., – Është administruar akti i ekspertimit vlerësues i provave materiale, nr. {***}, datë 28.01.2015, nga i cili është konkluduar se në gjurmëkopjuesin, shënuar me shkronjat “A” dhe “B”, janë gjurmë pëllëmbë të vlefshme për identifikim,[...]. – Janë administruar aktet e ekspertimit daktiloskopik, me nr. {***}, datë 04.09.2015 dhe nr. {***}, datë 11.09.2015, ku u konkludua se gjurmët papilare të shënuara me shkronjat “A” e “B”, objekt ekspertimi, të fiksuara në vendin e ngjarjes, nuk janë formuar në gjendjen që paraqiten kartelat daktiloskopike nga duart e shtetasve A. Ç. dhe A. D., si dhe K. L.

parashkrim të ndjekjes penale, sipas nenit 66 të Kodit Penal, ndër të cilat edhe dosja penale e pezulluar, nr. {***}, datë 06.02.2015, listuar me numrin 2.

26.3/d. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, lidhur me konstatimet e Komisionit për këtë çështje, ka sqaruar se: [...] pasi është marrë vendimi i pezullimit të hetimeve në datën 14.10.2015 dhe dosja i është dërguar Komisarariatit të Policisë nr. 6, kjo dosje, bashkë me aktet hetimore, qëndron pranë Komisarariatit të Policisë dhe është Oficeri i Policisë Gjyqësore pranë komisarariatit që, nëse del ndonjë e dhënë e re që ka të bëjë me nevojën për kryerje të veprimeve të tjera hetimore, me qëllim identifikimin e autorit / autorëve të kësaj ngjarjeje, i referon prokurorit, duke sugjeruar rifillimin e hetimeve, me qëllim kryerjen e këtyre veprimeve hetimore. Nuk rezulton se Oficeri i Policisë t'i ketë referuar subjektit ndonjë akt për rifillimin e hetimeve të kësaj çështjeje penale. Ndërkohë, në vitin 2016, ky procedim vijonte të ishte i pezulluar dhe jo nën hetim, për sa kohë, referuar nenit 326/1 të Kodit të Procedurës Penale, aktet i kaluan Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, e cila, në rast të evidentimit të provave të reja, referon rifillimin e hetimeve për këtë procedim, fakt i cili nuk ka ndodhur. Fashikulli është dërguar pranë Prokurorisë nga Komisarati i Policisë Vorë, më 24.03.2020, për parashkrim të ndjekjes penale. Nga dokumentacioni që do të në dispozicion, rezulton se për trajtimin e këtij materiali është caktuar prokurori pranë seksionit të ekzekutimeve të vendimeve penale të formës së prerë, z. E. B. [...].

26.4. Në funksion të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi dhe të konkluzionit të Komisionit, në raport me situatën faktike të sipërcituar, trupi gjykues mori fillimisht në analizë vendimmarrjen e subjektit, në rastin konkret “pezullimin e hetimeve”, në bazë të nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale⁸¹, duke e analizuar atë në raport me nenin 3, pikat 1 dhe 4, dhe nenin 13 të ligjit nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

26.4/a. Referuar nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale, vendimi për pezullimin e hetimeve, kur nuk njihet autori i veprës penale, merret nga prokurori, kur ai ka kryer të gjitha veprimet hetimore të mundshme për zbulimin e autorit dhe, pavarësisht kësaj, nuk ka bazë provuese për të konkluduar për autorin e veprës penale. Në këtë aspekt, vendimi i prokurorit për pezullim të procedimit penal përbën një aspekt të dhënies së drejtësisë, e cila nuk është shumë larg situatës kur prokurori pushon hetimet ndaj një personi. Për sa kohë vendimi për pezullimin e hetimeve merret pasi janë kryer të gjitha veprimet hetimore të mundshme, kjo çështje konsiderohet e përfunduar me vendimmarrje nga ana e prokurorit dhe, si pasojë, nuk mund të konsiderohet çështje ende në proces shqyrtimi për prokurorin që e ka ndjekur. Ky fakt përforcohet edhe me ndryshimet e kryera me ligjin nr. 35/2017, në Kodin e Procedurës Penale, përmes së cilave u parashikua edhe mundësia e kontrollit gjyqësor të vendimmarrjes së prokurorit për pezullimin e hetimeve, duke i dhënë të drejtën viktimës apo palës që ka bërë kallëzimin për ta ankimuar pranë gjyqtarit të seancës paraprake. Me marrjen e vendimit

⁸¹ Neni 326, “Pezullimi i hetimeve” (ligji në fuqi në kohën e hetimit të procedimit penal): 1. Kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm, prokurori vendos pezullimin e hetimeve. 2. Pezullimi i hetimeve vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme. 3. Hetimi i pezulluar rifillon me vendim të prokurorit.

të pezullimit nga prokurori, dosja i dërgohet Drejtorisë Vendore të Policisë për kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore për zbulimin e autorit dhe, vetëm në rast se ka ndonjë fakt të ri, kjo i referohet prokurorit që ka pasur më parë çështjen në ngarkim, duke i sugjeruar rifillimin e hetimeve, me qëllim kryerjen e këtyre veprimeve hetimore. Pasi prokurori vlerëson se duhen rifilluar hetimet, merr vendim për rifillim të hetimeve dhe urdhëron policinë gjyqësore për kryerjen e veprimeve hetimore.

26.5. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të rezultateve të hetimit në Komision, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se marrëdhënia shoqërore është krijuar pas hetimit të çështjes dhe dhënies së vendimit të pezullimit, duke shpjeguar rrethanat dhe nivelin e njohjes me shtetasin M. GJ., si vijon: *Kjo llogari e posaçme, me nr. {***}, u çel pranë bankës “Credins”, në monedhën lekë; llogaria nr. {***}, në monedhën USD dhe llogaria nr. {***}, në monedhën euro, me përshkrimin e veçantë “llogari e hapur për donacione për djalin e sëmurë”. Një ndër shtetasit që ka dhuruar pranë llogarisë me nr. {***} ka qenë dhe z. M. GJ., i cili ka pasur marrëdhënie njohjeje dhe miqësore me të afërmin tim, T. A. Këtë shtetas e kam takuar vetëm një herë (rreth dy-tre muaj pasi është bërë donacioni nga ana e atij), në vitin 2016, për ta falënderuar për zemërsisht për gjestin e tij dhe nuk e kisha njohur asnjëherë më parë apo të kem pasur marrëdhënie miqësore përpara këtij dhurimi. Lidhja shoqërore që kam cilësuar në deklaratë ka të bëjë vetëm me njohjen e përbashkët, mikun tonë T. A., njohje e cila, për herë të parë, u prezantua në vitin 2016. Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision deklaratën noteriale⁸² të shtetasit M. GJ., që konfirmon thëniet e subjektit për kohën e njohjes midis tyre dhe rrethanat e kryerjes së donacionit.*

26.6. Trupi gjykues vëren se, për të aplikuar standardet ligjore të ekzistencës së konfliktit të interesave, në rastin e hetimit të procedimit penal nr. {***}, të vitit 2015, i hetuar prej subjektit të rivlerësimit dhe i konkluduar me pezullimin e hetimeve dhe dërgimin e fashikullit hetimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Komisariati i Policisë Vorë, për zbulimin e autorit, duhet arsyetuar nën dritën e indikatorëve që e përkufizojnë (ose jo) një marrëdhënie si në kushte konflikti interesash.

26.7. Sikurse rezulton nga të dhënat e kësaj çështjeje, procedimi penal nr. {***} është regjistruar në datën 06.02.2015 për veprën penale “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134 i K. Penal, me kallëzues / të dëmtuar nga vepra penale, subjektin “{***}” ShPK, me autor të paidentifikuar. Pas regjistrimit të procedimit penal, janë kryer një sërë veprimesh hetimore në drejtim të verifikimit të ekzistencës së faktit, zbardhjes së autorësisë dhe vendosjen e tij përpara përgjegjësisë penale, por nuk është bërë dot e mundur zbardhja e autorit mbi ngjarjen e, për rrjedhojë, në bazë të nenit 326 të K. Pr. Penale (të kohës, pa ndryshimet me ligjin nr. 35/2017), ka disponuar me “pezullimin e hetimeve”, si një vendimmarrje që jepet në kushtet e: i) mosnjohjes së autorit të veprës penale, dhe; ii) kryerjes paraprakisht të të gjitha veprimeve të mundshme.

26.8. Nga analiza e veprimeve objektive të mësipërme, të dokumentuara me akte shkresore të kohës, rezulton se ndërmjet procedurës ligjore të ndjekur prej subjektit për hetimin e

⁸² Deklaratë noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 12.12.2023, e shtetasit M. GJ.

procedimit penal nr. {***}/2015 dhe faktit të pagesës së donacionit nga shtetasi M. GJ., mungon koherenca dhe lidhja shkakësore në konfigurimin e një situatë si konflikt interesash. Evidentimi i interesit privat (donacioni i shumës 30.000 lekë nga M. Gj.), jashtë periudhës së hetimit dhe, pas marrjes së vendimit për pezullimin e tij dhe përcjelljes së fashikullit në Polici, e shkëput “gjendjen” si koncept thelbësor për ekzistencën e një konflikti interesi të mundshëm.

26.9. Qëndrimi i mësipërm vjen në harmoni edhe me vlerësimin e Kolegjit në raste të ngjashme, sipas së cilës, konflikti i interesit lidhet domosdoshmërisht me një situatë të caktuar, çështje konkrete apo vendimmarrje, e cila ka ndodhur ose pritet të ndodhë. Një argument tjetër që nuk tregon për njëanshmëri të subjektit në trajtimin e procedimit penal në fjalë, është edhe fakti që shoqëria “{***}” ShPK ka qenë në cilësinë e palës së dëmtuar, dhe vendimi i pezullimit të hetimeve, i marrë nga subjekti i rivlerësimit, për shkak se nuk është bërë i mundur zbulimi dhe identifikimi i autorëve të kësaj veprë penale, duket që nuk është një vendim në favor të shoqërisë apo shtetasit M. GJ., ortak dhe administrator i saj.

26.10. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se situata e argumentuar në pikën e mësipërme dhe, njëkohësisht testi i konfliktit të interesit, do të aktivizohej në rast se, në çdo moment, nga policia gjyqësore do të kërkohej “rifillimi i hetimeve” dhe subjekti, si prokuror potencial për vlerësimin e një kërkesë të tillë eventuale, do të pranonte shqyrtimin e saj. Për sa kohë që rezulton se nuk është paraqitur asnjëherë çështja, pas disponimit të pezullimit të hetimeve dhe dërgimit të dosjes në Polici, për shkak se përmes shortimit i ka kaluar për trajtim një prokurori tjetër, subjekti nuk është vendosur përpara një situatë konflikti interesi, që do të mbartte detyrimin e shmangies së tij (sipas neneve 17 dhe 18 të K. Pr. Penale).

26.11. Gjithashtu, nga aktet e administruara gjatë gjykimit, rezulton se pas pezullimit të hetimeve për procedimin penal në fjalë, në tetor të vitit 2015, fashikulli është përcjellë në Komisaratin e Policisë Vorë, ndërkohë që me Urdhrin nr. 40, datë 07.12.2015, “Për organizimin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore”, në përputhje me nenin 27/c, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, subjekti është caktuar për të ushtruar funksionin në seksionin që përfshin referimet nga komisaritet e policisë nr. 3, nr. 5 dhe Komisaritat Rinas (ndryshe nga Komisarati Vorë, që kishte qenë më herët). Për shkak të kësaj rrethane, pas dhjetorit të vitit 2015 (pra, ende pa lindur dyshimi për konfliktin e interesit) as eventualisht, subjekti i rivlerësimit nuk mund të vendosej dot më në kushtet e një konflikti interesi që t’i lindte detyrimi për shmangie, pasi në çdo kohë, edhe para datës 05.04.2016, ky procedim penal (edhe në rast rifillimi hetimesh), nuk do të mund t’i caktohej më për ndjekje, për shkak të ndryshimit të seksionit dhe lëndës e kompetencës tokësore të tij, por edhe se në vitin 2020 u parashkrua afati i ndjekjes penale.

26.12. Për sa më sipër, trupi gjykues, duke konsideruar deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me rrethanat dhe nivelin e njohjes me shtetasin M. GJ., si dhe në mungesë të ndonjë

indicieje apo të dhëne⁸³, të dala nga aktet e administruara në dosje, që do të dëshmonte një raport shoqëror mes tyre, para periudhës së hetimit të çështjes penale, vlerëson se nuk u vërtetua asnjë arsye apo motiv, që tregojnë njëanshmëri të subjektit në trajtimin e procedimit në fjalë, si për shkaqe ligjore, ashtu edhe për shkaqe personale apo të ndonjë interesi të mundshëm, duke rezultuar subjekti i rivlerësimit, të mos jetë vendosur para situatës së konfliktit të interesit, që do të mbartte detyrimin e shmangies, sipas neneve 17 dhe 18 të Kodit të Procedurës Penale, për rrjedhojë, shkak i ankimit të Komisionerit Publik është i pabazuar.

27. Lidhur me shkakun e ankimit për denoncimet e publikut

27.1. Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, ka vlerësuar se rrethanat e dala nga çështjet penale që lidhen me denoncimin e paraqitur nga shtetasi B. A. dhe denoncimi tjetër i paraqitur nga shtetasi A. H., duhen vlerësuar në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, së bashku me gjetjet e tjera në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, lidhur me aftësinë e përgjithshme për të marrë logjikisht hetimin, sipas nenit 73/2 të ligjit nr. 96/2016, si dhe në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, dhe për të marrë në pyetje, sipas nenit 73/3 të po këtij ligji.

Sipas Komisionerit Publik, sjellja e subjektit të rivlerësimit duket se vjen në kundërshti me vlerat themelore të pritshme të një magjistrati, siç është përcaktuar në nenin 3, pika 5 e ligjit nr. 96/2016, dhe vlerëson se problematikën e konstatuar në përfundim të vlerësimit të gjetjeve, të lidhura me konfliktin e interesit dhe ato të dala nga shqyrtimi i dy denoncimeve, janë të vlefshme për t'u trajtuar nga Kolegji eventualisht, së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, nën frymën e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të aplikimit të nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, si cenim i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

27.2. Lidhur me denoncimin⁸⁴ e shtetasit B. A., trupi gjykues konstaton se dononcuesi pretendon se prokurori Valentin Preçi e ka mbyllur çështjen penale për të cilën ai kishte bërë kallëzim penal, pa kryer hetim, pa marrë në pyetje dëshmitarët dhe pa kontaktuar aspak me personin e kallëzuar për veprën penale të mashtrimit, duke vendosur mosfillimin e hetimeve për kallëzimin e tij, vendim i cili, pasi është ankimuar gjyqësisht nga dononcuesi, është prishur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

27.3. Në funksion të shqyrtimit të pretendimit të dononcuesit, Komisioni i ka kërkuar⁸⁵ Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁸⁶ dosje të fashikullit përkatës për procedimin penal me numër {***/2018. Nga verifikimi i akteve të kësaj çështjeje trupi gjykues konstaton se:

⁸³ Nga verifikimi i akteve në dosje, nuk rezulton ndonjë e dhënë apo rrethanë (udhëtim sipas sistemit TIMS etj.) që do të dëshmonte njohje apo një marrëdhënie miqësie mes subjektit të rivlerësimit dhe dhuruesit të shumës, shtetasit M. G.J., para periudhës së hetimit të procedimit penal.

⁸⁴ Regjistruar në Komision me nr. {***/} prot., datë 11.09.2018.

⁸⁵ Shkresë nr. {***/} prot., datë 03.11.2022, e Komisionit, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁸⁶ Me shkresë nr. {***/}, datë 10.11.2020, Prokuroria i ka përcjellë kopje të fashikullit penal.

(i) Në datën 24.05.2016, mbi bazë të kallëzimit të shtetasit B. A., në ngarkim të shtetasit N. V., në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është regjistruar kallëzimi penal me numër {***}, për veprën penale të *Mashtrimit*, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal.

(ii) Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka konkluduar se fakti i mësipërm nuk përmban elemente të veprës penale, pasi kjo është një marrëdhënie juridike civile dhe, si e tillë, duhet të vendoset mosfillimi i procedimit penal nr. {***}, të vitit 2016.

(iii) Kundër vendimit për mosfillimin e procedimit penal, shtetasi B. A. ka bërë ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me vendimin nr. {***} akti, datë 11.11.2016, ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuarit dhe kthimin pranë organit të Prokurorisë për hetime të mëtejshme.

(iv) Kundër këtij vendimi, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. {***}, datë 23.04.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***} akti, datë 11.11.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

(v) Subjekti i rivlerësimit, më datë 28.05.2018, ka nxjerrë urdhrin për regjistrimin e procedimit penal nr. {***}, për veprën penale të “*Mashtrimit*”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal dhe, më datë 25.2.2019, ka urdhëruar regjistrimin e emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale, emrin e shtetasit nën hetim, N. V., për veprën penale të “*Mashtrimit*”, e parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal.

(vi) Në përfundim të hetimeve, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kuadër të procedimit penal, ka paraqitur para kësaj gjykate kërkesën për dërgimin në gjyq të çështjes nr. {***}/2018, në ngarkim të shtetasit N. V., për veprën penale të “*Mashtrimit*”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. {***} datë 23.04.2019, ka vendosur: [...] *Deklarimin fajtor të të pandehurit N. V., për kryerjen e veprës penale të “Mashtrimit” dhe, në bazë të nenit 143/3 të Kodit Penal, dënimin e tij me 5 vite burgim [...].*

27.4. Komisioni, në konkluzionin e tij mbi rastin, është shprehur se mban në konsideratë edhe faktet si vijon: [...] *subjekti i rivlerësimit, në përfundim, ka marrë një vendim të drejtë, duke treguar profesionalizëm dhe, vendimmarrja e parë e tij për “Mosfillimin e procedimit penal”, e bazuar në përmbajtjen e kallëzimit dhe në bindjen e tij të brendshme, krijojnë te Komisioni bindjen se vendimi i parë i subjektit, pavarësisht se rezultoi i gabuar, nuk është marrë me qëllim favorizimin e të pandehurit, aq më tepër që nuk u provuan me prova shkresore apo me ndonjë indicie, veprimet korruptive të subjektit të rivlerësimit në raport me të pandehurin N. V. Për sa më lart, Komisioni, në përfundim, çmon që vendimin e subjektit të rivlerësimit, “Për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. {***}/2016”, ta vlerësojë në tërësinë e veprimeve të subjektit për këtë procedim dhe, në tërësi, gjatë vlerësimit profesional të tij, duke i dhënë një peshë të konsiderueshme edhe parimit të proporcionalitetit në lidhje me veprimet / problematikat e konstatuara nga Komisioni për rastin në fjalë [...].*

27.5. Subjekti i rivlerësimit, në qëndrimin e mbajtur në Kolegj, ashtu si edhe në shpjegimet e dhëna në Komision, lidhur me vendimmarrjen e tij, sqaroi se, pas verifikimeve të ngutshme të

materialit kallëzues, ka konstatuar se kallëzuesi dhe i kallëzuari kishin një histori të gjatë njohjeje dhe biznesi ndërmjet tyre. Përgjatë kësaj kohe, në vijimësi, kishin tjetërsuar reciprokisht pjesë të kapitalit të shoqërisë, në bazë të kontratave të shitblerjeve, duke mos u prezantuar ndonjë rezervë apo problematikë pagesash e trashëguar nga këto rrethana. Pretendimi i ngritur në lidhje me dhënien e një shume monetare, i pasuar nga njohja verbale e këtij detyrimi e, më tej, premtimi për ta likuiduar të plotë investimin e kallëzuesit, kanë qenë elemente që janë vlerësuar prej tij se ndodhej përpara një marrëdhënieje juridiko-civile. Sipas subjektit, mbi bazën e konkluzionit të arritur (mosfillimin e procedimit penal), ligjërisht nuk mund të kryente veprime hetimore në funksion të ushtrimit të ndjekjes penale, përfshirë këtu edhe marrjen e deklarimeve nga i kallëzuari përmes letërporosisë, pasi një veprim hetimor si ky i fundit, kërkonte detyrimisht regjistrimin e procedimit penal (pasi në të kundërt, rrezikohej ligjshmëria e marrjes së provës e, për pasojë, edhe përdorshmëria e saj).

27.6. Subjekti pretendon se ankimi i Komisionerit Publik lidhur me këtë çështje është paragjykes, nisur vetëm nga qëndrimi i ndryshëm i gjykatës mbi faktin e kallëzuar, i cili gjithsesi, në asnjë moment nuk e ka cilësuar të paargumentuar, të paqartë, të pakuptueshëm apo të palogjikshëm arsyetimin e tij, mbi të cilin kishte arritur në konkluzionin për mosfillimin e procedimit penal.

27.7. Trupi gjykues, nisur nga sa më sipër, konstaton se ekzistojnë dy vendime gjyqësore, më konkretisht, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. akti {***}, datë 11.11.2016, dhe vendimi nr. {***}, datë 23.04.2018, i Gjykatës së Apelit Tiranë, sipas të cilave, kanë konstatuar se hetimi kishte mbetur i paplotë dhe se duhet të kryheshin hapa të tjerë hetimorë. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit, me vendimin për mosfillimin e procedimit penal nr. {***}/2016, nuk ka hetuar të dyshuarin kryesor, shtetasin *N. V.*, në mënyrë që të konkludonte nëse përfituesi i të hollave ka qenë në një marrëdhënie ortakërie juridiko-civile apo e gjithë kjo ka shërbyer për realizimin e qëllimit, që synonte hedhjen në dorë në mënyrë të paligjshme të pasurisë së tjetrit, pretendim edhe i kallëzuesit. Trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit se kishte vështirësi, pasi i dyshuari ndodhej jashtë Shqipërisë, në Rumani, nuk përbën një justifikim ligjor për moskryerjen e hetimit të plotë të një procedimi penal, sa kohë mjetet procedurale për marrjen e deklarimeve, edhe në këto raste, gjejnë rregullim të posaçëm në ligj.

27.8. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se me veprimet / mosveprimet e subjektit të rivlerësimit *“Për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. {***}/2016”*, pavarësisht se nuk janë të plota, ato nuk janë të tilla që të afektojnë indikatorët e pikave 2 dhe 3 të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

27.9. Në lidhje me denoncimin e paraqitur nga shtetasi A. H., ku pretendohet se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, nuk i ka njoftuar palës kallëzuese kërkesën për pushimin e çështjes, sikundër parashikon neni 329/a/4 i Kodit të Procedurës Penal, trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve të kësaj çështjeje konstaton se: (i) Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 03.12.2021, ka regjistruar procedimin penal me nr. {***}/2021, për kryerjen e veprës penale të *Falsifikimit të dokumenteve*, parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal, me kallëzues shtetasin A. H., mbi bazën e akteve të dërguara për kompetencë nga ana e

Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. (ii) Më datë 03.10.2022, subjekti i rivlerësimit është caktuar në cilësinë e prokurorit të çështjes me short elektronik. Më datë 04.11.2022, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur për gjykim para gjyqtarit të seancës paraprake të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkesën penale me objekt: *Pushimi i çështjes nr. {***}, të vitit 2021, regjistruar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, me arsyetimin se: [...] mungojnë veprimet në kundërshtim me ligjin material penal dhe, në bazë të nenit 328/1, germa “b”, të K. Pr. Penale, fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale [...].* (iii) Në vijim të kërkesës, gjyqtari i seancës paraprake, më datë 15.03.2023, me vendimin nr. {***}, ka vendosur: *[...] Pranimin e kërkesës së përfaqësuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e procedimit penal nr. {***/2021 [...].*

27.10. Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, duke i kërkuar të japë shpjegime lidhur me faktin se, nga aktet e përfshira në fashikull, nuk konstatohet dërgimi dhe marrja dijëni nga palët e interesuara të kërkesës për pushimin e çështjes, sikundër parashikon neni 329/a/4 i Kodit të Procedurës Penale, duke iu mohuar kësisoj palëve të drejtën për të realizuar të gjitha kërkesat kushtetuese e ligjore të një procesi të rregullt ligjor.

27.11. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, të paraqitura në Komision, por edhe në qëndrimin e mbajtur gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore në Kolegj, ndër të tjera, ka deklaruar se: *[...] kjo “gjetje” e Komisionit dhe pretendimi i shtetasit A. H. për mungesë të njoftimit të “Kërkesës për pushimin e çështjes” nga prokurori, është e bazuar, pasi në fashikull nuk i rezulton të ndodhet shkresa drejtuar kallëzuesit me kërkesën bashkëlidhur. Sa më sipër, ka ardhur si pasojë e ngarkesës së lartë në punë në vitin 2022. Nga ana tjetër, kjo e metë e hetimeve paraprake nuk ka sjellë asnjë pasojë për të drejtat e shtetasit A. H., pasi ai është njoftuar rregullisht nga gjykata, ai ka marrë pjesë në gjykim dhe ka parashtruar kërkimin e tij për kthimin e çështjes për plotësim të hetimeve, pretendim të cilin e bazon vetëm në faktin se nuk ishte kryer një hetim i drejtë dhe i bazuar në ligj, pa dhënë asnjë detaj të mëtejshëm për pretendimet e tij apo në çfarë drejtimi konkret duhet të plotësoheshin hetimet.*

27.12. Trupi gjykues konstaton se në dosjen gjyqësore rezulton të jetë administruar kërkesa drejtuar gjykatës për pushimin e procedimit penal, por nuk gjendet i administruar shënimi për marrjen në dorëzim nga kallëzuesi të kërkesës në fjalë, sipas nenit 329/a, pika 4 e Kodit të Procedurës Penale⁸⁷. Sikurse rezulton nga dosja gjyqësore, pas përpilimit të kërkesës për pushimin e çështjes, fashikulli i hetimit është përcjellë shkresërisht në gjykatë brenda katër ditëve dhe janë realizuar njoftimet për gjykimin e saj. Një rrethanë e tillë eventualisht përbën edhe kohën e procedurave administrative të sekretarisë së prokurorisë për njoftimin e kërkesës te palët. Nisur nga të drejtat që ligji i njej palëve nga ky njoftim (vetëm njohjen me aktet e procedimit), nuk mundet që një gabimi të procedurës administrative (që pason një sërë burokracish administrative për njoftimin e tij), t'i parashikohet një peshë në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale apo etike të prokurorit.

⁸⁷ Neni 329/a, pika 4 e K. Pr. Penale parashikon: *“Kërkesa i njoftohet të pandehurit, mbrojtësit të tij, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personit që ka bërë kallëzim ose ankim. Ata kanë të drejtë të njihen me aktet dhe provat, si dhe të marrin kopje të tyre”.*

27.13. Në konkluzion të analizimit të këtij shkakut ankimi, lidhur me denoncimin e shtetasit A. H., trupi gjykues, ashtu sikurse edhe Komisioni, vlerëson se pasoja ndaj kallëzuesit, për shkak të mosnjohjes së tij me kërkesën e prokurorit “Për pushimin e procedimit penal”, nuk është me vlerë përcaktuese në proces, referuar faktit që kallëzuesi, gjatë gjykimit të kësaj kërkesë nuk ka paraqitur ndonjë provë, që mund të pretendonte se nuk i është marrë në konsideratë nga subjekti apo nuk ka paraqitur ndonjë pretendim që i është cenuar ndonjë e drejtë tjetër gjatë hetimit. Si rrjedhim i këtyre fakteve, pasoja e pretenduar nga denoncuesi ka mbetur në “nivele formal”, duke zbehur kështu edhe rëndësinë e shkeljes që ka kryer subjekti i rivlerësimit në këtë rast. Për sa më lart, trupi gjykues arrin në përfundimin se një mangësi e tillë, me një rëndësi dhe pasojë minimale në rastin konkret, nuk arrin deri në atë nivel sa të ndikojë negativisht në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

27.14. Trupi gjykues çmon se mangësitë e vërejtura në trajtimin e dy procedimeve penale, analizuar për shkak të dy denoncimeve, nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk marrin ndonjë peshë specifike, të tillë që mund ta ngarkojnë atë me përgjegjësi në drejtim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale apo të vlerësimit tërësor, sipas nenit 4, pika 2, në lidhje me nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

28. Së fundmi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se, edhe pretendimet për cenim të besimit të publikut janë të pabazuara. Pa përsëritur sa është referuar më sipër në lidhje me arsyet për të cilat subjekti nuk ka mbajtur në konsideratë komunikimet telefonike në vitin 2012, në drejtim të telefonit të tij zyrtar, trupi gjykues i Kolegjit vëren se, në kushtet që subjekti asnjëherë nuk është pyetur për to dhe, nga ana tjetër, në pyetësorin standard ka dhënë me vullnet të plotë informacionin që e lidhte me dy individët në fjalë, ngarkimi i tij me mungesë sinjeraliteti në proces do të ishte i pabazuar, disproporcional dhe në mungesë të objektivitetit. Në të njëjtën linjë, edhe pretendimi që lidhet me efektin në perceptimin e publikut, për shkak të fitimit të disa biletave të lotarisë sportive, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit⁸⁸, u vlerësua pa peshë, ndërsa shpjegimet e subjektit për faktin që ishte një episod i papërsëritur, i veçuar dhe që përfshin edhe një të afërm të tij në këtë lotari sportive, u vlerësuan bindëse.
29. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të çështjes, konkludoi se subjekti i rivlerësimit Valentin Preçi ka arritur nivel të besueshëm në të tria kriteret e rivlerësimit dhe nuk ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, për pasojë, ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Për sa më lart, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar në ligj vendimin nr. 730, datë 10.01.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Valentin Preçi.

⁸⁸ Vendimi i Kolegjit nr. 25, datë 14.10.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Artur Selmani.

PËR KËTO ARSYE:

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 730, datë 10.01.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Valentin Preçi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 26.02.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi – kundër

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi – kundër

MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtarët Ina Rama dhe Sokol Çomo, kemi votuar kundër vendimit të dhënë nga shumica e trupit gjykues për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Valentin Preçi, duke votuar për ndryshimin e tij dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.
2. Vota jonë kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues lidhet me qëndrimin ndryshe në drejtim të disa shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik, në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë dhe kontrollit të figurës, të cilat, të vlerësuara sipas analizës sonë, çojnë drejt konkluzionit se subjekti i rivlerësimit është në kushte të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë në pronësi të tij, si edhe për të përballuar shpenzimet e jetesës, në vlera që pengojnë zbatimin e parimit të proporcionalitetit, duke mos arritur një nivel të besueshëm lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, dhe për pasojë, gjendet në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
3. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, në vlerësimin tonë, ka dështuar të provojë se mosdeklarimi i një kontakti të papërshtatshëm, në deklaratën për kontrollin e figurës, ka ndodhur për shkak të mosnjohjes me të, duke u gjendur në këtë mënyrë në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm lidhur me këtë kriter, në kuptim të nenit DH, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe të neneve 39 e 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
4. Analiza e mëposhtme, në mbështetje të votës sonë kundër, do të fokusohet në ato çështje për të cilat kemi ndarë qëndrime të ndryshme nga shumica, të cilat kanë përcaktuar edhe votën tonë për ndryshimin e vendimit të Komisionit.

Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

5. Çështja e parë e marrë në analizë i përket shqyrtimit të shkakut të ankimit të ngritur nga Komisioneri Publik, *lidhur me përlllogaritjen e shpenzimeve të kryera për shlyerjen e kredisë së marrë në Emporiki Bank, në vitet 2008 – 2010, në vlerën totale prej 8.750 eurosh, të pretenduar prej subjektit se është shlyer prej vjehrrit të tij, SH. B.* Lidhur me këtë çështje, kemi ndarë qëndrim të ndryshëm nga shumica, duke konkluduar se ky shkak ankimi është i bazuar dhe subjekti duhet të ngarkohet në analizën financiare me këtë shpenzim duke arsyetuar si vijon.

5.1. Subjekti në deklaratën *vetting* ka deklaruar si një prej burimeve të krijimit të pasurisë “apartament dhe garazh”, objekt kontrolli, kreditë në vlerën totale prej 30.000 eurosh, të marra në Emporiki Bank. Këto kredi, ai i ka deklaruar si të tilla edhe në DPV-në e vitit 2008. Duke filluar nga ky vit deklarimi, në DPV-të e viteve 2008, 2009 dhe 2010, ai ka deklaruar shlyerjet e kësteve të tyre në secilin vit, respektivisht 2.800 euro, 4.460 euro dhe 3.874 euro, ndërsa në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar vetëm shumën e mbetur të pashlyer nga kredia afatgjatë, prej 24.500 eurosh, e cila vijonte të ishte akoma korente. Në këto akte, në të cilat deklarohen interesat privatë dhe pasurorë të subjekteve, subjekti nuk ka dhënë asnjë

informacion për financimin e shumës prej 8.750 eurosh për shlyerjen e këtyre kësteve, prej vjehrrit të tij. Deklarimet e para të dhëna nga subjekti për këto shlyerje janë bërë në përgjigje të pyetësorit standard të Komisionit, në të cilin ai specifikon kështu e shlyera prej vjehrrit, si mbështetje financiare për vajzën e tij dhe familjen e saj.

5.2. Pakica vlerëson se ky deklaram në përgjigjet e pyetësorit standard nuk zëvendëson dhe as shëron mosdeklarimin e përfitimit të kësaj shume, në vitet respektive dhe as në deklaratën *vetting*. Shpenzimet për shlyerjen e kësteve të kredisë, ndonëse nuk kanë të përcaktuar, në rubrikën përkatëse, një zë për të treguar burimin e shlyerjes së tyre, janë shpenzime të deklarueshme sipas përcaktimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, pavarësisht vlerës së tyre dhe, si të tilla, nëse nuk do të financoheshin nga fondet monetare të vetë subjektit, do të duhej që ai të deklaronte fondet e përdorura për pagimin e tyre, për nevoja të analizës matematikore e logjike që do të kryente edhe vetë institucioni i ILDKPKI-së, në funksion të kontrollit të pasurisë së subjekteve. Gjithashtu, përfundi i këtyre shumave, pavarësisht se nuk kanë shërbyer për krijim të pasurive, janë shtesa në të ardhurat e subjektit/personit të lidhur, të cilat kanë shërbyer për përballimin e shpenzimeve, nëpërmjet kalimit të pronësisë mbi to, nga vjehri te vajza e tij/subjekti, dhe si të tilla, kualifikohen si dhurime në kuptim të parashikimeve të ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 9049/2003. Në këtë kuptim, këto vlera monetare duheshin deklaruar si të ardhura të përfituara nëpërmjet dhurimit në deklaratën *vetting* dhe po ashtu në DPV-të e viteve 2008, 2009 dhe 2010, përderisa ato tejkalojnë vlerën e 10.000 lekëve, për të cilat ligji nr. 9049/2003 lejon mosdeklarimin.

5.3. Mungesa e deklaramit të këtyre shumave, në deklaratën *vetting* dhe DPV-të respektive, si edhe mospasja e asnjë gjurme të çfarëdolloj natyre tjetër dokumentare, që tregon se këto fakte kanë ndodhur siç subjekti i pretendon në hetimin administrativ dhe gjykim, nuk krijojnë besueshmëri për këto deklarime, të cilat në këtë kontekst mbeten deklarative dhe ta paprovuara. Pakica sjell në vëmendje, në këtë rast, qëndrimin e konsoliduar të mbajtur nga jurisprudenca e Kolegjit, për vlerën provuese të deklaratave noteriale të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit, aq më tepër kur ato lëshohen nga familjarët, të cilat në këtë rast janë të vetmet dokumente që synojnë të provojnë deklaramet e subjektit. Për këto arsye, ndryshe nga shumica, në kushtet kur faktet e deklaruara prej subjektit gjatë hetimit administrativ, qoftë edhe në përgjigje të pyetësorit standard të Komisionit, mbështeten vetëm në deklarata noteriale të vjehrrit, SH. B., dhe kunatit, E. B., vlerësohen prej pakicës si të paprovuara, sa kohë që ato do të duhej të deklaroheshin në deklaratat respektive të pasurisë.

5.4. Pakica e gjen të drejtë edhe referimin që bën Komisioneri Publik në jurisprudencën e Kolegjit, e cila ka trajtuar në linjën e përkrahur nga pakica, deklaramet për përballimin e shpenzimeve për jetesë, prej vjehrrit të një subjekti tjetër⁸⁹, të cilat u konsideruan se mbetën në nivel deklarativ. Argumentet e përdorura nga shumica, për diferencat mes rasteve, nuk gjenden relevante prej pakicës, pasi në thelb të arsyetimit, në të dyja rastet, qëndron fakti që shumat e pretenduara se kanë shërbyer për përballim shpenzimesh, duhet të deklarohen si të përfituara në deklaratat respektive të pasurisë, në mënyrë që situata më pas të kualifikohej

⁸⁹ Në çështjen nr. 7/2023 (JR), të Kolegjit të Posaçëm të Apëlimit.

sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ndërsa vlera e shumave të përfituara, si element për të dalluar diferencën mes rastit të referuar dhe atij objekt gjykimi, vlerësohet si irelevante në analizën lidhur me këtë çështje, meqenëse duket se kjo vlerë është diktuar nga nevoja konkrete për të korrigjuar analizën financiare përkatëse.

5.5. Për sa më lart, pakica ka konsideruar se shuma prej 8.750 eurosh duhet t'i ngarkohet subjektit si shpenzim në analizën financiare për vitet 2008, 2009 dhe 2010.

6. Çështja e dytë, për të cilën kemi konsideruar të drejtë shkakun e ankimit të Komisionerit Publik dhe kemi mbajtur qëndrim të ndryshëm prej shumicës, lidhet me shpenzimet e kryera për qëndrimin e subjektit dhe të bashkëshortes në ShBA, në periudhën 15.07.2009 deri në 14.11.2009. Sipas vlerësimit të pakicës, këto shpenzime, të përlllogaritura sipas metodologjisë së Kolegjit,⁹⁰ duhet t'i ngarkohen analizës financiare të subjektit për këtë vit kalendarik, duke arsyetuar si vijon.

6.1. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në përgjigjet për pyetësin standard se shpenzimet për këtë periudhë qëndrimi në ShBA, të tij dhe të bashkëshortes, periudhë që përkon edhe me lindjen e njërit prej fëmijëve të subjektit, janë përballuar prej shoqes së bashkëshortes, shtetases L. T., rezidente në shtetin e Ohio-s, ku ata, kryesisht bashkëshortja dhe fëmija i sapolindur, kanë qëndruar për këtë periudhë. Sipas subjektit, marrëdhënia shoqërore mes kësaj shtetase dhe bashkëshortes së tij, e krijuar një vit më parë, kur ata ishin në ShBA, ka qenë arsyeja e kësaj mikpritjeje. Në vlerësimin e pakicës, marrëdhënia shoqërore, e shpjeguar se ka lindur vetëm gjatë qëndrimit njëmuor të një viti më parë, të subjektit dhe të bashkëshortes në ShBA, nuk krijon besim se ka mundur të krijojë një terren të mjaftueshëm për të mirëpritur, për një periudhë katërmujore, një lidhje të re shoqërore, e cila për më tepër do të shtohet me lindjen e një fëmije, duke përballuar çdo shpenzim të kësaj familjeje, përfshi edhe ato që lidheshin me sjelljen në jetë të fëmijës të sapolindur. Qëndrimi në banesën e znj. T., sado e konsiderueshme të jetë ajo në sipërfaqe, apo edhe mundësitë financiare të mikpritëses, sërish nuk krijojnë besim për ofrimin e një mundësie të tillë. Të tilla ngjarje mund të vlerësoheshin të besueshme/arsyeshme, në rast se do të ofroheshin nga familjarë të afërt apo për shkak të marrëdhënieve miqësore të konsoliduara dhe afatgjata.

6.2. Subjekti, në ILDKPKI, në datën 09.03.2016, në përgjigje të pyetjeve: *“Sa herë keni qenë jashtë shtetit? Sa nga puna dhe sa privatisht? Sa kanë qenë shpenzimet për daljet private?”*, ka deklaruar se: *“[...] për qëllime private, me sa mbaj mend, kam qenë një herë në Itali, me bashkëshorten, kam qenë në ShBA rreth 10-11 herë, duke u nisur edhe nga fakti që ka jetuar dhe punuar bashkëshortja ime, shpenzimet janë mbuluar nga të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes”*, duke marrë përsipër në këtë përgjigje shpenzimet e kryera për qëndrimin në ShBA në të gjitha udhëtimet e kryera atje. Shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe të pranuar nga shumica, se pyetja në ILDKPKI ka qenë e përgjithshme dhe se ai është përgjigjur vetëm për shpenzimet e udhëtimit, duke nënkuptuar transportin, vlerësohet prej pakicës si e paarsyeshme dhe e pabesueshme. *Së pari*, pyetja nuk është drejtuar për shpenzimet e

⁹⁰ Sipas vendimit nr. 9/2019 (JR), të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

transportit, por për shpenzimet për daljet private, që do të thotë se interesi ka qenë i adresuar për çdo shpenzim ekstra atyre të jetesës në vendet që është kryer, kur subjekti ka qenë jashtë vendit. *Së dyti*, subjekti ka qëndruar për periudha relativisht të gjata në ShBA, përfshi edhe udhëtimin objekt ankimi, dhe është e paarsyeshme të besohet se ai ka dhënë përgjigje vetëm për shpenzimet për transport, ndërsa ato që prezumoheshin të kryheshin për qëndrimin, ishin shumë më të larta, për pasojë me interes primar për pyetësin. Në këtë kontekst konstatohet si një argument për pabesueshmërinë e shpjegimeve të dhëna në hetim, se subjekti ka deklaruar se shpenzimet për udhëtimin në ShBA, në vitin 2008, janë përballuar prej vjehrrit të tij, ndërsa nëse do të ndiqnim logjikën e shpjegimeve të tij, ai nuk mund të pretendonte një financim të tillë, sa kohë që kur shpjegon përgjigjen në ILDKPKI, se ka pasur në konsideratë vetëm shpenzimet e udhëtimit, do të duhej që të përjashtonte nga këto shpenzime ato të kryera për financimin e këtij udhëtimi, meqë ka pretenduar se vjehri i kishte përballuar ato, dhe jo të ardhurat e vetë subjektit dhe të bashkëshortes. Analiza vlen në këtë rast vetëm për të potencuar arsyet e mungesës së besueshmërisë apo të provueshmërisë së shpjegimeve që jep subjekti lidhur me përballimin e këtyre shpenzimeve.

6.3. Pakica, gjithashtu, sjell në vëmendje se metodologjia e Kolegjit, e përcjellë si një qëndrim orientues për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit, e cila është aplikuar edhe nga shumica në këtë rast, i dedikohet dhe merr sens për udhëtime afatshkurtra, në të cilat subjektet mund të kenë shkuar pranë familjarëve të tyre apo miqve, duke u përballuar prej tyre shpenzimet për qëndrim dhe ushqim. Kjo metodologji nuk ka synuar të përcaktojë rregulla për qëndrime afatgjata jashtë vendit, që dalin nga natyra e udhëtimeve turistike, për të cilat subjektet mund të mbështeteshin prej familjarëve apo miqve të afërt. Në rastin konkret, natyra e mbështetjes tejkalon atë që mund të trajtohej sipas metodologjisë së Kolegjit, ndërsa përfshihet në rastet kur financimi, edhe sikur të kishte ndodhur siç deklarohet, duhej të konsiderohej si dhurim, dhe të deklarohet në DPV-të përkatëse.

6.4. Për shkak të argumenteve si më lart, pakica arrin në konkluzionin se këto shpenzime në vlerën e përlllogaritur, qoftë edhe sipas metodologjisë së Kolegjit për përlllogaritjen e shpenzimeve për udhëtime të shkurtra, prej 1.047.007 lekësh, duhet t'i ngarkohen si shpenzim subjektit të rivlerësimit, në analizën financiare të vitit 2009. Në këtë vlerë, ndonëse nuk ka një matje matematikore, ashtu siç pretendon edhe Komisioneri Publik, duhet konsideruar edhe fakti që në këtë periudhë ka ardhur në jetë një fëmijë, ngjarje e cila mund/duhet të ketë prodhuar shpenzime shtesë përtej asaj që kalkulohet nga metodologjia e Kolegjit.

7. Çështja e tretë, e cila në vlerësimin e pakicës duhej trajtuar sipas shkakut të ankimit të ngritur nga Komisioneri Publik, lidhet me vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurës prej 4000 eurosh, të deklaruar nga subjekti si të përfituar prej lotove sportive në vitin 2010. Lidhur me këtë shkak, pakica ka ndarë qëndrim të ndryshëm nga shumica lidhur me provueshmërinë e përfitimit të saj, duke vlerësuar se subjekti nuk arriti të provonte përfitimin e kësaj shume, për pasojë, ajo nuk duhet të llogaritet si e ardhur në analizën financiare të këtij viti. Ky konkluzion mbështetet në argumentet si vijon.

7.1. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting*, fitimin e shumës 7.451 euro prej lotove sportive, nga shoqëria “{***}”, në nëntor 2010, duke përcaktuar edhe numrat e biletave fituese

sipas vërtetimit përkatës të lëshuar nga shoqëria. Këtë deklaram, por të pashoqëruar me numrat e biletave dhe as me vërtetimin përkatës, subjekti e ka bërë edhe në DPV-në e vitit 2010. Si dokumentacion provues për përfitimin e kësaj shume, e cila më pas është reduktuar në vlerën prej 4.000 eurosh, sipas deklarimeve të subjektit për shpërndarjen e saj me vëllanë e tij, mbetet vetëm vërtetimi i lëshuar nga shoqëria “{***}”, i cili mban datën 07.11.2010. Në analizë të këtij akti, pakica sjell në vëmendje se ajo është një shkresë e thjeshtë dhe nuk ka elemente që garantojnë vërtetësinë e datës së lëshimit, si edhe të të dhënave të tjera të pasqyruara në të. Dokumenti nuk shoqërohet me ndonjë dokumentacion financiar, që provon atë që pasqyrohet në përmbajtje të tij, duke e shndërruar në një dokument deklarativ.

7.2. Në jurisprudencën e mëparshme të Kolegjit, të referuar në ankim nga Komisioneri Publik,⁹¹ është mbajtur një qëndrim konservator në drejtim të provueshmërisë së të ardhurave nga ky lloj aktiviteti, duke mos njohur vlerën provuese të biletave të lotarisë, të cilat nuk kanë gjeneralitetet e personit fitues. Ndërsa, në një rast tjetër, është konsideruar se përfshirja e një magjistrati në aktivitete të tilla, që mund të konsiderohen të ligjshme nga pikëpamja e mospasjes së pengesave ligjore për përfshirjen në to, ngrenë pikëpyetje domethënëse për të ardhurat që magjistratët mund të kenë deklaruar se kanë krijuar nga përfshirja në lojërat e fatit. Në këtë kontekst, merr rëndësi të posaçme, provueshmëria pas një diligjence të lartë, të të ardhurave të fituara nga kjo lloj veprimtarie, duke përballur subjektin e rivlerësimit me një shkallë të lartë për provueshmërinë e tyre. Deklarimi i subjektit në DPV për fitimin e kësaj shume, nuk është në këtë rast prova, e cila provon krijimin e saj, por njohja e kësaj të ardhure të deklaruar në këtë deklaratë, ashtu si edhe në atë *vetting*, duhet provuar në proces, përndryshe mbetet deklarative dhe nuk mund të konsiderohet si e ardhur. Organet e rivlerësimit kanë pasur për detyrë të ushtrojnë kontroll dhe për të verifikuar deklaratimet e subjekteve të rivlerësimit, të cilat në rastin konkret, nuk arrihet të provohen, sipas vlerësimit të pakicës.

7.3. Në moskrijimin e bindjes se kjo shumë është përfituar në kohën dhe vlerën e deklaruar prej subjektit, pakica ka në konsideratë edhe faktin, se jo vetëm që ky deklaram mbështetet vetëm në një dokument të lëshuar nga shoqëria “{***}”, data dhe përmbajtja e të cilit nuk konfirmohen me ndonjë akt tjetër shkresor, por ai është lëshuar nga shtetasi A. B., në cilësinë e menaxherit të sallonit, shtetas i cili është një lidhje familjare e subjektit dhe i përfshirë me të në transaksione të tjera financiare në vitet vijuese. Gjithashtu, fakti që aksionar/ortak i kësaj shoqërie është shtetasi M. F., marrëdhëniet e subjektit me të cilin analizohen si pjesë e shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e kontrollit të figurës, dhe sjella e subjektit në raport me këto marrëdhënie e vë, edhe më tepër, në dyshim vërtetësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të pasqyruara në vërtetimin e lëshuar.

7.4. Në këto kushte, pakica arriti në konkluzionin se shkak i ankimit lidhur me këtë çështje është i bazuar dhe se kjo shumë, për të cilën subjekti nuk arriti të provojë përfitimin e saj, nuk duhet llogaritur si e ardhur e ligjshme në vitin 2010.

⁹¹ Vendimi nr. 8/2018 (JR), i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

8. Çështja e katërt, e cila sipas mendimit të pakicës duhej vlerësuar sipas shkakut të ankimit të ngritur nga Komisioneri Publik, lidhet me deklarin e gjendjes *cash* në deklaratën *vetting*, që si pasojë e analizës financiare të kryer duke përdorur konkluzionet e mësipërme, rezultoi të prodhojë pamundësi për të krijuar këtë gjendje *cash*-i të deklaruar. Qëndrimi i pakicës, ndryshe nga shumica lidhur me këtë çështje, vjen për shkak të qëndrimeve ndryshe, të cilat u analizuan më lart, si edhe të leximit ndryshe të deklarinëve për gjendjen *cash* në vitin 2012. Në mënyrë të përmbledhur, pakica arsyeton si vijon.

8.1. Së pari, në analizën financiare të kryer për të kontrolluar mundësinë për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën *vetting*, u konsideruan si shpenzime të subjektit, ato për shlyerjen e kredisë në vitet 2008, 2009 dhe 2010, si edhe shpenzimet për udhëtimin në ShBA, në vitin 2009. Gjithashtu, nuk u llogarit si e ardhur shuma prej 4.000 eurosh, e deklaruar si e përfitur nga lotaria sportive.

8.2. Së dyti, pakica përlllogarit gjendjen e *cash*-it të deklaruar në DPV-në e vitit 2012, prej 6.000 USD, të krijuar nga kursimet e familjes në ShBA, sipas shpjegimeve të subjektit, se ajo ishte shtesë e gjendjes së viteve të mëparshme dhe jo gjendje totale e kursimeve të disa viteve, siç ka pranuar shumica. Kjo mënyrë leximi e deklarinëve vjen në përputhje jo vetëm me deklarinin dhe shpjegimin e subjektit, por është edhe mënyra e duhur e leximit të deklarinëve të subjekteve, që vjen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, sipas të cilit, çdo vit kalendarik subjektet deklarojnë ndryshimet e gjendjeve të pasurisë nga viti i mëparshëm. Subjekti ka pretenduar se ka deklaruar pikërisht në këtë formë, për pasojë, në analizën financiare të kryer me ndihmën e Njësisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, kjo shumë u konsiderua si e tillë.

8.3. Duke përdorur këto të dhëna, nga analiza financiare, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi financiare me burime të ligjshme të krijonte gjendjen *cash*, në kohën e hartimit të deklaratës *vetting*, duke konkluduar se e gjithë shuma, prej 10.200 USD (1.307.334 lekë) dhe 70.000 lekë, të mos mbulohet me burime të ligjshme.

8.4. Gjithashtu, pakica konstatoi se, nga analiza financiare e kryer për subjektin e rivlerësimit, për vitet 2003 – 2015, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, ai rezultoi me një balancë negative në vlerën prej 1.791.802 lekësh, së cilës i shtohet mungesa e burimeve të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash*, në vlerën 1.377.334 lekë, duke e vendosur subjektin në situatën e parashikuar prej nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, e për pasojë, në kushtet e një deklarin të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e po këtij ligji.

Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës

9. Pakica ka ndarë qëndrim të ndryshëm nga shumica lidhur me shkakun e ankimit që i adresojë kriterit të kontrollit të figurës. Ne kemi vlerësuar si të bazuar pretendimin e Komisionerit Publik, se subjekti i rivlerësimit nuk ishte i besueshëm në shpjegimet që ka dhënë për mospasjen e një kontakti me shtetasin *M. F.*, person i përfshirë në krimin e organizuar, sipas parashikimeve të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, për pasojë, ai ka kryer deklarin të

pamjaftueshëm, duke mos deklaruar në deklaratën për kontrollin e figurës, kontaktin e papërshtatshëm sipas ligjit. Në këtë vlerësim, pakica arriti duke arsyetuar si vijon.

9.1. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar dy herë jashtë vendit me automjet, me shtetasit *A. F.* dhe *M. F.*, në datat 24.06.2012 dhe 17.07.2012. Subjekti ka deklaruar në përgjigjet e pyetësorit standard se ka udhëtuar me të dy këta shtetas, vëllezër me njëri-tjetrin, rastësisht në të dy udhëtimet e rezultuara nga hetimi, duke mos pasur njohje me asnjërin prej tyre, por që rrethana të rastit, të shpjeguara prej tij, e kanë bërë të gjendej në këto dy udhëtime me këta shtetas në të njëjtin automjet. Mbi qëndrimin se subjekti nuk njihej me këta shtetas dhe se kontakti me ta ishte i kufizuar vetëm në këto dy episode, shumica ka ndërtuar të gjithë linjën e arsyetimit mbi të cilin ka konkluduar se subjekti nuk kishte detyrim të deklaronte kontaktin me shtetasin *M. F.* në deklaratën për kontrollin e figurës. Pakica, në të kundërt, ka mbajtur qëndrimin se subjekti nuk ishte i besueshëm në pretendimet e tij për pasjen e vetëm këtyre dy kontakteve me këta shtetas, dhe se situata faktike e rezultuar nga hetimi, si edhe nga informacioni që vjen nga “gjetja” e vëzhguesit ndërkombëtar, e administruar në gjykimin në Kolegj, sugjerojnë të kundërtën.

9.2. Konsideruar kohën e realizimit të udhëtimeve, më datë 24.06.2012, ora 00:46, është regjistruar dalje me mjetin me targa {***}, ku në kolonën “shofer” është regjistruar shtetasi *A. F.* dhe si “pasagjer”, subjekti i rivlerësimit, së bashku me dy persona shoqërues, me vendkalim kufitar “pika kufitare Murriqan” dhe hyrje në territorin shqiptar të subjektit të rivlerësimit, në të njëjtën datë, në orën {***}, me të njëjtin automjet, të njëjtin shtetas si shofer dhe të njëjtët persona shoqërues; (2) më datë 17.07.2012, ora {***}, është regjistruar dalje me mjetin me targa {***} me dy persona, ku në kolonën “shofer” është regjistruar shtetasi *M. F.* dhe si “pasagjer” subjekti i rivlerësimit, me vend kalim kufitar “pika kufitare Morinë”, pretendimi i subjektit se ato kanë qenë rastësore, mbetet i pabesueshëm.

Shpjegimi se rastësisht, ai udhëton në shoqërinë e dy vëllezërve, në harkun kohor të më pak se një muaji, në rrethana që gati krijojnë një tablo *naive* për jetën dhe sjelljet e njerëzve, aq më shumë të një magjistrati/prokurori në detyrë, nuk justifikojnë situatën në të cilën gjendet subjekti dhe nuk krijojnë bindjen se rrethanat e rastit janë zhvilluar në atë mënyrë. Përpjekjet e subjektit për të ndërtuar grup faktesh, të cilat mbështesin pretendimin e tij, dhe nëpërmjet deklarimeve të shtetasve të tjerë, të sjella me anë të deklaratave noteriale të hartuara në funksion të procesit të tij të rivlerësimit, sfidojnë logjikën dhe krijojnë, në drejtim të besueshmërisë, një tablo krejtësisht të kundërt me atë që subjekti synon të provojë. Pretendimet se ai po udhëtonte për të dërguar medikamente te një mik i tij, në Mal të Zi, në orë të vona të natës, se automjeti i tij u prish gjatë rrugës, se shtetasi *A. F.* u gjend rastësisht ta shoqëronte në këtë udhëtim, së bashku me dy shtetase që shoqëronin atë për në destinacion, se subjekti, pasi kreu porosinë e tij, u kthye sërish me të njëjtët shtetas, nga Mali i Zi, në orët e hershme të mëngjesit; apo se rastësisht u takua në një lokal me shtetasin *M. F.*, më pak se një muaj më vonë, për njohjen rastësore me të vëllanë e tij, dhe se meqë ai u vu në dijeni se ky i fundit po udhëtonte për në Prizren, vendosi ta shoqëronte, me qëllim njohjen e qytetit të Prizrenit, në vlerësimin e pakicës, demonstrojnë përpjekje për deformuar të vërtetën në drejtim të marrëdhënies me këta shtetas, në funksion të përmirësimit të situatës së tij në këtë proces.

9.3. Besueshmëria e subjektit për këto deklarime u cenua thellësisht në vlerësimin e pakicës pas faktit të provuar me anë të gjetjes së administruar si provë në gjykim, në zbatim të nenit 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016. Sipas të dhënave që rezultuan nga kjo provë, subjekti kishte shkëmbyer 5 thirrje telefonike me shtetasin *A. F.*, në harkun kohor të 10 ditëve, në vitin 2012. Këto thirrje paraqiteshin jo vetëm hyrëse, nga *A. F.*, në numrin e telefonit të subjektit të rivlerësimit, por edhe dalëse, të paktën dy prej tyre. Këto fakte, nuk mund të vlerësohen sërish si rastësore dhe pa peshë, në drejtim të krijimit të besimit se subjekti po shpjegon të vërtetën për njohjen me këta shtetas. Pretendimet se thirrjet janë shkëmbyer në numrin zyrtar të telefonit dhe se në atë kohë shtetasi *A. F.* nuk ishte një personazh, i cili duhej memorizuar, sepse nuk kishte ende rekorde kriminale, nuk janë relevante në drejtim të vlerësimit të faktit se ky shtetas kishte njohje me subjektin e rivlerësimit, pa qenë domosdoshmërisht e nevojshme të mbahet një qëndrim mbi llojin e raportit. Ajo që del si konkluzion prej pakicës, në analizë të këtyre fakteve, është se pretendimi i subjektit, se njohja me këta shtetas nuk ekzistonte dhe se ai është gjendur rastësisht me ta në udhëtimet e evidentuara prej sistemit TIMS, është i pabesueshëm.

9.4. Nisur nga ky arsyetim, pakica vlerëson se e gjithë analiza tjetër, e bërë prej shumicës, mbi mosprovueshmërinë e pasjes nga subjekti të kontakteve të tjera përtej këtyre të evidentuara, si një argument që shmang përgjegjësinë e tij për të deklaruar kontaktin me shtetasin *M. F.*, është jorelevante. Pasja e kësaj panorame, në vlerësimin e pakicës, provon mjaftueshëm dyshimet se subjekti dhe shtetasi *M. F.* nuk kanë pasur vetëm një kontakt apo, së paku, që ai kontakt të ketë qenë rastësor, pasi të dhënat dhe shpjegimet jobindëse të subjektit sugjerojnë për një situatë të ndryshme faktike në drejtim të marrëdhënieve mes tyre. Kësaj shtohet edhe fakti që subjekti ka deklaruar për fitimin e të ardhurave, nga shoqëria “{***}”, të një shume parash të analizuara më lart, aksionar i së cilës është shtetasi *M. F.* dhe në të cilën punon një familjar i subjektit, si menaxher i sallonit të lojërave të fatit. Këto elemente nuk mund të trajtohen sërish si rastësore dhe pa një lidhje me njëri-tjetrin. Analiza dhe vlerësimi që pakica bën, si një proces logjik dhe i arsyeshëm, e çon në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk është i sinqertë në deklaratimet e tij për këtë raport, dhe mbi këtë konkluzion, ka çmuar edhe përgjegjësinë e tij për mosdeklarimin e kontaktit me shtetasin *M. F.*

9.5. Duke u mbështetur në sa më lart, pakica ka arritur në konkluzionin se subjekti duhet të deklaronte kontaktin me shtetasin *M. F.*, në formularin për kontrollin e figurës, në respektim të detyrimit që vjen nga neni 34 dhe 35 i ligjit nr. 84/2016, për deklarimin me vërtetësi të fakteve në *deklaratën për kontrollin e figurës*, e njohur si shtojca 3 e këtij ligji.

9.6. Në vlerësimin e pakicës, në zbatim të parashikimeve të nenit 3, pika 6⁹² dhe pika 15⁹³ e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte kontaktin me shtetasin

⁹² “Kontakt i papërshtatshëm” është një takim, komunikim elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht nëse vendosen marrëdhënie biznesi, në kuptim të pikës 9 të këtij neni, ose ndonjë marrëdhënie tjetër.

⁹³ “Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit

M. F., në përgjigjen me “po”, të pyetjes me shkronjën “c” të pjesës 5, “*Të dhëna për sigurinë*”, të deklaratës për kontrollin e figurës, duke ekspozuar në mënyrë të plotë marrëdhënien me këtë shtetas. Në vlerësimin e pakicës, sa kohë që personi me të cilin subjekti ka një marrëdhënie, një kontakt të çfarëdo lloji, është i përfshirë në krimin e organizuar, sipas kuptimit të pikës 15, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ai duhet të deklarohet, në mënyrë që organet e rivlerësimit të hetojnë, verifikojnë më tej, natyrën e marrëdhënies, ekzistencën e rrethanave lehtësuese apo renduese, të parashikuara nga neni 38 i këtij ligji, për të konkluduar nëse raporti me këtë person do të duhet të konsiderohet si penalizues për subjektin, në kuptim të përcaktimeve të nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dhe si një shkak, bazë për marrjen e masës disiplinore. Ligji nr. 84/2016, në nenin 3, pika 6, ka përcaktuar në mënyrë të gjerë kategorinë apo llojin e marrëdhënieve që subjektet mund të kenë, dhe të cilat mund të kualifikohen si kontakte të papërshtatshme. Në thelb të këtij përkufizimi qëndron fakti se natyra e marrëdhënies apo individit me të cilin subjekti ka një kontakt, nuk përputhet me ushtrimin e detyrës, duke cenuar në thelb besimin e publikut te një funksionar i drejtësisë. Në këtë kontekst, fakti që në momentin e plotësimit të deklaratës për kontrollin e figurës, subjekti prezumohet që kishte dijeni për përfshirjen e shtetasit *M. F.* në një veprimtari kriminale, që e vendoste atë nën zbatimin e nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, e detyronte subjektin të deklaronte këtë kontakt në këtë deklaratë. Ky detyrim vjen për shkak të ligjit, edhe sikur subjekti të kishte pasur vetëm një takim me këtë shtetas, atë që provohet nga hetimi nëpërmjet të dhënave të sistemit TIMS, aq më shumë subjekti e kishte këtë detyrim nën dyshimin e arsyeshëm që bazohet në rrethanat e referuara më lart, se ky takim nuk duket se ka qenë i vetmi.

9.7. Pretendimet e ngritura prej subjektit dhe të pranuar si shfajësuese prej shumicës, për profilin publik të shtetasit *M. F.*, e padijeninë e subjektit për aktivitetin e tij të kundërligjshëm apo mungesën e provuar të këtyre aktiviteteve për vëllanë ë tij, shtetasin *A. F.*, në kohën që provohet pasja e kontakteve, qoftë edhe rastësore, siç subjekti pretendon, vlerësohen pa ndikim në analizën e mësipërme, për sa kohë detyrimi i subjektit për deklarim dhe përgjegjësia e tij për mosdeklarim kanë lindur me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016 dhe janë materializuar në momentin e hartimit të deklaratës për kontrollin e figurës, moment në të cilin, aktiviteti kriminal i të dy shtesave të përmendur më sipër ishte një fakt i njohur botërisht/publikisht, madje me impakt në memorien edhe të një vëzhguesi të zakonshëm, për shkak të profilit të lartë publik dhe natyrës së veprave penale në të cilat ishin përfshirë këta shtetas.

9.8. Për sa më lart, pakica ka arritur në konkluzionin se subjekti ka kryer deklarim të pamjaftueshëm lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, sipas kualifikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur: a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet; b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata, pasi vepra penale është kryer nga një person që nuk mund të akuzohet ose dënohet.

10. Mbështetur në dy konkluzionet e mësipërme, lidhur me të dy kriteret e procesit të rivlerësimit, atë të vlerësimit të pasurisë dhe të kontrollit të figurës, pakica ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pamjaftueshme sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, ankimi i Komisionierit Publik duhej të pranohej, dhe ndaj subjektit të vendosej masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

GJYQTARE

Ina RAMA

nënshkrimi